

UDHËZUES PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

MJETE TEKNIKE PËR MBROJTJEN
DHE MENAGJIMIN E TRASHËGIMISË



Funded
by the European Union



Implemented
by the Council of Europe

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)

UDHËZUES PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

MJETE TEKNIKE PËR MBROJTJEN
DHE MENAGJIMIN E TRASHËGIMISË

SHTATOR 2012

JP - EU/CoE Support to the
Promotion of Cultural Diversity (PCDK)



LISTA E SHKURTESAVE

PDKK	Promovimi i Diversitetit Kulturor në Kosovë*
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
LTK	Ligji për trashëgiminë kulturore
KiE	Këshilli i Evropës
LPH	Ligji për planifikim hapsinor
LZVM	Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura
KI	Konzervimi i Integruar
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor
ICOMOS	Këshilli Ndërkombëtar për monumente dhe vende
ICCROM	Qendra Ndërkombëtare për ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve kulturore

Ky dokument është prodhuar brenda kornizës së projektit të përbashkët ‘BE/KE – Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë’.
Përmbajtja nuk reflekton domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe/apo të Këshillit të Evropës.

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

PËRMBAJTJA



UDHËZUES PËR INVENTARIZIMIN E PASURIVE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE



UDHËZUES PËR KËRKIME ARKEOLOGJIKE



UDHËZUES PËR LICENCIMIN E HULUMTIMEVE
ARKEOLOGJIKE



UDHËZUES PËR KRITERET DHE KUSHTET PËR VLERËSIMIN
E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE



UDHËZUES PËR HARTIMIN E BAZAVE TË KONSERVIMIT TË
TRASHËGIMISË KULTURORE BRENDË PLANIFIKIMIT



UDHËZUES PËR AKTIVITETET E KONSERVIMIT DHE
RESTAURIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- hartimi i projekteve konservuese



UDHËZUESI PËR RUAJTJEN E TRASHËGIMISË KULTURORE
TË LUAJTSHME



MIRËNJOHJE

Deshirojmë të falenderojmë të gjithë pjesëmarrësit në zhvillimin e Udhëzuesve për Trashëgiminë Kulturore, veçanërisht grupin punues:

Znj. Julija Trichkovska, PDKK specialist i lartë në trashëgiminë kulturore

Z. Jusuf Musa, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Znj. Drenushe Behluli, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Z. Imer Hakaj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Z. Avdyl Hoxha, Qendra Rajonale për trashëgimi kulturore në Pejë

Znj. Lindita Cervadiku – Dibra, Qendra Rajonale për trashëgimi kulturore në Prishtinë

Znj. Valbona Saliuka, Qendra Rajonale për trashëgimi kulturore në Prishtinë

Znj. Besnike Rraci, Muzeu i Kosovës

Ekspertëve vendor:

Znj. Edi Shukriu

Znj. Gjejlane Hoxha

Z. Bujar Demjaha

Z. Osman Gojani

Z. Agim Gerguri

Z. Jusuf Xhibo

Z. Enver Rexha,

Z. Haxhi Mehmetaj

Z. Shafi Gashi

Z. Milot Berisha

Znj. Festa Nixha – Nela

Znj. Hidajete Zhuri

Z. Luan Nushi

Expertëve të Këshillit të Evropës:

Dr. Martin Cherry

Dr. Adrian Olivier

Z. David Johnson

Znj. Donatella Zari

Dr. John Bold

Dr. Robert Pickard

Asistentit të ngritjes së kapaciteteve institucionale në kuadër të projektit PDKK:

Z. Avni Manaj

Gjithashtu shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre në tryezat e rumbullakëta të organizuara nga ekipi i projektit PCDK.

PARATHËNIE

Puna e Këshillit të Evropës (KiE) kombinon bërjen e politikave, dhe siguron mbështetje dhe ndihmë për qeveritë dhe partnerë të tjerë për të zbatuar politikën nëpërmjet një shumëllojshmërie të metodave. Një numër i madh dokumenteve, rekomandimeve dhe udhëzuesve ekzistojnë në Evropë në lidhje me trajtimin e duhur të trashëgimisë kulturore, shumë prej të cilave janë dokumente të KiE.

Në thelbin e tyre është të kuptuarit e trashëgimisë në kontekstin e saj më të gjerë: trashëgimia përfshinë një gamë të gjerë karakteristikash dhe një spektër të vlerave që përshkruajnë rëndësinë e saj si për komunitetet lokale poashtu edhe komunitetin e gjerë Evropian.

Në mbështetje të ligjit ekzistues të Trashëgimisë Kulturore në Kosovë dhe shtatë Rregulloret e tij, projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës – Përkrahje për Promovimin e Diversitetit Kulturor në Kosovë (PDDK) ka kërkuar të forcojë mirëkuptimin e këtyre dokumenteve dhe të integrojë vlerat e tyre më për së afërmi në praktikën e përditshme, në përputhje me praktikën Evropiane dhe konventat ndërkombëtare.

Ne kemi zhvilluar dhe prodhuar shtatë udhëzuesit për të bërë dispozitat e kuadrit ligjor ekzistues më të kuptueshme dhe më lehtë për tu aplikuar. Udhëzuesit janë të hartuar për t'u përdorur nga profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë, dhe janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë tëme Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me ekspertë nga ministritë dhe organizatat tjera, dhe me individë me përvojë të gjerë ndërkombëtare dhe pregaditje profesionale. Udhëzuesit janë dokumente dinamike, dhe kështu duhet të rishikohen ose përditësohen me ndryshimin e kushteve dhe rregullave të reja të miratuara, duke evoluuar në përgjigje ndaj kontekstit të trashëgimisë në Kosovë dhe nevojave në zhvillim dhe aftësive të profesionistëve të saj.

Udhëzuesit janë pika e fillimit për vendosjen e standardeve të trashëgimisë dhe masave dhe për të stimuluar më tej përfshirjen aktive të të dyjava autoriteteve dhe komunitetit të gjerë lokal të trashëgimisë kulturore në çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë.

Robert Palmer

Drejtor i Qeverisjes Demokratike, Kulturës dhe Diversitetit
Këshilli i Evropës
Strasbourg

HORIZONTI NJERËZOR

Kur flasim për trashëgiminë kulturore dhe natyrore shpesh jemi të prirë të përdorim fjalë shumë domethënëse, siç janë: identiteti kombëtar dhe toleranca historike. Por në jetën tonë të përditshme, a mos konfrontohemi shumë shpesh më mu të kundërtën: me identitete të shumëfishta dhe me mosdije të historisë? Shumë shpesh stereotipet mbizotërojnë ndaj nuancave subtile të përvojave individuale të njerëzve, dhe ne shpesh pësojmë tronditje të thella nga ndërhyrjet brutale në veprat dhe vendet me vlera universale si në hapësirat urbane, ashtu edhe në peizazhet mbresëlënëse natyrore.

Nëse ne më të vërtet dëshirojmë të mësojmë nga trashëgimia jonë, mësimi ynë i parë duhet të jetë që të menduarit kritik është trashëgimia jonë më e madhe dhe më e vlefshme. Pa këtë trashëgimi, nuk do të ishte i mundur përparimi. Në momentin kur ta kuptojmë se qëndrimi kritik për aktivitetet tona të përditshme është mënyra më e mirë për njohjen dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë, do të jemi afër maksimës klasike etike që lidh qiellin ylëzor mbi ne me ligjin moral në zemrat tona.

Ose, thënë me fjalë të tjera, afër horizontit njerëzor që lidh peizazhet natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Dhe është mu këtu, në këto momente magjike mes largësive në hapësirë dhe momenteve tona më intime, vendi ku krijohen vlerat kulturore dhe artistike. Rrëmbimi i momentit të përjetësisë, duke kuptuar momentin tonë modern; pasqyrimi i tij në mesin e vlerave të përjetshme, duke e nënshkruar me nënshkrimin e kohës sonë – ky proces i dyfishtë është në thelbin e artit dhe të kulturës, nëse ato një ditë do të bëhen trashëgimi.

Ky Udhëzues, i përkrahur përmes projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, duhet të konsiderohet si një hallkë: mes ligjit dhe terrenit, mes kornizës ekzistuese ligjore (të hartuar përmes debatit të gjerë të ekspertëve dhe atij publik, të organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit) dhe përdorimit të përditshëm nga profesionistët në terren. Hartimi i tij ka qenë shembull tipik i asaj se si duhet të bëhen gjërat në bashkëpunim dhe në mënyrë pjesëmarrëse: a nuk është kjo praktikë e njëjtë e këmbimit të parimeve të miratuar universale me përvojat e fushës specifike, të vendit a të regjionit, gjithashtu edhe mënyra e ecjes përpara drejt integritetit evropian?

Kështu, edhe nëse do të hasni në disa zëra kritikë gjatë kësaj rruge, mos u befasoni – kjo po ashtu është trashëgimia jonë e përbashkët evropiane.

Samuel Žbogar

Udhëheqës i Zyrës së BE-së dhe përfaqësues i Bashkimit Evropian në Kosovë

HYRJE

Lëmia e mbrojtjes së trashëgimisë ka një rëndësi të madhe në përdorimin e parimeve dhe standardeve në udhëzimin e praktikues për konzervimin dhe menagjimin e drejtë të pronave të trashëgimisë .

Ruajtja nuk është e kufizuar me ndërhyrje fizike, sepse ajo përfshinë veprimtari të tilla si interpretimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të karakteristikave të saj.

Menaxhimi i qëndrueshëm i trashëgimisë nuk është një proces i izoluar; ai fillon me identifikimin, kuptimin dhe përcaktimin e vlerave kulturore dhe atributëve të tyre të rëndësishme, e cila është një bazë ligjore për një përcaktim në çdo sistem kombëtar të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

Përtej emërtimeve, në kontekstin më të gjerë të menaxhimit të mjedisit dhe planifikimit hapësinor, një kuptim i vlerës së trashëgimisë që mund të ketë për të pronarët e tyre, bashkësitë lokale dhe palët tjera të interesit duhet të konsiderohet si një bazë për të ardhmen e tij.

Në këtë proces dinamik të mbrojtjes së trashëgimisë, standardet dhe praktikët e mira të vendosura në zbatimin e masave konservuese dhe ndërhyrjet duhet të jetë gjithmonë të përpunuar me kujdes dhe të zbatohen, duke konsideruar se vlerat e trashëgimisë përfaqësojnë interes publik.

Përdorimi i ligjit të trashëgimisë, rregulloret dhe instrumentet e tjera ligjore ose mjete teknike në procesin e mbrojtjes së trashëgimisë janë të justifikuara për të mbrojtur atë interes publik.

Udhëzuesit për Trashëgiminë Kulturore – «Mjete teknike për Ruajtjen dhe Menaxhimin e Trashëgimisë» paraqesin praktikët aktuale sistematike dhe të harmonizuara në bazë të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore në Kosovë dhe shtatë rregulloret e tij, në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare.

Këta Udhëzues janë përgatitur nga anëtarë të shtatë grupeve të ndryshme punuese duke përfshirë stafin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ekspertët vendorë nga një numër i ministrive dhe instituteve në Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtare nën drejtimin e projektit PDDK, midis pranverës së vitit 2010 dhe pranverës së vitit 2012.

Projekti PDDK ka ndjekur një metodologji sistematike në përgatitjen e secilit prej Udhëzuesve, duke siguruar konsultime të vazhdueshme me palët përkatëse; duke punuar së pari me stafin e MKRS dhe ekspertët lokalë, duke studiuar shembujt në Kosovë, duke përcjellur kërkesat ligjore dhe duke tërhequr lidhje me standardet ndërkombëtare. Kjo praktikë është konsideruar gjithashtu pjesë e zhvillimit kapaciteteve duke punuar për stafin e MKRS. Draft dokumentet u janë dërguar ekspertëve të Këshillit të Evropës që kanë dhënë reagimet e para për Udhëzuesit përkatës.

Dokumenti është rregulluar nga ekipi PDDK-së, dhe pastaj është përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe është ndarë me aktorët lokalë në një tryezë të rrumbullakët. Informata kthyesë marrë nga palët e interesuara u konsolidua në dokument, në mënyrë që të zhvillojë një version përfundimtar të dokumentit, i cili iu nënshtrua kontrollit përfundimtar nga një ekspert ndërkombëtar.

Kjo metodë u përsërit për secilin prej Udhëzuesve, për të inkurajuar pjesëmarrjen e më gjithëpërfshirëse të mundshme në proces. Këto grupe punuese janë të përfshirë në një përpjekje bashkëpunuese për të zhvilluar Udhëzuesit që mund të përdoren më së miri nga profesionistët në këtë fushë.

Udhëzuesit për Trashëgimi Kulturore janë përgatitur në mënyrë që të sigurojnë që puna në terren të plotësojë standardet e nevojshme për të mbrojtur asetet e trashëgimisë në Kosovë. Udhëzuesit do të duhet të rishikohen dhe të përditësohen periodikisht për të pasqyruar rekomandimet aktuale dhe ndryshimet që potencialisht mund të ndodhin në periudhën e ardhshme. Dokumenti përmbanë shtatë seksione, secili përfaqëson Udhëzuesin bazuar në Ligjin e Trashëgimisë Kulturore dhe rregulloret.

Lexuesit e Udhëzuesve duhet ta shohin dokumentin si një burim teknik që do të përdoren në teren poashtu edhe në prodhimin e dokumenteve të cilat janë të hartuar për publikun në përgjithësi.

Si Udhëzues të tillë janë duke u prezentuar në fushën e trashëgimisë kulturore në Kosovë, projekti PDDK-së beson se ky botim do të ketë një ndikim të konsiderueshëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Projekti PDDK shprehë gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar në procesin e zbatimit të këtyre Udhëzuesve.

**Udhëzues për
inventarizimin
e aseteve të
trashëgimisë
kulturore**

HISTORIKU

HYRJE

UDHËZUESI

INVENTARËT E KATEGORIVE TË NDRYSHME TË ASETEVE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE

- I. PËRMBAJTJA E INVENTARIZIMIT TË ASETEVE TË
PALUAJTSHME TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- II. PËRMBAJTJA E INVENTARIZIMIT TË ASETEVE TË
LUAJTSHME TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- III. PËRMBAJTJA E INVENTARIZIMIT TË ASETEVE TË
TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE

BURIME TË PËRZGJEDHURA

HISTORIKU

Udhëzuesi për inventarizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore është përgatitur nga anëtarët e ekipit të PDKK-së. Ky udhëzues është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, z. Martin Cherry (Mbretëria e Bashkuar). Kryesisht, Udhëzuesit kanë për qëllim të shërbejë si një mjet teknik për identifikimin dhe inventarizimin e kategorive të ndryshme të aseteve të trashëgimisë kulturore e cila është thelbësore për procesin e mbrojtjes.

Prishtinë, Shkurt 2011

HYRJE

Si pjesë integrale e sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, inventarizimet e kategorive të ndryshme të aseteve të trashëgimisë kulturore ofrojnë informacion të harmonizuar, të krahasueshëm dhe të përdorshëm mbi trashëgiminë.

Përpilimi i inventarit, përkatësisht regjistrimi i informacionit bazohet në:

1. parimet e transparencës, objektivitetit, punës ndërdisiplinare, kompetencës dhe detyrimeve
2. kategorinë/llojin e trashëgimisë, sistemin autorizues kombëtar/lokal dhe llojin e caktuar të inventarit;
3. standardet ndërkombëtare të inventarizimit lidhur me klasifikimin dhe datimin.

Udhëzuesit për Inventarizimin, i propozuar (më poshtë “Udhëzuesi”) është në përputhje me legjislacionin aktual të Kosovës në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, në veçanti me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore” (më poshtë “LTK”) numër 02/L-88/2006, neni 3.1.- 3.3 dhe neni 4.1 dhe Rregulloren mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje (Rregullorja numër 5/2008), neni 1 dhe 2 (më tej: “Rregullorja”).

Udhëzuesi synohet të shfrytëzohet si mjet teknik për procedurën e identifikimit të kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore që duhet të vendosen nën mbrojtje të përkohshme (sipas LTK, neni 3). Për më tepër, informacioni i dhënë në inventarizim duhet të shfrytëzohet si një bazë të dhënash për asetet e

trashëgimisë kulturore që përzgjidhen për mbrojtje të përhershme (sipas LTK, neni 4).

- Terminologjia dhe përkufizimet

Paragrafi i parë i udhëzuesit (“përkufizimet”) specifikon kategoritë e ndryshme të aseteve të trashëgimisë kulturore, të ndihmojë përpiluesit dhe shfrytëzuesit e inventarizimit në përcaktimin e procedurave të duhura për tu përcjellur. Në përgjithësi, përkufizimet janë ato të përdorura në LTK-në.

Tri kategoritë kryesore të trashëgimisë kulturore janë vënë në listë në udhëzues – asetet e trashëgimisë kulturore të paluajtshme, asetet (objektet) e trashëgimisë kulturore të luajtshme dhe asetet (elementet) e trashëgimisë kulturore shpirtërore.

Kategoria e aseteve të paluajtshme të trashëgimisë kulturore e paraqitur në udhëzues perputhet me parimin kryesor të klasifikimit të trashëgimisë të dhënë në LTK (neni 2) lidhur me llojet e ndryshme të trashëgimisë (trashëgimia arkitekturore, trashëgimia arkeologjike dhe peizazhi kulturor). Ideja është që të krijohet një sistem i përbërë me informacione të harmonizuara për këto lloje të ndryshme të trashëgimisë kulturore të paluajtshme. Termat e sugjeruara për asetet e luajtshme të trashëgimisë kulturore (objektet dhe/ose materiali) dhe për asetet (elementet) e trashëgimisë kulturore shpirtërore, janë konform konventave ndërkombëtare dhe praktikave të mira.

Për të identifikuar kategoritë e aseteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme informata me të detajuara janë shtjelluar tema të veçanta nga LTK (neni 2). Konsiderohet se qasja në lidhje me terminologjinë dhe përkufizimet e shfrytëzuara në LTK është pak a shumë në përputhje me konventat përkatëse ndërkombëtare,¹ por përkufizimi i llojeve të caktuara të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, të tilla si “zona konservuese arkitekturore” (LTK, neni 2, 2.2. c) nuk është i qartë sepse pothuaj i njëjti përkufizim jepet dhe për kategorinë e peizazhit kulturor (LTK, neni 2, 2.4). Me qëllim që të jetë më i kuptueshëm për shfrytëzuesit dhe gjithashtu në pajtueshmëri me terminologjinë aktuale të LTK-së, në udhëzues është dhënë përkufizimi i “zonës konservuese arkitekturore” si kategori e trashëgimisë kulturore që përfshin vendndodhjet/kytetet historike ose qendrat urbane/rurale.

1 Konventa e UNESCO-s mbi Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore (Paris, 1972), Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitekturore të Evropës (Granadë, 1985), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike (e ripunuar), Vateja 1992 dhe Konventa mbi Rajonet Peizazhore (Firencë, 2000).

Termet e përdorura në LTK për përkufizimin e trashëgimisë arkeologjike: “trashëgimia arkeologjike” (neni 7.1), “objektet e palujtshme arkeologjike” (neni 7.2) dhe “objektet e luajtshme arkeologjike” (neni 7.2; 7.3) janë në pajtueshmëri me përkufizimin e Konventës së Valetës, duke përfshirë “të gjitha mbetjet dhe objektet dhe çdo gjurmë tjetër të njerëzimit nga epokat e kaluara”² por meqë këto përkufizime të përgjithshme janë mjaft të paqarta, koncepti i udhëzimit rekomandon përkufizime më të sakta të trashëgimisë së palëvizshme arkeologjike, duke e dhënë termin “lokacion arkeologjik” në vend të “palëvizshme” i cili tanimë është shfrytëzuar për t’i klasifikuar tri kategoritë kryesore të trashëgimisë dhe gjithashtu për arsye se kur ne flasim për “objektin” atëherë kjo është më shumë e lidhur me trashëgiminë e lëvizshme,³ tsesa me veçoritë strukturore të trashëgimisë arkeologjike apo të ndonjë kategorie tjetër të trashëgimisë së paluajtshme (të ndërtuar). Termi “lokalitet arkeologjik” përfshinë veçoritë arkitekture/strukturore të gërmuara, apo të gjetura si elemente pjesërisht të përfaqësuara/ruajtura që nuk mund të konsiderohen si elemente (objekte) individuale, të veçanta të trashëgimisë në kontekst më të gjerë të ambientit, do të thotë se ato dëshmojnë për praninë e një numri të ndërtesave (monumenteve), vendbanimeve apo të ndonjë lloji tjetër strukture (dhe infrastrukture) të lidhur me jetën e organizuar të njerëzve në të kaluarën në lokacionin në fjalë. Ky lloj i inventarizimit duhet gjithmonë të marrë parasysh kompleksitetin e elementeve strukturore që do të mbrohen dhe paraqiten *in situ*.

Sa i përket kompleksitetit të procesit të hulumtimit arkeologjik dhe procedurave për mbrojtjen dhe prezantimin e gjetjeve arkeologjike në pajtueshmëri me termin e përdorur në ligj për “objektet e luajtshme arkeologjike” (neni 7.3.), udhëzuesi trajton veçmas procedurën e inventarizimit të lokacionit arkeologjik dhe procedurën e inventarizimeve të objekteve arkeologjike si asete të lëvizshme të trashëgimisë kulturore, të cilat janë larguar nga lokacioni i tyre i parë gjatë gërmimeve të programuara, ose të cilat janë gjetur rastësisht dhe trajtuar nga LTK-ja si “zbulime të rastësishme arkeologjike” (neni 7.8.). Këto gjetje zakonisht bëhen pjesë e koleksionit përkatës ekzistues të një muzeu/galerie ose formojnë një koleksion të ri *in situ* (në vend të ngjarjes). Procedura e inventarizimit të “objekteve arkeologjike” në udhëzues është e njëjtë me atë për kategoritë

e tjera të aseteve të trashëgimisë së luajtshme. Logjikisht, informacioni i detyrueshëm për t’u dhënë në situatën kur është i njohur lokaliteti arkeologjik nga i cili janë larguar objektet janë shënimet përcjellëse për veçoritë/elementet e lokacionit të parë dhe shënimet përcjellëse për koleksionin (et) të citave ato u takojnë brenda sistemit të inventarit të muzeut/galerisë përkatëse. Informacion i njëjtë duhet të jepet në seksionet e shënimeve përcjellëse të inventarit të lokacionit përkatës arkeologjik. Sidoqoftë, kjo çasje duhet marrë parasysh lidhur me trashëgiminë e paluajtshme sa herë që është e mundshme.

Procedura e inventarizimit të kategorisë së “rezervateve arkeologjike” (LTK, neni 7.11–7.14) nuk është trajtuar në mënyrë të posaçme në udhëzues. Duke pasur parasysh informacionin e kufizuar lidhur me këtë lloj trashëgimie “të ruajtur *in situ* për gjeneratat e ardhshme”, përpiluesit duhet të sigurojnë sa më shumë informacion të jetë e mundur duke shfrytëzuar procedurën e inventarizimit të lokalitetit arkeologjik.

Rekomandimi i UNESCO-s lidhur me nevojën për të caktuar shtrirjen e (apo vënien në hartë të) “rezervatit arkeologjik”⁴ do të mund të jepej në pjesën e udhëzuesit “Toka/njësia kadastrale”, p.sh. ngastra (t) kadastrale brenda perimetrit të përcaktuar apo propozuar dhe “ngastra kadastrale brenda zonës (ve) të mbrojtura të përcaktuara, ose të propozuara” dhe në dokumentacionin mbështetës teknik (hartë/program) të paraqitur në pjesën: “Dokumentacioni mbështetës”. I njëjti informacion do të mund të jetë i dobishëm për kategorinë e “peizazhit kulturor”, veçanërisht nëse ai gjendet në zonën periferike dhe gjithashtu për lokacionin arkeologjik, ansamblin e monumenteve dhe zonën konservuese arkitekture.

Në pikëpamje të kompleksitetit të tij përkufizimi i “peizazhit kulturor” në udhëzues është i sqaruar më detajisht duke konsultuar Shtojcën për Udhëzime Operacionale të UNESCO-s 3. Peizazhi kulturor është ndarë në tri pjesë: a) peizazhi i projektuar dhe i krijuar qëllimisht nga njeriu; b) peizazhi i zhvilluar organikisht dhe c) peizazhi asociativ kulturor. Shpjegimi i përkufizimit jepet në pjesën hyrëse të udhëzuesit (“Përkufizimi”). Detaje me specifike janë dhënë në pjesët “Kategoria dhe lloji(et)” dhe “Përshkrim” i inventarit të aseteve të paluajtshme të trashëgimisë kulturore.

Me qëllim të përcaktimit të proceduarve korresponduese të in-

² Konventa e Valetës, neni 1.3.

³ “Objektet arkeologjike” të njohura si objekte të luajtshme nga rekomandimi i UNESCO-s lidhur me shkëmbimin ndërkombëtar të pasurisë kulturore (e miratuar në Najrobi, 26 nëntor 1976, neni 1).

⁴ Rekomandimi i UNESCO-s lidhur me ruajtjen e pasurisë kulturore të rrezikuar nga punët publike apo private, 19 nëntor 1968 (neni 24 a)

evntarizimit, udhëzuesi definon asetet e trashëgimisë kulturore të luajtshme sipas llojeve të ndryshme të objekteve që do të regjistroheshin dhe vendet ku do të vendosen, kërkohen apo paraqiten. Neni 1.3, neni 2.5 dhe veçanërisht neni 9 i LTK përshkruajnë objektet e luajtshme të llojeve të ndryshme në linjë me dokumentet ndërkombëtare relevante,⁵ por pa bërë klasifikim, do të thotë bazën e kritereve për përzgjedhje. Madje edhe rregullorja nuk siguron përkufizim më specifik të objekteve të luajtshme që do të mund t'u jepnin orientim të qartë përpiluesve.

Udhëzuesi rekomandon disa lloje të inventarizimeve për trashëgiminë e luajtshme duke shfrytëzuar kriteret e ndryshme për përzgjedhje (klasifikim) të objekteve, me sqarim të detajuar të secilës nga kategoritë vijuese: “objektet arkeologjike”, “objektet etnologjike”, “objektet historike”, “objektet e artit”, “objektet teknike”, “materiali arkivor”, “materiali bibliotekar”, “materiali audio-vizual” dhe “materiali arkivor i zërit të regjistruar (fonogrami)”. Kjo qasje do të mund të ishte e dobishme për zhvillimin e sistemit të unifikuar të veprimit në kategoritë/llojet e ndryshme të trashëgimisë së lëvizshme, kryesisht në sistemin e inventarizimeve për mbrojtjen e trashëgimisë. Ky klasifikim rekomandohet të bëhet nga palët e ndryshme në sistemin kombëtar të informimit duke pasur parasysh se ka shumë kritere specifike për identifikimin e kësaj kategorie të trashëgimisë në sistemet e informimit të muzeve/galerive. Shënime të përcjellëse në sistemin e informimit për koleksionin përkatës në muze/galeri janë të detyrueshme.

Përkufizimi i përdorur i aseteve të trashëgimisë shpirtërore në LTK (neni 10) përfshinë të gjitha “shprehjet” e traditave popullore. Duhet përmendur që të dyja LTK-ja dhe rregullorja përdorin terminologji të ndryshme për këtë kategori të trashëgimisë kulturore nga ajo e përdorur në konventën përkatëse, pra në Konventën e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (Paris, 2003). Pastaj, në këto dy rregullore të Kosovës mbi trashëgiminë kulturore nuk ka klasifikim të llojeve të ndryshme të “shprehjeve” dhe ndonjë të dhënë mbi parimet kryesore të konventës përkatëse: 1. “shprehjet” të njohura si një trashëgimi e gjallë; 2. komunitetet/grupet e krijuesve/ekzekutuesve, që njihen si faktor vendimtar për vlerësim, ruajtje dhe zhvillim të kësaj kategorie të trashëgimisë kulturore.

Duke marrë parasysh politikat e zhvilluara për këtë kategori

5 Rekomandimi lidhur me mbrojtjen e pasurisë së lëvizshme kulturore, i miratuar nga UNESCO në Paris, 28 nëntor 1978 (neni 1); Rekomandimi lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e imazheve lëvizëse, i miratuar nga UNESCO në Beograd, 27 tetor 1980 (neni 1.3)

të trashëgimisë, udhëzuesi rekomandon klasifikimin, pra inventarizime në dy (nën) kategori kryesore të trashëgimisë jomateriale: 1. inventarizimet e elementeve të folklorit dhe zejtarisë tradicionale, dhe 2. inventarizimet e elementeve të traditës gojore.

- Procedura e inventarizimit

Hartimi i inventarizimit është i lidhur ngusht me procesin e mbrojtjes së trashëgimisë. Meqë procedura e inventarizimit në udhëzues trajton veçanërisht identifikimin e asetit të trashëgimisë kulturore që do të jetë nën mbrojtje ligjore, (te evidentohet sipas LTK) informacioni i kërkuar përzgjidhet kryesisht për këtë qëllim.⁶ Shtrirja e informacionit të kërkuar sygjerohet të jete me shume ne forme te regjistrimit “preliminar” sesa nje regjistrim me vizatime i cili do ta ngadalson te procesin e listimit. Standartet ndërkombëtare lidhur me indeksin bazë të të dhënave për kategoritë e ndryshme të aseteve të palëvizshme dhe të lëvizshme kulturore, të paraqitura në Udhëzuesin mbi Inventarizimin dhe Dokumentimin e Trashëgimisë Kulturore të publikuar nga Këshilli i Evropës,⁷ janë parashikuar për pothuaj të gjitha seksionet e rekomanduara që kanë të bëjnë me përpilimin e inventarit të aseteve të palëvizshme dhe të lëvizshme të trashëgimisë kulturore. Udhëzuesi nuk siguron procedurë të veçantë inventarizimi për secilin lloj të aseteve të trashëgimisë së palëvizshme apo lëvizshme, por seksionet do të mund të përshtateshin apo zhvilloheshin në një mënyrë që pasqyron në mënyrë të përshtatshme kompleksitetin e aseteve kulturore si të tilla dhe specifikat e kërkesave.

Rekomandohet që qasja në kategorinë e “peizazhit kulturor” të jetë në pajtueshmëri me kriteret dhe procedurat e inventarizimit (apo procedurën tjetër rregulluese) të caktuar për trashëgiminë natyrore, ku “ndërveprimi i njeriut dhe natyrës” është karakteristik kryesor e kësaj kategorie të trashëgimisë të njohur nga Konventa Evropiane për Peizazhin (Firencë, 2000, neni 1, a). Përpiluesit duhet ndjekur të njëjtën qasje metodologjike për kategorinë e “zonës konservuese arkitekturore,” të trajtuar në

6 Hapi tjetër në këtë proces është krijimi apo rishikimi i bazës së të dhënave të inventarit sipas procedurës së caktuar me aktin/rregulloren e veçantë mbi statusin ligjor të së mirës kulturore nën mbrojtje të përhershme (e shënuar në listën e trashëgimisë kulturore) e cila do të pasojë rregulloren ekzistuese mbi regjistrimin, dokumentimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore për mbrojtje, veçanërisht pjesën e rregullores që lidhet me vlerësimin dhe implementimin e kritereve për përzgjedhje.

7 Botimi i përdorur është ribotim nga viti 2009; ai pason analizën mbi inventarizimin dhe dokumentimin të publikuar në: R. Thornes, J. Bold, Dokumentimi i Trashëgimisë Kulturore, Poll Getty Trust, 1998

mënyrë specifike në procesin e konservimit të integruar, sa i përket kriterëve dhe procedurave për rregullimin e sektorit të planifikimit urban/hapësinor. Është e qartë se në këto raste puna në ekip e profesionistëve që vijnë nga sektorët përkatës (mbrojtja e trashëgimisë kulturore, planifikimi hapësinor urban/rural/ dhe mbrojtja e trashëgimisë së natyrës) është esenciale.

Një nga seksionet që kanë të bëjnë me inventarizimin e aseteve të paluajtshme të trashëgimisë kulturore në të cilin rekomandimi shkon drejt informimit më të detajuar është ai mbi të dhënat kadastrale. Ka disa arsye për ta bërë këtë. Para së gjithash, informatat kadastrale janë të rëndësishme jo vetëm për pozicionin e monumentit brenda planit përkatës urban, të rëndësishme për trajtimin e tij në planifikimin e ardhshëm, por gjithashtu edhe për informimin e pronarëve të aseteve në mënyrë që të dijnë se cila pjesë e pronës së tyre planifikohet të jetë nën mbrojtje ligjore dhe çfarë regjimi mbrojtjeje duhet të ndjekë ajo, sepse LTK-ja parashikon procedurën e regjistrimit të trashëgimisë së palëvizshme kulturore të mbrojtur të përfshirë në listën e trashëgimisë kulturore (nën mbrojtje të përhershme) të Agjencisë Kadastrale dhe Gjeodezike të Kosovës në nivel lokal dhe qendror (LTK, neni 4.6). Megjithatë LTK-ja nuk mori parasysh mendimin e pronarëve mbi këtë çështje,⁸ pronari ka (së paku) një të drejtë ligjore të informohet se çfarë është dhe çfarë mund të jetë obligimi i tij/saj në menaxhimin e pronës. Për më tepër, LTK-ja ka për detyrë të caktojë “perimetritin” dhe “zonën e mbrojtur” apo “hapësirën e mbrojtur” të asetit të mbrojtur të trashëgimisë kulturore, asaj arkeologjike apo arkitekturore (neni 2.20–22; 6.3, 6.4) përkatësisht numrin (at) konkret të ngastrave kadastrale (apo pjesë të tyre) meqë kjo u intereson pronarëve të ndërtesave (trashëgimia arkitekturore) ose të tokës (trashëgimia arkeologjike), por gjithashtu planifikuesve që janë të përfshirë në përgatitjen e propozimeve (sipas ligjit mbi planifikimin hapësinor).⁹

Seksioni që ka të bëjë me statusin ligjor të aseteve të trashëgimisë kulturore, siç rekomandon udhëzuesi, është në pajtueshmëri me situatën specifike në legjislacionin e Kosovës mbi trashëgiminë kulturore. Procedura e re ligjore në lidhje me këtë çështje (LTK i vitit 2006) dhe gjendja e trashëgimisë kulturore, e shkatërruar apo dëmtuar në konflikt, e detyruan MKRS-në të ndërmarrë një veprim për (ri) vlerësimin e trashëgimisë së

mbrojtur kulturore sipas procedurave të sistemit të mëparshëm (Jugosllav) të mbrojtjes ligjore, i cili duket sikur ka filluar përsëri një proces të ri inventarizimi. Historiku i statusit ligjor dhe i dokumentacionit përcjellës (aq sa është në dispozicion) do të mund të ishin shumë të dobishëm për observim të përpiluesve “të rinj” në rrethana të reja.

Arsyeja tjetër për t’u rekomanduar ky seksion është e lidhur me fazën tjetër të procedurës ligjore për status mbrojtjeje të përhershme. Gjatë procesit të përpilimit të inventarit përpiluesit mund të njihen me elementet e rëndësishme të trashëgimisë kulturore në pyetje të cilat duhet të zhvillohen, duke paraqitur argumentet kryesore për procedurën e ardhshme lidhur me trashëgiminë kulturore nën mbrojtje të përhershme. Ky rekomandim duhet të merret si i rëndësishëm në aktivitetin e planifikuar të MKRS-së për përzgjedhjen e trashëgimisë kulturore që është në procedurë për fitimin e statusit ligjor për mbrojtje të përhershme. Ky lloj observimi duhet marrë parasysh edhe në procedurën e kundërt ligjore, pra në procedurën e largimit nga lista e trashëgimisë të një objekti trashëgimie nëse veçoritë/elementet e vlefshme të trashëgimisë sipas të cilave është njohur dhe mbrojtur trashëgimia konsiderohen se janë humbur dhe nuk mund të kthehen.

Seksioni lidhur me llojin e ndryshëm të “dokumentacionit” që duhet për të mbështetur informatat për inventarin e seksioneve të tjera ka të bëjë pak a shumë me informacionin elementar, ose atë që tanimë ekzistojnë (kopjet e dokumentacionit ekzistues), ose me informacionin që mund të përpilohet për një kohë të shkurtër, të tilla si skica të dokumentacionit teknik, fotografi të gjendjes aktuale, kopje të dokumenteve, kopje të intervistave të regjistruara, filma etj.

Sa i përket procedurës së inventarizimeve të elementeve kulturore shpirtërore situata është më e komplikuar jo vetëm pse rregulloret kosovare nuk kanë perceptuar kompleksitetin e aktiviteteve lidhur me këtë kategori të trashëgimisë, por edhe për shkak të përvojave të ndryshme në zbatimin e konventës relativisht të re (Konventa e UNESCO-s për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale, Paris 2003) në vendet me traditë më të gjatë në njohjen dhe mbrojtjen e kësaj kategorie të trashëgimisë.

Në rastin e Kosovës, ashtu si në disa vende të tjera në rajon, një nga gabimet më të mëdha është që komunitetet/grupet madje as nuk janë marrë parasysh në procedurën e inventarizim-

⁸ Parashikon vetëm procedurën e njoftimit për pronën brenda listës së trashëgimisë kulturore që duhet t’i bëhet pronarit në formë të shkruar përmes shpalljes në gazetën zyrtare brenda 28 ditësh (LTK, neni 4, 4.7)

⁹ “Zona mbrojtëse” dhe “hapësira mbrojtëse”, të sqaruara në udhëzues (paragrafi 1), përkufizohen në nenin 2 të ligjit mbi planifikimin hapësinor (ligji numër 2003/14)

it. Problemi kryesor është që institutet për mbrojtje nuk kanë burime të përshtatshme për këtë procedurë në mënyrë që ajo të ndërmerret dhe të kryhet vetëm nga ta. Pothuaj të gjitha ata janë të fokusuara në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e trashëgimisë materiale (të paluajtshme dhe të luajtshme).

Në këto rrethana, udhëzuesi sugjeron një procedurë inventarizimi që u drejtohet

(a) komuniteteve/grupeve përkatëse të krijuesve/zejtarëve/ekzekutuesve, të cilët, nëse trajtohen në mënyrën e duhur në sistemin e mbrojtjes ligjore do të mund të jepnin informacione të duhura mbi manifestimin e “trashëgimisë së tyre të gjallë” dhe (b) gjithashtu u adresohet institucionit (eve) të caktuara shkencore të cilat duhet të vlerësojnë informatat e mbledhura dhe të rekomandojnë që elementi i identifikuar kulturor të jetë nën mbrojtje ligjore. Institucioni kompetent për trashëgimi kulturore (brenda MKRS) duhet të paraqesë inventarizimin e përfunduar në sistemin e informimit dhe të fillojë procedurën e mbrojtjes ligjore. Prandaj seksioni “Statusi ligjor/mbrojtës” për këtë kategori të aseteve të trashëgimisë nuk ofron medoemos informata për procedurën e mbrojtjes së përkohshme dhe/ose të përhershme të trashëgimisë. Rekomandimet janë që ky aset i trashëgimisë të mbrohet menjëherë, duke ofruar përfitime për komunitetet dhe/apo individët nga statusi i tij ligjor.

Procedura specifike e inventarizimit të trashëgimisë shpirtërore në udhëzues thekson bashkëpunimin e komuniteteve/grupeve të individëve, OJQ-ve, çfarë do të thotë gatishmërinë dhe pajtimin e tyre për të qenë pjesë e sistemit për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, siç ka vënë në dukje konventa.

Pothuaj të gjitha seksionet e këtij lloji të inventarizimit të rekomanduar në udhëzues janë produkt i përpilimit të procedurave të shfrytëzuara për inventarizime në vendet me përvojë në këtë fushë, shumica prej tyre me një trashëgimi të shquar jomateriale, të shpallura edhe si kryevepra të trashëgimisë botërore.

UDHËZUESI

- Përkufizime:

1. “Inventarizim” është aktiviteti i hulumtimit zyrtar për regjistrim paraprak dhe dokumentim të aseteve të trashëgimisë kulturore. Ai paraqet bazën mbi të cilën mund të bëhet një vlerësim (a) për të përcaktuar nëse aset i duhet të mbrohet me ligj apo jo, dhe (b) për të përgatitur planin për konservimin e tij me anë të të cilit vlera e tij mund të sigurohet në mënyrë të përhershme

2. “Aseti i trashëgimisë së paluajtshme kulturore” përfshin llojet e ndryshme të trashëgimisë arkitekturore, strukturave të trashëgimisë arkeologjike dhe veçorive të peizazhit kulturor.

3. “Monumenti” nënkupton punët individuale arkitekturore, punimet e skulpturave monumentale dhe pikturave, elementet e strukturës së natyrës arkeologjike, vendbanimeve në shpellë etj.

4. “Ansambël ndërtesash” nënkupton grupe të ndërtesave të ndara ose të koncentruara që dallohen për nga vlerat e arkitekturës së tyre, homogjenitetit, ose vendit që zënë në mjedis.

5. “Zonë konservuese arkitekturore” nënkupton zonën që përbëhet nga puna e kombinuar e duarve të njeriut dhe natyrës me vlera të dallueshme historike, arkeologjike, artistike, sociale, ekonomike ose të interesit teknik, siç janë: nukleuset urbane apo rurale dhe qytetet/lokacionet historike me hapësira dhe infrastrukturë në ambientit të tyre,

6. “Peizazhi kulturor” nënkupton një zonë, siç perceptohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimt dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe njerëzorë. Ai mund të definohet si zone e veçantë në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Planifikim Hapsinor (ligji Nr. 2003/14). Përfshinë:

a) peizazh i projektuar dhe i krijuar nga njeriu: park, kopsht frutor, kopsht për rekreacion, shesh publik, shesh, varrezë, oborr;

b) peizazh i zhvilluar organikisht: relikth apo fosil, gjurmë të vjetra të prodhimit bujqësor në mjete natyrore, shfrytëzimet e tokave;

c) peizazhi asociativ kulturor: i lidhur me elementet fetare/kulturore/natyrore, siç janë: produktet tradicionale dhe ndikimi i tyre në peizazh; ansamblet industriale të vendit, sistemet e lidhura me energjinë; vendet dhe zonat që janë të rëndësishme për historinë e vendit dhe popullin e tij, të tilla singjarjet e rëndësishme, vendlindjet, fushat e betejës; besimi,

kultet, ritet tradicionale.

7. "Lokalitet arkeologjik" nënkupton një zonë ose vend në të cilin janë evidente manifestimet e aktiviteteve njerëzore në të kaluarën në strukturat dhe mbetjet e të gjitha llojeve për të cilat metodat arkeologjike ofrojnë informata parësore,

8. "Perimetri i një monumenti" nënkupton kufirin e zonës së mbrojtur të lidhur me asetin kulturor të mbrojtur që duhet të definohet në plan nga Institucioni kompetent,

9. "Zonë mbrojtëse" nënkupton një zonë të tokës siç është e definuar në nenin 3 të Ligjit për Planifikim Hapsinor (Ligji Nr. 2003/14) e cila rrethon perimetrin e asetit të mbrojtur të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që e ruan nga ndonjë zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë integritetin e saj, vendosjen saj të dukshëm ose dëmtim tjetër.

10. "Hapësirë e mbrojtur" nënkupton një zonë e cila mund të përfshijë burime natyrore apo ambientale të mbrojtura, ose trashëgiminë e paluajtshme kulturore të mbrojtur siç është e definuar në nenin 12.2 të Ligjit për Planifikim Hapsinor (Ligji Nr. 2003/14).

11. "Objektet arkeologjike" nënkuptojnë të gjitha të gjeturat e çfarëdo lloji ose materiali, nga gërmimet në tokë dhe të nxjerrura nga uji, të cilat vijnë nga periudhat që janë lëndë e arkeologjisë dhe shkencave të saj ndihmëse.

12. "Objektet etnologjike" nënkuptojnë asetet e luajtshme të lidhura me mënyrën e jetesës, aktivitetet, shprehitë, ritualet, besimet, idetë dhe veprat të cilat janë të nevojshme për të kuptuar karakteristikat etnike dhe ndryshimet në kulturën materiale dhe jomateriale të popullatës së Kosovës.

13. "Objektet historike" nënkuptojnë asetet e luajtshme të lidhura me (i) ngjarjet e rëndësishme historike apo aktivitetet kulturore, të çlirimit kombëtar, revolucionare dhe lëvizjeve dhe organizatave tjera politike, (ii) arsimore, kulturore, shkencore, fetare, sportive dhe institucioneve dhe të asociacioneve tjera, (iii) jeta dhe puna e personave të dalluar, (iv) antikitetet të cilat nuk u takojnë llojeve të tjera të trashëgimisë kulturore të luajtshme më të vjetër se 50 vjet.

14. "Objektet e artit" nënkuptojnë veprat e luajtshme të artit në fushën e arteve të bukura, të tilla si pikturat dhe vizatimet e bëra me dorë, në ndonjë bazë apo nga ndonjë material, dizajni industrial dhe prodhimet industriale me ornamente të punuara me dorë, veprat origjinale skulpturore, krijimet artistike dhe rregullimet në çfarëdo materiali, gravura origjinale, pllaka bakri, litografi dhe shtyp tjetër, posterët origjinal dhe fotografitë si një mënyrë e krijimit origjinal dhe veprat e artit aplikativ të bëra nga çfarëdo materiali.

15. "Objektet teknike" nënkuptojnë prodhimet e kulturës teknike, të lidhura me fazat e rëndësishme të progresit teknik, të tilla si makinat, mjetet, instrumentet, pajisjet, mjetet e transportit etj.,

16. "Materiali arkivor" nënkupton tërë materialin e kulturës teknike, autentik dhe të riprodhuar e me vlerë të përhershme dhe me rëndësi për shtetin, shkencën, kulturën dhe nevojat tjera.

17. "Materiali bibliotekar" nënkupton dorëshkrimet e vjetra (shqipe, sllave apo dorëshkrimet në gjuhë tjera) të cilat i referohen Kosovës, të bëra deri në fund të shek. XIX, hartat e vjetra dhe atlaset e Kosovës,¹⁰ tërësitë e veçantive bibliotekare të cilat rrjedhin nga institucionet arsimore, kulturore, shkencore, fetare dhe institucione të tjera në Kosovë, librat e rrallë dhe çdo material tjetër të rrallë bibliotekar të përcaktuar me ligj, dhe nga bibliotekat familjare dhe personale të rëndësishme shkencore apo kulturore, modelet obligative të publikimeve, shënimeve, subjekteve, materialit filatelik ose të ndonjë materiali tjetër me status për publikim.

18. "Materialet audio-vizuale" nënkuptojnë materialin origjinal të punës kinematografike, p.sh. negativin e një fotografie ose ton-negativin e një filmi dhe kopjen e tonit të një emisioni të posaçëm, të animuar, dokumentari popullor dhe të filmave të tjerë, pajisjet me apo pa zë pavarësisht nga teknika e incizimit së bashku me dokumentacionin e filmit (skenarin, librat, kostumin dhe materialin e skenarit, reklamat e filmit etj.) dhe modelin obligativ që i jepet institucionit kompetent filmik.

19. "Materiali arkivor i zërit të incizuar (fonogrami)" nënkupton materialin origjinal të zërave të incizuar, p.sh. incizimet orale, origjinale, muzikore apo të tjera të zërit, ose kopjet e tyre, pavarësisht nga forma, teknika e zërimit apo lloji i medias, duke përfshirë modelin obligativ të fonogramit, i cili po ashtu duhet t'i jepet institucionit kompetent sipas ligjit.

20. "Elementet kulturore shpirtërore" nënkuptojnë përvoja, përfaqësim, shprehje, dije dhe shkathtësi specifike, duke përfshirë instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to.

10

Ligji në fjalë duhet të përcaktojë periudhën specifike.

- **INVENTARËT E KATEGORIVE TË NDRYSHME TË ASETVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE**

- I. Intari i asetit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme
- II. Inventari i asetit të trashëgimisë kulturore të luajtshme
- III. Inventari i asetit të trashëgimisë kulturore shpirtërore

I. Inventari i aseteve të trashëgimisë kulturore të paluajtshme

- 1. Inventari i monumentit
- 2. Inventari i ansamblit të ndërtesave
- 3. Inventari i zonës konservuese arkitekturore
- 4. Inventari i lokalitetit arkeologjik
- 5. Inventari i rezervatit arkeologjik
- 6. Inventari i peizazhit kulturor

II. Inventari i aseteve të trashëgimisë kulturore të luajtshme

- 1. I. Inventari i objekteve arkeologjike
- 2. Inventari i objekteve etnologjike
- 3. Inventari i objekteve historike
- 4. Inventari i objekteve të artit
- 5. Inventari i objekteve teknike
- 6. Inventari i materialit arkivor
- 7. Inventari i materialit bibliotekar
- 8. Inventari i materialit audio-vizual
- 9. Inventari i materialit arkivor të zërit të inçizuar (fonogrami).

III. Inventari i aseteve të trashëgimisë kulturore shpirtërore

- 1. Inventari i elementeve të folklorit dhe zejtarisë tradicionale
- 2. Inventari i elementeve të traditës gojore

I. PËRMBAJTJA E INVENTARIT TË ASETVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE TË PALUAJTSHME¹¹

Inventarët e aseteve të trashëgimisë së paluajtshme përmbajnë informacionin vijues:

- 1. Emri dhe referencat
- 1.1. Emri i asetit të trashëgimisë kulturore

(emri i asetit të trashëgimisë kulturore me të cilin njihet aseti)

- 1.2. Emri i institucionit/organizatës e cila mbledh dhe ofron informacion për inventarin (emri, adresa)
- 1.3. Emri i personit (ave) të cilët mbledhin dhe ofrojnë informacion për inventarin (emri, aftësitë profesionale dhe pozita)
- 1.4. Data(t) e përpilimit dhe/apo sigurimit të informacionit për inventarin
- 1.5. Numri i inventarit dhe/apo numri unik i referencës (numri apo kombinimi i karaktereve të citat e identifikojnë në mënyrë unike secilën ndërtesë apo elemente/veçori natyrore-veçanërisht për ansamblin e ndërtesave, zonën konservuese arkitekturore, lokacionin arkeologjik, rezervatin arkeologjik, peizazhin kulturor)
- 1.6. Shënimi përcjellës për të dhënat përkatëse
 - 1.6.1 Shënimi përcjellës për të dhënat rreth ndërtesave/monumenteve individuale (në veçanti trashëgimia e trajtuar si një pjesë e ansamblit të monumenteve, zonës konservuese arkitekturore, lokalitetit arkeologjik, ose peizazhit kulturor)
 - 1.6.2. Shënimi përcjellës për të dhënat e lidhura me trashëgiminë ambientale/natyrore (në veçanti trashëgimia e trajtuar si një pjesë e zonës konservuese arkitekturore, lokalitetit arkeologjik, rezervatit arkeologjik apo peizazhit kulturor)
 - 1.6.3. Shënimi përcjellës për të dhënat e lidhura me koleksionet arkeologjike dhe artefaktet
 - 1.6.4. Shënimi përcjellës për të dhënat karakteristike dhe pajisjet ose objektet (pikturat murale, dekorimi skulpturor nga guri/mermeri, karakteristikat e drugdhendjes etj. të lidhura me ndërtesën(at) apo ambientin e monumentit/lokacionit në pyetje)
 - 1.6.5. Shënimi përcjellës për dokumentacionin përkatës

¹¹ Titujt/seksionet 1,3,5 dhe 6 janë të detyrueshëm

- 1.6.6. Shënimi përcjellës për planin urban dhe hapësinor (emri i planit, komuniteti/komuna përgjegjëse për të siguruar planin (et) urban apo hapësinor në nivel qendror dhe lokal, dhe referencat tjera të lidhura me sistemin (et) e planifikimit në territorin e trashëgimisë në fjalë)
2. Dëshmia e rëndësisë (Përshkrim/shpjegim i rëndësisë së asetit në një tekst të shkurtër)
3. Kategoria dhe lloji (et)
 - 3.1. Kategoria (monument, ansambël i monumenteve, zonë konservuese arkitekturore, lokalitet apo rezervat arkeologjik, peizazh kulturor)
 - 3.2. Lloji (xhami, kishë, manastir, tyrbe (varrezë), objekte banimi, industriale, administrative, rekreative, ura, shpella, etno-park apo zonë/rajon, park arkeologjik, kopsht, vend i një ngjarjeje historike)
 - 3.3. Tipi (et) funksional (fetar, profan, veçori/elemente të kombinuara të trashëgimisë kulturore dhe natyrore (peizazh kulturor)
 - 3.2.1. Funksioni i parë
 - 3.2.2. Ndryshimet e funksionit në të kaluarën
 - 3.3.3. Funksioni i tanishëm
4. Statusi mbrojtës/Ligjor¹²
 - 4.1. Lloji i statusit mbrojtës/Ligjor (përkohësisht i mbrojtur, nën mbrojtje të përhershme, i pambrojtur)
 - 4.2. Procedura e mbrojtjes (vendimi i aktit ligjor, emri i autoritetit që ka marrë vendimin dhe data e aktit ligjor në fuqi)
 - 4.3. Akti ligjor mbi amendamentin ose pezullimin e statusit mbrojtës (emri/titulli, autoriteti vendimmarrës).

5. Lokacioni:
 - 5.1. Lokacioni administrativ
 - 5.1.1. Njësia gjeopolitike ose rajoni (rajoni, shteti/vendi)
 - 5.1.2. Komuna, qyteza/qyteti/fshati/vendbanimi, distrikti, lokaliteti
 - 5.1.3. Adresa me të gjitha referencat përkatëse (emri postal, kodi postal, rruga, numri)
 - 5.1.4. Pozicioni i lokacionit (informata mbi lokacionin, duke u bazuar në hartën që tregon pozicionin e lokacionit si pjesë e dokumentacionit përcjellës të inventarit)
 - 5.2. Referenca kartografike (në veçanti koordinatat X, Y, Z).
 - 5.3. Referenca kadastrale/njësia e tokës
 - 5.3.1. Komuna (t) kadastrale¹³ (emri (t) i komunës, agjencisë kadastrale etj.)
 - 5.3.2. Ngastra (t) kadastrale¹⁴
 - 5.3.2.1. Ngastra (t) kadastrale me perimetër të përcaktuar apo propozuar të zonës mbrojtëse të monumentit, ansamblit të ndërtesave, lokalitetit arkeologjik¹⁵
 - 5.3.2.2. Ngastra (t) kadastrale me perimetër të përcaktuar apo propozuar të monumentit, ansamblit të ndërtesave, rezervatit arkeologjik, peizazhit kulturor¹⁶
6. Data
 - 6.1. Periudha kulturore dhe/apo kultura/stili

¹³ Nëse asemi i trashëgimisë së palëvizshme apo pjesë të tij, duke përfshirë zonën mbrojtëse apo një pjesë të saj, gjendet në territorin e dy apo më shumë komunave, të dhënat për një trashëgimi të tillë konsiderohen si pjesë e inventarit të përgjithshëm të komunës ku gjendet trashëgimia e tillë ose pjesë më të mëdha të saj.

¹⁴ Nëse trashëgimia në fjalë shtrihet në terren që nuk ka qasje, apo zona e propozuar për t'u mbrojtur është tepër e madhe të përcaktohet saktësisht (veçanërisht për rezervatin arkeologjik dhe llojin specifik të peizazhit kulturor), përpiluesi i këtij seksioni duhet të bëjë një përshkrim të terrenit. Një plan apo kopje e hartës përkatëse për shtrirjen (kufijtë) e propozuar të trashëgimisë duhet të paraqiten në seksionin: "Dokumentacioni përcjellës, 11.2-11.4" dhe t'i bashkangjiten inventarit.

¹⁵ Nëse perimetri i ndërtesës nuk është përcaktuar, duhet bërë një propozim, duke shfrytëzuar referencën kadastrale ose elementet e njohura të rrethinës së ndërtesës (rrethoja, orientimi në rrugë etj.) për përshkrim. Nëse perimetri është përcaktuar informatat duhet të përshkruhen duke shfrytëzuar referencat kadastrale si në vijim: kufiri lindor (ngastrat kadastrale numri...)/kufiri perëndimor(ngastrat kadastrale numri...)/kufiri verior(ngastrat kadastrale numri...)/kufiri jugor (ngastrat kadastrale numri...).

¹⁶ Nëse zonat e mbrojtura nuk janë përcaktuar, duhet bërë një propozim, duke shfrytëzuar referencën kadastrale dhe/ose elementet e njohura të rrethinës së ndërtesës për përshkrim, do të thotë kufijtë e perimetrit. Nëse për zonat e mbrojtura janë përcaktuar informatat duke shfrytëzuar referencën kadastrale për secilën nga zonat: p.sh.: kufiri i zonës mbrojtëse në lindje (ngastra kadastrale numri...)/kufiri i zonës së mbrojtur në perëndim (ngastra kadastrale numri...)/kufiri i zonës së mbrojtur në veri (ngastra kadastrale numri...)/kufiri i zonës mbrojtëse në jug(ngastra kadastrale numri...).

¹² Kërkohe informata nëse ka nevojë për përditësimin inventarit ekzistues të objektit kulturor, i kompiluar para vënies së tij në listë si trashëgimi kulturore (apo para ndërprerjes së statusit të tij të mbrojtjes me një vendim të organit/autoritetit përgjegjës

- 6.2. Shekulli
- 6.3. Data e përafërt
- 6.4. Data e saktë
7. Personi(at) dhe/apo organizata(t) e lidhur me historinë e trashëgimisë
 - 7.1. Personat dhe/ose vendet e punës
(morën pjesë në ndërtim, pikturim, drugdhendje apo në ndërtimin/krijimin e veçorive tjera të trashëgimisë-arkitektët, konstruktorët, piktorët, peizazhisti, kopshtari, etj.)
 - 7.2. Themeluesi, donatori, përkrahësi, zotëruesi
8. Përshkrimi
 - 8.1. Përshkrim i përgjithshëm i ndërtesës apo lokacionit (përshkrim i shkurtër me tekst)
 - 8.1.1. Veçoritë arkitekturore-ndërtimore (planimetria, organizimi hapësinor, elementet ndërtimore përcjellëse etj.)
 - 8.1.2. Pajisjet e paluajtshme dhe luajtshme (pikturat e murit, dekorimet skulpturore, drugdhendja, ikonostasi, mimbari, mihrabi, mobiliet)
 - 8.1.3. Karakteristikat e rëndësishme të rrethinës (shatërvani, kopshti, parku, rregullimet e shtigjeve, ose karakteristika të tjera të rëndësishme infrastrukturore dhe natyrore)
 - 8.2. Përshkrim i përgjithshëm i peizazhit kulturor
 - 8.2.1. Ambienti
(urban/rural/bujqësor/për kënaqësi/karakteristika të tjera të ambientit të ndërtuar ose natyror; kushtet ambientale: temperatura, klima, lagështia, erërat);
 - 8.2.2. Karakteristikat gjeografike
(vegjetacioni, fauna, topografia rajonale, gjeologjia, ekosistemi)
 - 8.2.3. Në rast të kopshteve: stili origjinal dhe kulturor
 - 8.2.4. Rugët, shtigjet, rugicat, shtigjet e ecjes/mekanike (dizajni)
 - 8.2.5. Elementet arkitekturore/arkeologjike
(ndërtesat, mbetjet nga strukturat, skulpturat dhe veprat e artit)
 - 8.2.6. Vegjetacioni
(pyjet/plantacionet natyrore; drunjtë, kaçubat)
 - 8.2.7. Uji
(lumenjtë/liqene/ shatërvane/pellgje/kanale/sistemi i ujitjes)

9. Pozita/gjendja
 - 9.1. Gjendja e përgjithshme
(përshkrim i shkurtër i gjendjes)
 - 9.2. Veçantia e pozitës
(shkalla e dëmeve: dëmtim apo humbje e strukturës, kulm që rrjedh; dobësim strukturor dhe jostabilitet; dëmtim i brendshëm; prezencë e lagështisë, aset i lënë pas dore etj.)
 - 9.3. Faktorët që ndikuan në tërësinë e trashëgimisë
(mungesa e mirëmbajtjes, mungesa e intervenimeve konservuese/restauruese, aseti i braktisur, infrastruktura jo e duhur, ndotja e ajrit, zhvillim i paqëndrueshëm i ambientit etj.).
 - 9.4. Ndërhyrjet në të kaluarën
(Lista dhe përshkrimi i shkurtër i gjurmimit, restaurimit/rindërtimit/riparimeve apo llojit tjetër të aktiviteteve mbrojtëse në të kaluarën)
 - 9.5. Plani i shpejtë i vlerësimit ¹⁷
10. Pronësia/zotërimi
 - 10.1. Lloji i pronësisë
(private, qeveria lokale/qendrore, institucionale, bamirësi; e pavendosur)
 - 10.2. Pronari (ët)
(emri(t)/emri i pronarit(ëve) dhe adresa)
 - 10.2.1. Baza ligjore e pronësisë
(kontrata, donacioni, lloj tjetër i marrëveshjes)
 - 10.3. Zotëruesi (t)
(emri (t)/emri i zotëruesit (ve))
 - 10.3.1. Baza ligjore për zotërim
(kontrata, bamirësi, lloj tjetër i marrëveshjes)
 - 10.3.2. Kohëzgjatja e shfrytëzimit

17 Përdorni planin vijues:

	1	2	3	4	5
Gjendja	E shkëlqyeshme	E mirë	E favorshme	E keqe	Shumë e keqe
Cenueshmëria	Mirë e menaxhuar	Pa asnjë kërcënim	Disa kërcënime të lokalizuara	Kërcënime të qarta për krejt lokacionin	Kërcënime të rënda
Trendi	Në përmirësim	E qëndrueshme	E qëndrueshme por me probleme të lokalizuara	Duke u dëmtuar apo ka të ngjarë të dëmtohet	Dëmtim i shpejtë
Zotërimi	I plotë	Kryesisht i plotë	Pjesëshm	I fragmentuar	I pazënë

Sa më i madh të jetë totali aq më i madh është kërcënim; kështu që një ndërtesë që ishte në gjendje të shkëlqyeshme, e menaxhuar mirë, e shfrytëzuar plotësisht dhe janë bërë përmirësime = 4; një ndërtesë në gjendje të favorshme, me disa kërcënime të lokalizuara ((sikur zbrazia apo mbeturinat), e cila është duke u dëmtuar por është plotësisht e zënë = 11; një lokacion i pazënë në gjendje të keqe që është duke u dëmtuar dhe nën kërcënim = 16.

11. Dokumentacioni përcjellës:
- 11.1. Dokumentacioni me fotografi;
- 11.2. Dokumentet përcjellëse kartografike (hartat);
- 11.3. Dokumentacioni teknik;
- 11.4. Dokumentacioni kadastral;
- 11.5. Dokumentacioni ligjor;
- 11.6. Mbishkrimet, shënimet, nënshkrimet;
- 11.7. Literatura;
- 11.8. Dokumentet/burimet tjera.

II. PËRMBAJTJA E INVENTARIT TË ASETVEVE TË TRASHËGIMISË SË LUAJTSHME KULTURORE (OBJEKTET/MATERIALET)¹⁸

Inventarët e aseteve të trashëgimisë së luajtshme përmbajnë të dhënat vijuese:

1. Emri dhe referencat
 - 1.1. Emri i objektit/materialit që do të regjistrohet (emri i asetit të trashëgimisë kulturore me të cilin njihet)
 - 1.2. Emri/titulli i koleksionit pjesë e të cilit është (apo duhet të jetë) objekti/materiali i regjistruar (emri/ titulli apo karakteri specifik i cili e identifikon koleksionin)
 - 1.2.3. Numri i përgjithshëm i njësive të koleksionit pjesë e të cilave është objekti/materiali në fjalë
 - 1.2.4. Numri i shembujve të llojit të njëjtë të objekteve/materialeve brenda koleksionit të afërt
 - 1.3. Emri i personit në pronësi të të cilit ishte/është objekti/materiali (për koleksione private);
 - 1.4. Emri i institucionit/organizatës që është përgjegjëse për mbledhjen dhe regjistrimin e të dhënave (emri, adresa)
 - 1.5. Emri i personit (ve) i cili mbledh dhe regjistron informatat në inventar (emri, shkathtësia profesionale dhe/apo pozita)
 - 1.6. Data(t) e përpilimit dhe/apo sigurimit të informatave për inventar
 - 1.7. Numri i inventarit dhe/apo numri unik i referencës (numri apo kombinimi i karaktereve të cilat e identifikojnë më mënyrë unike secilin objekt/njësi brenda koleksionit)
 - 1.8. Shënimet përcjellëse për regjistrimet e lidhura me objektet/materialet (në muze, galeri dhe/apo koleksion privat)
 - 1.9. Shënimet përcjellëse për koleksionet e ndërlidhura (muze, galeri dhe/apo koleksion privat)
 - 1.10. Shënimet përcjellëse për monumentin/lokacionin e ndërlidhur
 - 1.11. Shënimet përcjellëse për dokumentacionin e ndërlidhur
2. Dëshmia e rëndësisë (Përshkrim/shpjegim në një tekst të shkurtër mbi

¹⁸ Titujt/seksionet 1, 3, 5 dhe 6 janë të obligueshëm

rëndësinë e asetit)

3. Kategoria dhe lloji (t)

3.1. Kategoria

(objekte arkeologjike, etnologjike apo historike, objekte të artit, objekte teknike, materiali arkivor, materiali bibliotekar, materiali audio-vizuel, material i arkivit i zërit të inçizuar-fonogram)

3.2. Lloji

(p.sh.: figura, kuadër pikturimi, instrument, mjet transporti, shkrim dore, vepra kinematografike, regjistrimi i zërit etj.)

4. Statusi mbrojtës/Ligjor

4.1. Lloji i statusit mbrojtës/Ligjor

(përkohësisht i mbrojtur, përhershëm i mbrojtur, i pambrojtur)

4.2. Procedura e mbrojtjes

(vendimi i aktit ligjor, emri i autoritetit që ka marrë vendimin dhe data e hyrjes së aktit në fuqi)

4.3. Akti ligjor mbi amendamentin ose ndërprerjen e statusit mbrojtës

(emri, data, autoriteti).

5. Lokacioni

5.1. Lokacioni administrativ

5.1.1. Njësia gjeopolitike apo rajoni

5.1.2. Komuna, qyteza/qyteti/fshati

5.1.3. Adresa me të gjitha referencat përkatëse

(emri/titulli, emri postal, kodi postal, rruga, numri)

6. Data

6.1. Periudha kulturore dhe apo kultura/stili

6.2. Shekulli

6.3. Data e përafërt

6.4. Data e saktë

7. Përshkrimi

7.1. Përshkrim i përgjithshëm

7.2. Forma

7.3. Materiali

7.4. Teknika dhe teknologjia

7.5. Dimensionet/matjet

7.5.1. Gjerësia

7.5.2. Gjatësia

7.5.3. Lartësia

7.5.4. Trashësia

7.5.5. Diametri

7.5.6. Pesha

7.6. Karakteristikat dalluese (në veçanti: tema/subjekti, zhanri, gjuha, alfabeti, mbishkrimi (t), shenjat/treguesit, nënshkrimi, ornamentet/piktura etj.)

8. Personi(t) dhe/apo organizata(t) apo seminari (et) i punës i lidhur me paraqitjen dhe historikun e trashëgimisë

8.1. Autori(ët)/Krijuesi (t)

(piktorët, skulptorët, farkëtarit/farkëtarit dhe kategoria tjetër specifike e krijuesve, artistëve etj.)

8.2. Pjesëmarrësit tjerë dhe roli i tyre

(donatori, përkrahësi, profesioni etj.)

9. Pozita/gjendja

9.1. Gjendja e përgjithshme

9.2. Veçantia e pozitës

(shkalla e dëmeve)

9.3. Ndryshimet/ndërrhyrjet në të kaluarën

(restaurimi; rindërtimi dhe/apo ndonjë aktivitet tjetër mbrojtës)

9.4. Faktorët që ndikuan në tërësinë e trashëgimisë

(mungesa e mirëmbajtjes, mungesa e ndërrhyrjeve konservuese/restauruese, prezantim jo i duhur, kushte jo të duhura në vendin ku është vendosur apo prezantuar etj.).

10. Prejardhja dhe pronësia:

10.1. Prejardhja e objektit/materialit

(gjetje e rastësishme arkeologjike, objekt i marrë nga trashëgimia e palëvizshme për arsye mbrojtjeje, dhuratë, donacion, blerje, koleksion privat etj.)

10.2. Lloji i pronësisë

(pronësi publike, familjare apo personale)

10.3. Pronari (t)

(emrat, adresa)

10.4. Mënyra e furnizimit

(i zbuluar, i blerë, i mbledhur, thesar familjar/privat etj.)

11. Gjendja

11.1. E ekspozuar

- 11.2. E ruajtur
- 11.3. E shpërndarë

- 12. Dokumentacioni përcjellës
- 12.1. Dokumentacioni me fotografi
- 12.2. Dokumentacioni teknik
- 12.3. Dokumentacioni ligjor
- 12.4. Regjistrimi
- 12.5. Literatura
- 12.6. Dokumentet/burimet tjera

III PËRMBAJTJA E INVENTARIT TË ASETVE (ELEMENTEVE) TË TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE ¹⁹

Inventarët e asetve të trashëgimisë kulturore shpirtërore përbajnë informacionin vijues:

1. Emri (t) dhe referencat
 - 1.1. Emri i elementit
(emri/titulli i elementit/njesisë që shfrytëzohet nga komuniteti/grupi/individit në fjalë)
 - 1.2. Emri i institucionit përgjegjës për administrimin e regjistrimeve
 - 1.3. Emri (t) i personave të cilët sigurojnë informacione për inventar
 - 1.4. Emri(t) i personave të cilët përditësojnë dhe/ose regjistrojnë informacionet në inventar
 - 1.5. Numri i inventarit/numri unik i referencës
 - 1.6. Shënimet përcjellëse për regjistrimet e lidhura me elementet/objektet e ndërlidhura
 - 1.7. Shënimet përcjellëse për dokumentacionin e ndërlidhur dhe burimet tjera të ndërlidhura
 - 1.8. Pëlqimi dhe përfshirja e komunitetit/grupit/individëve në mbledhjen e informacioneve/të dhënave
 - 1.9. Personi(t) për burime: emri dhe përkatësia
 - 1.10. Data(t) dhe vendi (t) i mbledhjes/grumbullimit të të dhënave/informatave
 - 1.11. Data(t) e përpilimit, regjistrimit dhe futjes së informatave në një inventar
 - 1.12. Kufizimet, nëse ka, në shfrytëzimin e të dhënave të inventarizuara
2. Dëshmia e rëndësisë
(Përshkrim/shpjegim në një tekst të shkurtër mbi rëndësinë e asetit)
3. Lloji
 - 3.1. Elementet e folklorit dhe zejtarisë tradicionale
(zakonet, manifestimet, festimet, ritualet, besimet, vallëzimet, muzika, këngët, artizanati i vjetër, ushqimi tradicional)
 - 3.2. Elementet e traditës gojore
(dialektet rajonale/lokale, rrëfimi i tregimeve, shërimi i sëmundjeve)

¹⁹ Titujt/seksionet 1,3,5 dhe 6 janë të obligueshëm

4. Statusi mbrojtës/ligjor
 - 4.1. Lloji i statusit mbrojtës/ligjor (i mbrojtur apo i pambrojtur)
 - 4.2. Procedura e mbrojtjes (lloji i statusit mbrojtës, vendimi i aktit ligjor, emri i autoritetit që ka marrë vendimin dhe data e hyrjes së aktit në fuqi)
 - 4.3. Akti ligjor mbi amendamentin ose ndërprerjen e statusit mbrojtës (emri, data, autoriteti).
5. Lokacioni:
 - 5.1. Lokacioni administrativ
 - 5.1.1. Njësia gjeopolitike, ose rajoni
 - 5.1.2. Komuna, qyteza/qyteti/fshati
 - 5.1.3. Lokacioni (et) fizik
(adresa me të gjitha referencat përkatëse për vendin e ngjarjes apo produktin dhe/apo krijuesin e produktit, interpretuesin etj.)
6. Identifikimi/Relacioni
 - 6.1. Komuniteti/komuna/personat dhe institucionet e përfshira me elementin
(praktikanti (ët): krijuesi (t)ekzekutuesi (t): emri (t), mosha, gjinia, statusi social, dhe/apo kategoria profesionale etj.)
 - 6.2. Pjesëmarrësit e tjerë (p.sh. bartësit/kujdestarët)
 - 6.3. Relacioni me asetën përkatëse të trashëgimisë kulturore materiale apo jomateriale dhe/apo ambientin (vendi, ndërtesa/objekti, lokacioni, rajoni)
7. Përshkrimi/karakteristikat e elementit
 - 7.1. Përshkrim i shkurtër
 - 7.2. Prejardhja e perceptuar
 - 7.3. Rregullat/normat, aftësitë, veglat për punim/krijim/ekzekutim
 - 7.4. Mënyra e ekzekutimit/punimit/krijimit
8. Pozita/gjendja
 - 8.1. Gjendja aktuale
 - 8.2. Ndryshimet në mënyrën origjinale, historike, tradicionale të të ekzekutuarit, punuarit/krijuarit/ruajtjes
(nëse është e zbatueshme);
 - 8.3. Kërcënimet për miratim/transmetim;
 - 8.4. Gjendja e elementeve të ndërlidhura materiale dhe jomateriale;

- 8.5. Masat e ruajtjes në vend (nëse janë të zbatueshme)

9. Dokumentacioni përcjellës
 - 9.1. Dokumentacioni deskriptiv;
 - 9.2. Dokumentacioni me fotografi;
 - 9.3. Video dokumentacioni;
 - 9.4. Fono dokumentacioni;
 - 9.5. Literatura;
 - 9.6. Dokumentet/burimet tjera

SHËNIM:

Të dhënat që u takojnë aseteve të trashëgimisë kulturore shpirtërore që janë bërë subjekt i inventarizimit duhet të bazohen në llojin ku bëjnë pjesë këto asete të identifikuara si element ekzistues për të cilin arsyeshëm supozohet që paraqet trashëgiminë kulturore të lidhur me popullatën e Kosovës.

BURIMET E PËRZGJEDHURA

Guidance on Inventory and Documentation of the Cultural Heritage, Council of Europe 2009

Practical Handbook for Inventory of Intangible Cultural Heritage of Indonesia, published by the Ministry of Culture and Tourism of the Republic of Indonesia and UNESCO Office, Jakarta 2009

Questions and Answers – UNESCO project publication (brochure) on implementation of the Convention on Safeguarding the Intangible Heritage, 2009

What is Intangible Heritage? UNESCO project publication (brochure), 2009

Identifying and Inventorying Intangible Cultural Heritage, UNESCO project publication (brochure), 2009

Intangible Heritage Domains, UNESCO publication, 2009

Implementing the Convention for the Safeguarding of Intangible Cultural Heritage, UNESCO project publication (brochure), 2008

What is Intangible heritage?, Heritage Foundation of Newfoundland and Labrador, 2008

Integrated Management Tools in South East Europe, Council of Europe 2008 (Directorate of Culture and Cultural and Natural Heritage Regional Co-operation Division)

Analysis and reform of cultural heritage policies in South East Europe, Council of Europe 2008 (Directorate of Culture and Cultural and Natural Heritage Regional Co-operation Division)

Law on the Protection of Cultural Heritage (the Former Yugoslav Republic of Macedonia), 2004

Cultural Qualities in Cultural Landscapes, ICOMOS UK, 2004

Criteria to Designate Properties as National Monuments, (September 2002), the Commission to Preserve National Monuments of B&H

European Landscape Convention, Council of Europe, Florence 2000;

Law on the Protection and Preservation of Cultural Property (OG, 69/99), Croatia

Thornes, R. and Bold, J., Documenting the Cultural Heritage, Los Angeles, 1998

Ristov, J., The terminology of monuments, The Institute for the Protection of Cultural Monuments, Skopje 1997

Thornes, R., Introduction to Object ID. Getty Information Institute, 1997

Proclamation of masterpieces of the oral and intangible heritage, UNESCO, 1997

Principles for the recording of monuments, groups of buildings and sites (ICOMOS, 1996)

Recommendation No. R (95) 9 on the integrated conservation of cultural landscape areas as part of landscape policies, Council of Europe (Adopted by the Committee of Ministers on 11 September 1995) and the Appendix to Recommendation No. R (95) 9

Recommendation No. R(95) on co-ordinating documentation methods and systems related to historic building and monuments of the architectural heritage, Council of Europe (Adopted by the Committee of Ministers on 1 January 1995) and the Appendix to Recommendation No. R (95) 3

International guidelines for museum object information (the CIDOC information categories), International Committee of ICOM, Paris 1995

Cultural Landscape Areas as Part of Landscape Policies, 1995, Council of Europe

Recommendation No.8 (95)9 of the Committee of Ministers to Member States on the Integrated Conservation of Cultural Landscape Areas as Part of Landscape Policies, 1995, Council of Europe

Architectural heritage: inventory and documentation methods in Europe, proceedings of the Nantes colloquy (1992), in Archaeological Heritage No. 28, Council of Europe, Strasbourg 1993

Convention for the Protection of the Archaeological Heritage of Europe, (revised), Valetta, 16 January 1992, Council of Europe (basic text and Explanatory Report) (European Treaty Series No.143)

International Charter for Archaeological Heritage Management (ICOMOS Charter), 1990

Charter for the Conservation of Historic Towns and Urban Areas (ICOMOS Charter), Washington, 1987

European Convention on Offences relating to Cultural Property, Delhi, 23 June 1985, Council of Europe

Convention for the Protection of the Architectural Heritage of Europe (basic text and Explanatory Report) Granada, 03.October 1985, Council of Europe (European Treaty Series No. 121)

Recommendation for the safeguarding and preservation of movable images, UNESCO, Belgrade, 27 October 1980

Operational Guidelines for the Implementation of the World Heritage Convention (first edition from 1977-78)

Recommendation concerning the safeguarding and contemporary role of historic areas, UNESCO, Nairobi, 26 November 1976

Recommendation concerning the international exchange of cultural property, UNESCO, Nairobi, 26 November 1976

European Charter of the Architectural Heritage, adopted by the Council of Europe in Amsterdam, 21-25 October 1975

Recommendation concerning the protection at national level of the cultural and natural heritage, UNESCO, Paris, 16 November 1972

Convention on the means of prohibiting illicit import, export and transfer of ownership of cultural property, UNESCO, Paris, 14 November 1970

Recommendation concerning the preservation of cultural property endangered by Public or Private Works, UNESCO, Paris, 19 November 1968

Preservation and rehabilitation of groups and areas of buildings of historical or artistic interest: protective Inventory of the European Cultural Heritage, Council of Europe 1968

Resolution (66) 19 on criteria and methods of cataloguing ancient buildings and historical or artistic sites, Council of Europe (Adopted by the Committee of Ministers on 29 March 1966)

Recommendation on international principles applicable to archaeological excavations, UNESCO, New Delhi, 5 December 1956

Udhëzues për kërkime arkeologjike

HISTORIKU

I. SHPREHJET E PËRDORURA NË KËTË UDHËZUES

II. METODOLOGJIA E KERKIMEVE ARKEOLOGJIKE

- Hulumtimi dhe identifikimi në hartë i zonës ose i studimit
- Hulumtimi arkeologjik nëpërmjet sondimit (vlerësimi i gërmimit, gërmimi testues me sondë ose përdorimi i sondave)
- Gërmimi sistematik arkeologjik
- Llojet specifike të hulumtimit arkeologjik
- Hulumtimi arkeologjik nënujor
- Hulumtimi arkeologjik parandalues
- Rishikimi i hulumtimit arkeologjik

III. MENAGJERI PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK (BARTESI I LICENSES ARKEOLOGJIKE)

IV. KUSHTET PËR KRYERJEN E HULUMTIMIT ARKEOLOGJIK

- Dëshmia ligjore si menagjer për hulumtimin arkeologjik
- Hartimi i projektit për hulumtim arkeologjik
- Të dhëna për zonën e hulumtimit arkeologjik
- Objektivat e hulumtimit arkeologjik
- Rezultatet e pritura
- Lloji, qëllimi, drejtimi, metodat, koha e hulumtimeve dhe masat mbrojtëse

- Masat mbrojtëse për zonën/vendin arkeologjik dhe gjetjet

- Organizimi i hulumtimit

- Buxheti për hulumtimet arkeologjike

- Dokumentacioni teknik

- Dokumentacioni me fotografi

V. DOKUMENTIMI DHE REGJISTRIMI I HULUMTIMIT ARKEOLOGJIK

- Dokumentacioni me shkrim/përshkrues

- Ditari i punës

- Përshkrimi stratigrafik

- Inventari i terrenit

- Dokumenti kryesor dhe listat shtesë

- Dokumentacioni teknik

- Dokumentacioni me fotografi

- Dokumentacioni kompjuterik

VI. RAPORTI PËR HULUMTIMIN ARKEOLOGJIK

VII. BOTIMI I REZULTATEVE DHE DOKUMENTIMI

VIII. MONITORIMI I KËRKIMIT ARKEOLOGJIK

BURIMET E PERZGJEDHURA

HISTORIKU

Udhëzuesi për kerkime arkeologjike është përgatitur nga anëtarët e ekipit të PDKK-së. Ky udhëzues është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, z. Adrian Olivier (Mbretëria e Bashkuar).

Udhëzuesit kanë për qëllim të shërbejnë si mjete për zbatim të drejtë të LTK(eni7) dhe rregullores Nr. 01/2008 në procedurat e gërmimit dhe hulumtimit. Ato janë kryesisht të dedikuara për metodologjinë dhe punën në dokumentimin e cili duhet të ofrohet para fillimit të punimeve në teren sikurse dhe zhvillimit të dokumentacionit gjatë kerkimeve. Rezultatet e kërkimeve arkeologjike të përcjella me dokumentacionin relevant janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve nga autoritetet lidhur me strategjinë e planifikimit për vazhdimin e punimeve, punëve restauruese/konzervuese dhe prezentimin e aktiviteteve në strukturat e gërmuara dhe gjetjet dhe për rregullimin e raporteve me pronarët e tokave e cila është nën kerkim arkeologjik.

Prishtinë, Prill 2011

I. SHPREHJET E PËRDORURA NË KËTË UDHËZUES KANË KUPTIMET E MËPOSHTME:

1. Puna arkeologjike në terren është një proces kompleks që përfshin disa ose të gjitha fazat e mëposhtme të punës: 1. hulumtimin paraprak, duke përfshirë vlerësimin jo destruktiv në zyra dhe/ose vlerësimin në terren (fotografimin nga larg, gërmimin testues me sondë etj.); 2. realizimin e hulumtimit arkeologjik në depozitat në vendin origjinal (in situ) të gërmimeve; 3. përpunimin dhe analizën e rezultateve të punës, p.sh. të strukturave të gërmuara dhe të gjetura, të të dhënave dhe rezultateve të hulumtimit, tj.; 4. interpretimin e rezultateve; 5. botimin e rezultateve të hu

lumtimeve; 6. depozitimin e arkivit të hulumtimit me material dokumentar dhe material tjetër (artefakte) në një objekt të përshtatshëm për ruajtje afatgjatë (p.sh. në depo arkivi, muze).

2. Gërmim arkeologjik është çdo hulumtim ndërhyrës që ka për qëllim zbulimin e strukturave apo objekteve me karakter arkeologjik, pavarësisht nëse ky hulumtim përfshin gërmimin e tokës ose gërmimin sistematik të sipërfaqes së saj, ose kryhet nën ujë.
3. Lokaliteti/zona arkeologjike është pjesë e tokës ose e sipërfaqes nën ujë që përmban elementë me karakter arkeologjik.
4. Gjetjet arkeologjike përfshijnë çdo element të trashëgimisë arkeologjike, i cili është fryt i gërmimit ose hulumtimit arkeologjik, ose i ndonjë lloji tjetër hulumtimi arkeologjik, pavarësisht nëse gjetja përfaqëson një objekt të gjetur në sipërfaqe ose nën ujë, si rezultat i gërmimit ose në ndonjë mënyrë tjetër.
5. Strukturat arkeologjike janë një grup tiparësh të ndërlidhura që japin prova për bazat antropologjike, ekonomike dhe social-kulturore të ambienteve specifike, p.sh. të mbetjeve nga aktivitetet arkitekturore, artistike dhe aktivitetet e tjera njerëzore, gjurmët e zhvillimit të njeriut dhe natyrës dhe të marrëdhënies së njeriut në formësimin dhe shfrytëzimin e natyrës.
6. Punët paraprake janë punët përgatitore që kanë të bëjnë me përmbushjen e kërkesave për marrjen e lejeve për hulumtim arkeologjik, duke përfshirë: kryerjen e një inspektimi paraprak të gjendjes së zonës, dokumentimin e gjendjes aktuale, përgatitjen e një plani hulumtues/projekti bazë, nënshkrimin e kon-

tratave në rastet e përcaktuara me ligj dhe sigurimin e dokumenteve të tjera që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara.

7. Kryerja e hulumtimit duke shfrytëzuar metodat intruzive (kontrollimin me sondë, gjurmimin), ose metodat jointruzive (“hulumtimi” nënkupton të kryerit e punës kërkimore në vendin e origjinës (in situ), dokumentimin e hulumtimit dhe marrja e masave për të mbrojtur zonën arkeologjike dhe gjetjet)”.
8. Menagjeri i hulumtimit arkeologjik është çdo person juridik ose person fizik i emëruar nga institucioni përgjegjës për të drejtuar hulumtimin arkeologjik.
9. I licencuari për hulumtim arkeologjik është çdo personi fizik që zotëron një leje me shkrim për hulumtim arkeologjik të lëshuar nga institucioni përgjegjës.
10. Hulumtuesi i autorizuar është çdo person fizik, shkencëtar ose arkeolog i specializuar në fushën e muzeve ose në aktivitetet e lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë.

II. METODOLOGJIA E KËRKIMEVE ARKEOLOGJIKE ËSHTË E DEFINUAR SI :

1. Hulumtimi dhe identifikimi në hartë i zonës ose i studimit

1.1. Hulumtimi dhe identifikimi në hartë i zonës ose i studimit mund të kryhet në zona të caktuara që paraqesin hapësirë/zonë gjeografike, administrative apo të përcaktuar ndryshe (rajon, qark, territor komunal, zonë, vendndodhje) me qëllim:

- (i) zbulimin e zonave dhe strukturave të reja arkeologjike dhe konfirmimin e gjetjeve për ekzistencën apo mosekzistencën e strukturave të tilla në një zonë të caktuar;
- (ii) sigurimin e identifikimit të saktë hapësinor të strukturave arkeologjike;

(iii) bërjen e përshkrimit të saktë dhe të plotë të pjesëve të dukshme të objektit(ve) dhe lidhjes së tyre me ndryshimet antropogjenike në mjedisin e tyre të drejtpërdrejtë;

(iv) mbledhjen e gjetjeve sipërfaqësore për studim, trajtim dhe mbrojtje të mëtejshme;

1.2 Gjatë hulumtimit njohës puna duhet të jetë jo destruktive dhe e kufizuar vetëm në mbledhjen e objekteve të luajtshme, të lira ose të pjesëve të tyre në sipërfaqen e tokës, pa nevojën e ndonjë gjurmimi, nxjerrjeje apo çmontimi.

1.3 Përdoren dhe metoda të tjera jo ndërhyrëse ose jointruzive të gjurmimit nga larg (të tilla si arkeologjia nga ajri, hulumtimi gjeofizik, hulumtimi me gjeoradar etj.).

2. Hulumtimi arkeologjik nëpërmjet sondimit (vlerësimi i gjurmimit, gjurmimi testues me sondë ose përdorimi i sondave)

Kjo punë duhet të planifikohet dhe kryhet për të marrë informacion për pozicionin e zonës arkeologjike, natyrën dhe përmbajtjen e një zone të tillë me qëllim:

- (i) identifikimin e strukturave, komplekse arkeologjike potencialë dhe elementëve të tillë të ngjashëm ;
- (ii) marrjen e informacioneve për stratigrafinë, datën dhe llojin e vendndodhjes dhe gjetjet
- (iii) përcaktimin e kufijve të një zone arkeologjike dhe zonës së vet mbrojtëse.

3. Gjurmimi sistematik arkeologjik

3.1. Gjurmimi sistematik arkeologjik mund të planifikohet dhe kryhet në një zonë të identifikuar më parë përmes hulumtimit, ose ku ajo vlerësohet nëpërmjet hulumtimeve me sondë si e përshtatshme për gjurmim sistematik me qëllim regjistrimin dhe kuptimin sistematik dhe gjithëpërfshirës të zonës arke-

ologjike përmes hulumtimit dhe studimit të mëtejshme.

3.2. Leja për gjurmim sistematik arkeologjik mund të jepet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- (i) Zona e planifikuar i gjurmimit ka qenë më parë e regjistruar gjeodezikisht dhe e reflektuar në hartë dhe është pjesë e një rrjeti bashkërendues studimor dhe e lidhur me standarde krahasuese nga punë të mëparshme vlerësuese;
- (ii) Zona është identifikuar dhe është përcaktuar të mbetet i paprekur, duke lënë të hapur mundësinë e punës që mund të jetë e nevojshme në të ardhmen për të rishikuar dhe verifikuar rezultatet e projektit aktual duke përdorur teknika dhe metodologji që mund të mos ekzistojnë akoma.

4. Llojet specifike të hulumtimit arkeologjik

Për temat dhe qëllimet e mëposhtme mund të caktohen lloje specifike të hulumtimit arkeologjik për shkak të arsyeve, qëllimeve, kushteve, kufizimeve dhe karakteristikave të tjera të ndryshme.

4.1. Hulumtimi arkeologjik nënujor

Hulumtimi arkeologjik nënujor mund të planifikohet dhe të kryhet në fund të liqeneve ose lumenjve, me ose pa gjurmim, me qëllimin e identifikimit të zonave arkeologjike dhe mbledhjes së të dhënave dhe materialeve për studim dhe mbrojtje të mëtejshme të trashëgimisë arkeologjike nënujore.

4.2. Hulumtimi arkeologjik parandalues

4.2.1. Hulumtimi arkeologjik parandalues mund të ndërmerret në përgjigje të programeve/planeve zhvillimore të propozuara të cilat kërcënojnë pasurinë arkeologjike:

- (i). si pjesë e procesit të planifikimit (brenda kuadrit së udhëzimeve mbi politikën e nevojshme të planifikimit kombëtar) dhe/ose të politikës për zhvillimin e planit;
- (ii). jashtë procesit të planifikimit (p.sh. bujqësi, pyje dhe

menaxhim fshati, punimet e ndërmarrë nga sipërmarrësit publikë të njohur me ligj);

- (iii) në lidhje me planet menaxhuese dhe strategjitë lehtësuese të organeve private, lokale, qendrore ose ndërkombëtare.

4.2.2. Hulumtimi arkeologjik parandalues bëhet edhe për:

- (i) identifikimin, regjistrimin dhe kuptimin e atyre elementeve të trashëgimisë arkeologjike të cilat do të braktisen dhe/ose shkatërrohen si rezultat i zhvillimit të lidhur veçanërisht me ndërtimin e digave, rrugëve, rezervuarëve, hekurudhave dhe objekteve tjera të ngjashme, por jo të kufizuara vetëm në ta;
- (ii) zbulimin e elementeve të ndërtesave të shkatërruara apo të dëmtuara, ose të paraprijësive të tyre, duke përfshirë shtresat e mëparshme kulturore brenda, ose në afërsi të ndërtesave të tilla;
- (iii) identifikimin e elementeve të trashëgimisë arkeologjike në zonat e planifikuara për ndërtim, ose në të cilat po kryhen lloje të ndryshme punimesh;
- (iv) ruajtjen e elementeve të trashëgimisë arkeologjike në lokalitetet ose objektet e tjera të kërcënuara;
- (v) parandalimin e dëmtimit ose shkatërrimit të mëtejshëm të zonave arkeologjike ose të pjesëve të tyre;

4.2.3. Hulumtimi arkeologjik parandalues mund të planifikohet dhe të kryhet nëse ai urdhërohet si një masë mbrojtjeje nga organi kompetent, në përjashtim të rasteve kur hulumtimi specifikohet reciprokisht (në marrëveshje), ose parashikohet si aktivitet i rregullt i programuar.

4.3. Rishikimi i hulumtimit arkeologjik

4.3.1. Rishikimi i hulumtimit arkeologjik mund të planifikohet dhe të kryhet në zonat e njohura që i janë nënshtruar hulumtimit dhe ku ekziston dyshim i ar-

syreshëm që rezultatet e kësaj pune janë të paplota, të pasakta ose të rreme.

4.3.2. Rishikimi i hulumtimit arkeologjik bëhet për të:

- (i) testuar, përmirësuar dhe bashkërenduar të dhënat ekzistuese për një zonë ose vendndodhje arkeologjike dhe për të përfunduar regjistrimet zyrtare (inventarin), hartat ose bazat arkeologjike, vendndodhjet arkeologjike dhe të dhënat mbi monumentet dhe ndonjë dokumentacion në vazhdim;
- (ii) përcaktuar shtrirjen e zonave të mbrojtura;
- (iii) të kontrolluar nivelin dhe objektin i hulumtimit të mëparshëm lidhur me tërësisë stratigrafike dhe madhësisë së zonës së gërmuar krahasuar me të gjithë zonën arkeologjike.

III. MENAGJERI PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK (BARTESI I LICENSES ARKEOLOGJIKE)

- 1. Hulumtimi arkeologjik menaxhohet nga një hulumtues i autorizuar, pra nga i licencuari për hulumtim arkeologjik.
- 2. Menagjeri për hulumtim arkeologjik është përgjegjës për të gjitha aspektet e hulumtimit arkeologjik, pra ai/ajo është përgjegjës për të gjitha humbjet, dëmtimin ose cenimin e personit apo pasurisë, në çfarëdolloj mënyre, të shkaktuar nga projekti/hulumtimi.
- 3. Menagjeri për hulumtim arkeologjik duhet të sigurojë testimin, studimin dhe trajtimin e zbulimeve arkeologjike në proces, duke plotësuar standardet e caktuara profesionale.
- 4. Menagjeri për hulumtim arkeologjik duhet të jetë i pranishëm në zonën/vendin ku kryhet hulumtimi arkeologjik për një kohë të mjaftueshme për të drejtuar punët e përditshme. Në rast të paafësisë së tij/saj, ai/ajo duhet të emërojë një zëvendës nga ekipi i profesionistëve që plotëson kërkesat ashtu siç edhe drejtuesi i hulumtimit.

- 5. Në rast se ka ndonjë ndryshim të aktiviteteve të planifikuara që janë lejuar për t'u kryer, i licencuari për hulumtim arkeologjik duhet t'i parashtrijë një shpjegim me shkrim institucionit përgjegjës lidhur me nevojën për ndryshime të tilla. Arsyetimi i ndryshimeve të kërkuara në aktivitetet e planifikuara duhet t'i dërgohet institucionit përgjegjës me shkrim nga hulumtuesi.
- 6. Institucionet e huaja shkencore dhe shkencëtarë të huaj të caktuar mund të lejohen të menagjojnë hulumtim arkeologjik vetëm në rast se punimet do të kryhen në bashkëpunim me subjektet ligjore dhe sipas kushteve të përcaktuara në Udhëzuesin për licencimin e hulumtimit arkeologjik.

IV. KUSHTET PËR KRYERJEN E HULUMTIMIT ARKEOLOGJIK

Për hulumtimin arkeologjik do të lëshohet leje me shkrim nëse i menagjeri për hulumtimin arkeologjik dorëzon:

- 1. dëshminë që ai/ajo është kandidat i ligjshëm menagjer për hulumtimin arkeologjik;
- 2. projektin për hulumtim arkeologjik;
- 3. dëshminë lidhur me sigurimin e mjeteve financiare për hulumtim (duke përfshirë analizën dhe publikimin) dhe me masat mbrojtëse parandaluese që do të ndërmerren në zonën/lokalitetin ku kryhet hulumtimi dhe ku zbulohen gjetjet;
- 4. specifikimin e mjeteve teknike për kryerjen e hulumtimit;
- 5. listën e personave që janë pjesë e ekipit operacional, detyrat e tyre në strukturën e ekipit, të dhënat dhe dëshmitë bazë për kualifikimet e tyre;
- 6. deklaratën e pronarit të tokës ku bëhet hulumtimi/gërmimi lidhur me kryerjen e pakufizuar të punës, dhe/ose kontratën që rregullon marrëdhëniet e ndërsjella (në rast se zona/toka ku bëhet hulumtimi nuk është në pronësi të shtetit).

1. Dëshmia ligjore si menagjer për hulumtimin arkeologjik

1.1. licenca me shkrim, ose

1.2. dëshmia e

(i) një nivel të lartë arsimor, zakonisht të nivelit Master (magjistraturë) në fushën e arkeologjisë, antropologjisë apo fusha të tjera të afërta;

(ii) përvojës së gjerë praktike (dy ose tre vjet) në të dy pozitat, si i mbikëqyrur dhe si mbikëqyrës, në studim/gërmim, punë laboratorike apo administruese, shkrim raportesh dhe dokumentim të strukturave dhe gjetjeve arkeologjike sipas nevojës;

(iii) përvojës profesionale në një fushë specializimi të përshtatshme (periudha parahistorike, historike).

2. Hartimi i projektit për hulumtim arkeologjik përfshinë:

2.1. të dhëna për zonën arkeologjike ku do të bëhet hulumtimi;

2.2. objektin e hulumtimit arkeologjik;

2.3. rezultatet e pritura;

2.4. llojin, qëllimin, drejtimin, metodologjinë dhe kohëzgjatjen e hulumtimit;

2.5. masat për të mbrojtur zonën dhe gjetjet;

2.6. organizimin e hulumtimit;

2.7. buxhetin e nevojshëm;

2.8. dokumentacionin teknik;

2.9. dokumentacionin me fotografi.

2.1 Të dhëna për zonën e hulumtimit arkeologjik

2.1.1. Për zonën objekt të gërmimit arkeologjik duhet të jepet:

2.1.1.1. emri, vendi, koordinatat, lartësia, mënyra si mund të shkohet në zonë dhe informacione të tjera të ngjashme

për identifikimin e vendndodhjes;

2.1.1.2. inventari dhe/ose numri i regjistrimit të zonës arkeologjike, akti i mbrojtjes (lloji, emri, numri dhe data), hapësira e përgjithshme e zonës dhe e zonave të mbrojtura, informacion për pronarët e zonave të mbrojtura;

2.1.1.3. një përshkrim i shkurtër i natyrës, kuadrit kronologjik dhe karakteristikave kryesore të vendit arkeologjik në lidhje me kuptimin, vlerën, funksionin dhe informacione të tjera të ngjashme për vendndodhjet e identifikuar më parë duke shfrytëzuar teknikat profesionale dhe shkencore. Ky informacion nuk kërkohet në rastet e zonave arkeologjike tërësisht të pahulumtuara, ose të panjohura më parë.

2.1.1.4. të dhënat që gjenden në hartë: kufijtë komunal, ngas-tra/at e tokës të zonës, kategoria dhe destinacioni i përdorimit të tokës në pronësi të shtetit ose të subjekteve të tjera (titulli ose emri, adresa);

2.1.1.5. hulumtime dhe studime paraprake për lokalitetin /zonën (të dhëna lidhur me personin që ka bërë hulumtimin, se çfarë ka hulumtuar dhe sa është hulumtuar, se cilat janë rezultatet e këtyre hulumtimeve, ku janë vendosur gjetjet e lëvizshme arkeologjike dhe dokumentacioni i hulumtimeve, bibliografitë etj.).

2.1.1.6. institucioni përgjegjës për mbrojtjen e lokalitetit arkeologjik dhe për mbrojtjen e gjetjeve arkeologjike (muzeu përkatës).

2.1.2. Për një zonë objekt hulumtimi, paraqitje në hartë dhe vëzhgimi dhe për metoda të tjera jointruzive, duhet të jepet:

(i) emri, vendi, koordinatat, zona (në km²) dhe të dhëna tjera të ngjashme;

(ii) zona ekzistuese arkeologjike në vendin ku është duke u zhvilluar hulumtimi;

(iii) të dhëna nga puna paraprake në të njëjtën hapësirë

(nëse aplikohet).

2.2. Objektivat e hulumtimit arkeologjik

Sipas këtij udhëzuesi, objektivat e hulumtimit do të përzgjidhen dhe caktohen në bazë të metodologjisë së hulumtimit arkeologjik (të përcaktuar në kapitullin I të këtij udhëzuesi) në përputhje me rëndësinë, aspektet ose kushtet specifike të lidhura me interesat e përcaktuara të hulumtimit.

2.3. Rezultatet e pritura

Sipas këtij udhëzuesi, rezultatet e pritura do të parashikohen dhe përcaktohen në bazë të çdo vlerësimi të mëparshëm paraprak të potencialit arkeologjik dhe karakterit të zonës ose vendit ku organizohet hulumtimi.

2.4. Lloji, qëllimi, drejtimi, metodat, koha e hulumtimeve dhe masat mbrojtëse

Sipas këtij udhëzuesi, do të përfshihen elementet kryesore të mëposhtme:

- 2.4.1. lloji specifik i hulumtimit arkeologjik (shih kapitullin I);
- 2.4.2. qëllimi i hulumtimit: i vendosur bazuar në synimin dhe kushtet për kryerjen e hulumtimit dhe i shprehur nëpërmjet një përshkrimi dhe cilësive të studimeve që do të bëhen;
- 2.4.3. drejtimi i hulumtimit: i përcaktuar nga qëllimi dhe rezultatet e pritura, dhe i shprehur nëpërmjet një deklarate për drejtimin kryesor që do të merret;
- 2.4.4. Metoda(t) e hulumtimit: e përcaktuar nga metodologjia e hulumtimit dhe karakteri i zonës, duke përfshirë një përshkrim të hollësishëm të punës (p.sh. zonat e hapura të gërmuara me dorë dhe/ose sondë; zonat e hapura me makinë dhe me dorë dhe/ose sondë; intuita dhe përdorimi i sondës, duke shfrytëzuar detektorët).

- 2.4.5. Kalendari i përgatitur në formën përshkuese ose tabelore, plani dinamik i të gjithë programit të hulumtimit me informacionin për kohëzgjatjen e plotë të tij (kalendarin dhe ditët e punës), datat e planifikuara për fillimin dhe përfundimin e punës si dhe datat dhe kohët për secilën fazë të veçantë të punës.

2.5. Masat mbrojtëse për zonën/vendin arkeologjik dhe gjetjet lidhen me si më poshtë:

- 2.5.1. masat që kanë të bëjnë me sigurinë fizike dhe teknike të lokalitetit/zonës arkeologjike;
- 2.5.2. masat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e drejt-përdrejtë të lokalitetit /zonës dhe gjetjet (parandalimi, konservimi, anastiloza etj.)

2.6. Organizimi i hulumtimit përfshinë informacionet e mëposhtme:

- 2.6.1. Për menagjeret e hulumtimit :
 - (i) Në rast të një personi juridik: emri, adresa, biznesi kryesor (kodi dhe emri), regjistrimi, njësitë organizative dhe pozitat e punës në kuadrin e një pune të organizuar dhe sistematike në fushën e arkeologjisë dhe trashëgimisë arkeologjike, personi përgjegjës ligjor, personi përgjegjës kontaktues dhe çdo e dhënë tjetër që mendohet e rëndësishme për t'u përfshirë nga menagjeri për hulumtime arkeologjike;
 - (ii) Në rast të një personi fizik: emri, shtetësia, adresa, numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës (për hulumtuesit/studiuuesit e huaj), licenca me shkrim për hulumtim arkeologjik apo dëshmia për statusin e hulumtuesit të autorizuar (për hulumtuesin lokal), referimet për hulumtimin e ndërmarrë (në formën e një CV-je) dhe çdo e dhënë tjetër që konsiderohet e rëndësishme për t'u përfshirë nga menagjeri për hulumtim arkeologjik.

- 2.6.2. për partnerët në projekt ku hulumtimi do të ndërmerret në bazë të një kontrate bashkëpunimi;
- 2.6.3. për ekipet e punës ose ato operacionale (numri, përbërja, detyrat) si dhe për menagjeret veresisht nga specialitetet dhe detyrat e tyre, në rast se zbatimi nuk përfshinë më shumë se një ekip;
- 2.6.4. të dhëna për akomodimin, ushqimin, hapësirën e punës dhe ruajtjen e objekteve të lëvizshme.

2.7. *Buxheti për hulumtim arkeologjik, i cili përfshinë:*

- (i) mjetet financiare të siguruara (sasia, burimet dhe metodat e sigurimit);
- (ii) plani financiar për hulumtimin (qëllimi dhe shtrirja e burimit sipas llojeve dhe pozitave dhe sipas dinamikës së asetit).

2.8. *Dokumentacioni teknik, i cili përfshinë:*

- 2.8.1. hartat topografike (prerjet e e kopjuara me lokalitetin p.sh. hapësirën ku kryhet hulumtimi) në shkallën 1:50000 (për hulumtim ose vënien në hartë të terrenit apo studimit); 1:25000 (për llojet tjera të hulumtimit);
- 2.8.2 ekstraktin nga harta administrative (ose planin kadaltral), ose inçizimin/planin fotogrametrik në shkallën 1:2500;
- 2.8.3 gjendjen në terren me vijat rrethuese në shkallën 1:200, ose në një shkallë tjetër të duhur në varësi të zonës, ku shënohen:
 - (i) zonat e hulumtuara më parë;
 - (ii) zonat që do të hulumtohen dhe zonat e rrezikuara (për hulumtimet arkeologjike mbrojtëse);
 - (iii) zonat që janë lënë për hulumtime të mëtejshme dhe për rishikime (për gjermim sistematik arkeologjik).
- 2.9. Dokumentacioni me fotografi përfshinë përzgjedhjen e fotografive karakteristike që përshkruajnë gjendjen e mëparshme, hulumtimin e ëparshëm dhe gjendjes

së aktuale të zonës arkeologjike.

V. DOKUMENTIMI DHE REGJISTRIMI I HULUMTIMIT ARKEOLOGJIK

Gjatë procesit të hulumtimit duhet të mbahet dokumentacion me shkrim, dokumentacion grafik, me fotografi/video për të gjithë punën e kryer, duke përdorur formularë dhe tabela të gatshme, të përshtatshme për të regjistruar punën e kryer.

1. Dokumentacioni me shkrim/përshkrues përfshinë:

- 1.1. ditarin e punës në terrenit;
- 1.2. përshkrimin stratigrafik;
- 1.3. inventarin (në terren) e gjetjeve të lëvizshme arkeologjike (artefakteve dhe ekofakteve);
- 1.4. dokumentin bazë dhe listat shtesë në terren.

1.1. Ditari i punës në terren

1.1.1. Ditari i punës në terren përmbanë informacion të sintetizuar rreth:

- (i) rrjedhës së procesit të hulumtimit;
- (ii) stratigrafisë së shtresave kulturore që janë identifikuar;
- (iii) rrethanave dhe kushteve në të cilat është bërë zbulimi dhe çmontimi apo gjermimi i ndonjë strukture individuale arkeologjike dhe i lidhjeve me strukturat e afërta;
- (iv) lidhjes dhe marrëdhënies me forma të tjera të dokumentacionit që është përdorur gjatë kohëzgjatjes së projektit;
- (v) organizimit të elementeve teknike të hulumtimit.

1.1.2. Informacioni që përmbanë ditari i terrenit duhet të shoqërohen me skica të bëra me dorë të lirë dhe vizatime dhe fotografi përkatëse.

1.1.3. Menagjeri i hulumtimit arkeologjik duhet të sigurojë që mbahen shënime në ditarin e terrenit (apo dokumentacion ekuivalent të regjistrimit të punimeve në terren) për çdo ditë pune, informacion i cili ndahet

për secilin proces specifik të punës, siç përcaktohet nga sistemi i përdorur i regjistrimit.

1.1.4. Në rastet kur hulumtimi bëhet njëherësh në disa sektorë të ndryshëm, në pjesë të ndryshme ose zona të ndryshme, duhet të mbahen ditarë të veçantë shënimesh për terrenin (dhe/ose mënyra të tjera regjistrimi informacioni të përcaktuara në përputhje me sistemin e përzgjedhur të regjistrimit) nga menagjeri i hulumtimeve ose nga hulumtuesi përgjegjës për secilën nga këto njësi, të koordinuara nga menagjeri i hulumtim arkeologjik.

1.2 Përshkrimi stratigrafik

1.2.1 Përshkrimet stratigrafike bëhen kur hulumtimi bëhet në zona arkeologjike me shtresa të shumta.

1.2.2 Përshkrimi stratigrafik përmbanë:

- (i) identifikimin e shtresave individuale ose njërive të veçanta stratigrafike;
- (ii) rendin e shtresave dhe njërive stratigrafike dhe rendin e depozitimit të tyre, pra duke shfrytëzuar seksionet me ngjyra për të përcaktuar strukturën arkeologjike;
- (iii) kufijtë e njësive litostratigrafike dhe të shtresave kulturore (kur është e nevojshme);
- (iv) (iv) karakteristikat sedimentare dhe pedologjike (kur është e nevojshme);
- (v) karakterin e substratit gjeologjik dhe karakterin gjeomorfologjik të kontekstit (kur është e nevojshme);
- (vi) një interpretim paraprak të dinamikës së sedimentit, sinkronizimin dhe kronologjinë e shtresave dhe njësive

1.3. 1.3 Inventari i terrenit – Inventari i gjetjeve të luajtshme arkeologjike (artefaktet dhe ekofaktet)

Inventari i gjetjeve të lëvizshme arkeologjike përmban:

- (i) numrin rendor të secilës gjetje ose, ku është e

duhur, të grupit të gjetjeve

- (ii) datën e zbulimit;
- (iii) vendin e zbulimit (vektorin, sondën, kuadratin, numrin e gropës etj.);
- (iv) thellësinë dhe nivelin (krahësuar me elementet tjera kryesore dhe/ose krahësuar me sipërfaqen e terrenit);
- (v) emërtimin e shtresës si në përshkrimin stratigrafik;
- (vi) llojin e gjetjes me përshkrim të shkurtër;
- (vii) të dhëna dhe shënime tjera.

1.4. 1.4 Dokumenti kryesor dhe listat shtesë

1.4.1. Dokumenti kryesor për hulumtim arkeologjik përgatitet duke shfrytëzuar një formular që përmbanë informacion për:

- (i) lokalitetin arkeologjik: emrin, komunën, vendin, numrin identifikues, të dhënat kadastrare, referimin topografik në lokalitet; koordinatat gjeografike të caktuara me GPS, statusin konservues (trashëgimi kulturore e mbrojtur përkohshëm apo përhershëm);
- (ii) hulumtimin arkeologjik: llojin, menagjerin, vitin, hulumtuesin e autorizuar dhe/ose të licencuarin për hulumtim arkeologjik, numrin dhe datën kur është lëshuar licenca, bashkëpunëtorët profesionalë;
- (iii) masat mbrojtëse: lloji i mbrojtjes, konservuesi i autorizuar, bashkëpunëtorët profesionistë, masat e sigurisë, depozitimi i gjetjeve të luajtshme dhe i dokumenteve përkatëse (tek institucioni përgjegjës);

1.4.2. Listat shtesë të terrenit përmbajnë informacionin e përzgjedhur nga menagjeri i hulumtimit arkeologjik që lidhet me gjetjet dhe/apo qasjet metodologjike specifike.

2. Dokumentacioni teknik

2.1. Dokumentacioni teknik përmbanë:

- (i) planet dhe vizatimet e mbetjeve të dukshme mbi sipërfaqe;
- (ii) skicat topografike, ekstraktet e planeve kadastrorë dhe pjesët e hartave topografike dhe gjeografike;
- (iii) gjendjen e lokalitetit/zonës arkeologjike;
- (iv) planin e detajuar të lokalitetit/zonës arkeologjike;
- (v) fotografitë, planet, vizatimet dhe pjesët që paraqesin të gjitha fazat e gërmimit dhe shkatërrimit;
- (vi) skicat e shtresave stratigrafike;
- (vii) ditarin e shënimeve mbi nivelimin;

2.2. Dokumentacioni teknik përgatitet duke përdorur:

- (i) harta të përditësuara topografike në shkallën 1:25000 dhe harta të përditësuara gjeodezike në shkallën 1:2500;
- (ii) planet mund të jenë në shkallën 1:50, 1:100 ose 1:200, dhe baza, seksionet dhe vizatimet në shkallën 1:10, 1:20; 1:25 ose 1:50, ose në shkallë të tjera të përshtatshme në varësi të karakteristikave të zonës dhe strukturave arkeologjike dhe gjendjes specifike;
- (iii) detajet e strukturave specifike arkeologjike, ku gjetjet mund të jenë në shkallën 1:1, 1:2, 1:5 dhe 1:10;

2.3. vizatimet bëhen me linjë pjerrësie, ngritje, përshkrim të materialit të ngulitur, dëme të shënuara me përshkrim të deformimit dhe llojit të dukurisë, fazës dhe patologjisë, vegjetacionit të rëndomtë etj.

3. Dokumentacioni me fotografi

3.1. Dokumentacioni me fotografi në procesin e hulumtimit arkeologjik përbëhet nga negativë me ngjyra dhe bardh e zi, nga fotografi dhe/ose diapozitivë, ose të dhënat e fotografive digjitale.

3.2 Ditari me fotografi përmban: numrin e filmit dhe fotografisë, datën e regjistrimit, të dhëna për përmbajtjen e regjistruar dhe informacion rreth natyrës teknike, nëse është e mundshme.

4. Dokumentacioni kompjuterik

Përdorimi i kompjuterëve dhe teknikave tjera të regjistrimit digjital (si p.sh. sistemet e bazës së të dhënave GIS, CAD etj.) në zonat arkeologjike është i zakonshëm. Teknika të tilla kërkojnë aftësi të veçanta dhe kur përdoren si pjesë e projektit, teknikat dhe sistemet e përdorura në kuadrin e tyre duhet të dokumentohen si pjesë integrale e arkivit të projektit.

VI. RAPORTI PËR HULUMTIMIN ARKEOLOGJIK

1. Raporti për hulumtimin arkeologjik përmban në veçanti:

- 1.1. skicën e projektit, duke përfshirë qëllimin kryesor të hulumtimit;
- 1.2. informacion për ekipin e hulumtimit;
- 1.3. përmbledhjen e punës që është kryer në terren;
- 1.4. përshkrimin e metodologjisë së përdorur, periudhës kur është kryer puna, qëllimit, drejtimit, organizimit dhe kushteve të hulumtimit arkeologjik;
- 1.5. rezultatet dhe gjetjet paraprake nga hulumtimi;
- 1.6. masat e marra për mbrojtjen e zonave arkeologjike dhe të gjetjeve;
- 1.7. të dhëna mbi mostrat e marra dhe të dorëzuara për hulumtim të mëtejshëm laboratorik;
- 1.8. vendin e depozitimit të gjetjeve të lëvizshme arkeologjike, me kopje të dokumentacionit të dorëzimit dhe pranimit të gjetjeve dhe vendin e dorëzimit të shënimeve arkivore të projektit;
- 1.9. shpjegimet lidhur me ndonjë modifikim të skicës fillestare të projektit dhe ndonjë kusht të specifikuar në lejen për hulumtim arkeologjik;
- 1.10. një përzgjedhje të shënimeve dokumentare:
 - (i) listën e burimeve të zbuluara, sasinë, llojin në shkallë të duhura;
 - (ii) Ilustrimet mbështetëse – kopje e dokumentacionit

teknik, fotografive, apo incizimet fotografike, duke përfshirë kopjen e formularit që ilustron gjithë procesin e hulumtimit arkeologjik,

1.11. Raporti financiar përmban në veçanti:

- (i) pasqyrën e përgjithshme të shpenzimeve;
- (ii) shpenzimet e pjesëmarrjes së stafit;
- (iii) shpenzimet për mjetet teknike dhe veglat e punës;
- (iv) shpenzimet për derivate;
- (v) shpenzimet për materiale konsumi;
- (vi) dëmshpërblimin për pronarin (nëse aplikohet);
- (vii) shpenzimet për akomodim, transport dhe dieta ushqimore;
- (viii) shpenzimet për konservim dhe/apo mbrojtje të zonës arkeologjike dhe të gjetjeve.

1.12. Diskutim përmbyllës dhe sugjerim:

- (i) rekomandimet për përditësimin e kuadrove përkatëse historike dhe për planifikimin e qëllimeve dhe prioritetëve, dhe lindja e nevojës për informacion të ri ose të përditësuar;
- (ii) krijimi i lidhjeve ndërmjet aktiviteteve aktuale ose i aktiviteteve të propozuara
- (iii) propozim për hartimin e projektit të ardhshëm, ose të projekti pas gërmimit.

2. Raporti për hulumtimin arkeologjik duhet të përgatitet nga i licencuari për hulumtim arkeologjik/hulumtuesi i autorizuar.

3. Raporti duhet t'i dorëzohet institucionit përgjegjës brenda tre muajve nga përfundimi i punës, në tri kopje të shtypura dhe në formë elektronike, me vëllim dhe cilësi të përshtatshme për botim.

4. Dokumentacioni paraprak i hulumtimit të licencuar arkeologjik duhet t'i dorëzohet institucionit përgjegjës brenda 1 viti; dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet brenda 2 vjetësh.

5. Në rast të projekteve komplekse/sistematike që mund të marrin disa vjet, mbajtja e dokumenteve dhe gjetjeve mund të miratohet jo për më gjatë se një vit pas përfundimit të fushatës së caktuar hulumtuese.

VII. BOTIMI I REZULTATEVE DHE DOKUMENTIMI

1. I licencuari për hulumtim arkeologjik ka të drejtën ekskluzive të jetë i pari që boton dokumentacionin dhe gjetjet në një periudhë jo më të gjatë se (4) katër vjet pas përfundimit të hulumtimit. Arkeologët anëtarë të ekipit hulumtues të ekspertëve mund të lejohen po ashtu të botojnë dokumentacionin dhe gjetjet e hulumtimit arkeologjik në rast se ekziston një marrëveshje ndërmjet tyre dhe të licencuarit për hulumtime arkeologjike.
2. Për një periudhë prej 4 vjetësh pas hulumtimit, institucioni përgjegjës nuk e jep koleksionit të plotë të gjetjeve dhe as të dokumentacionit përkatës shkencor për studim të detajuar, pa autorizim me shkrim të të licencuarit për hulumtim arkeologjik.
3. Në rastet kur hulumtimi vazhdon për më shumë se 4 vjet, i licencuari për hulumtim arkeologjik bën me dije çdo vit rezultatet e hulumtimit dhe ekspertizën mbi gjetjet.

VIII. MONITORIMI I KËRKIMIT ARKEOLOGJIK

1. E gjithë puna duhet të monitorohet nga institucioni përgjegjës dhe, nëse është e nevojshme, nga instituti qendror për konservim dhe restaurim (nëse ekzistojnë aktivitete serioze konservuese gjatë procesit arkeologjik), agjencia/organizata përgjegjëse për planifikimit (nëse hulumtimet janë duke u bërë brenda projektit/planit të ndërtimit), dhe nga inspektori për trashëgimi arkeologjike i Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të MKRS-së.
2. Monitoruesi duhet të ketë përvojën dhe kualifikimin përkatës, ose duhet të ketë akses tek këshillimi i përshtatshëm i specialistëve.
3. Të gjitha vizitat monitoruese duhet të dokumentohen dhe të bëhen me pëlqim të ndërsjellë.
4. Për të gjitha marrëveshjet monitoruese duhet të bihet dakord që në fillim për projektin bazë; i licencuari për hulumtim arkeologjik duhet të informojë monitoruesin(ët) për punën e kryer brenda një kohe të arsyeshme.
5. Inspektori(ët) e trashëgimisë arkeologjike mund të vendosin të vizitojnë në çdo kohë vendin/zonën arkeologjik objekt hulumtimi.
6. Inspektori për trashëgimi arkeologjike përgatit një pasqyrë të përgjithshme përmbledhëse për procesin e monitorimit, e cila më pas i dorëzohet Departamentit të Trashëgimisë Kulturore të MKRS-së. Një kopje e raportit i dorëzohet të licencuarit për hulumtim arkeologjik.

BURIMET E PËRZGJEDHURA:

Pravilnik o arheološkim istraživanjima, R. Hrvatska, NN br.102 (2010)

Analysis and reform of cultural heritage policies in South East Europe, Council of Europe publication (2008)

Guidance on heritage assessment, Council of Europe publication (2005)

Integrated management tools in South East Europe, Council of Europe publication (2005)

Pravilnik za arheološki istraživanja, Sl. na RM br. 111 (2005)

Archaeology and historic preservation – Secretary of Interior’s Standards and Guidelines (As Amended and Annotated (http://www.nps.gov/history/local-law/arch_stnds_9.htm

Landmarks Preservation Commission Guidelines for Archaeological Work in New York City, April 2002 <http://www.nyc.gov/html/lpe>

Draft New Licensing Framework for Archaeology, Ministry of Tourism, Culture and Recreation, Ontario (2002)

European Cultural Heritage (Volume II) – A Review of policies and practices (2002)

Archaeological Heritage, The Council of Europe Initiatives and the Valletta Convention (1992), Tracking down the traces to understand the present (2002)

Heritage at Risk 2001–2002: Archaeological Sites at Risk, ICOMOS

Guidance on inventory and documentation of the cultural heritage, Council of Europe publication (2001, revised 2009)

Heritage at Risk 2001–2002: Archaeological Sites at Risk, ICOMOS

European Landscape Convention, Florence (2000)

Review of Archaeological Assessment and Monitoring, Heritage Council, Ireland (February, 2000)

Policy and Guidelines on Archaeological Excavation, An Roinn Ealaíon, Oidhreacht, Gaeltachka & Oileán, Department of Art, Heritage, Gaeltach and the Islands, Government of Ireland (1999)

Archaeological sites in Europe: conservation, maintenance and enhancement: European Colloquy jointly organised by the Council of Europe and Instituto Português do Património Cultural, Architectural Heritage Series No. 22, CoE Press (1999)

Standard and Guidance for Archaeological Excavations, The Institute of Field Archaeologists, University of Manchester (Revision September 1999)

Core Data Standard for Archaeological Monuments and Sites, Council of Europe publication (1999)

Archaeological Site Manual, Museum of London, Archaeology Service (1994)

European Convention on Protection of the Archaeological Heritage (Revised), Valletta Convention (1992)

Charter for the Protection and Management of the Archaeological Heritage, ICOMOS (1990)

Recommendation Concerning the Preservation of Cultural Property Endangered by Public or Private Works, UNESCO (1968)

International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites (Venice Charter), ICOMOS (1964)

Recommendation on International Principles Applicable to Archaeological Excavations, UNESCO meeting at New Delhi (1956)

**Udhëzues për
licencimin e
kërkimeve
arkeologjike**

HISTORIKU

- I. SHPREHJET E PERDORURA NË UDHËZUES
- II. KUSHTET PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR PERSONIN FIZIK DHE JURIDIK
- III. KËRKESA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK
- IV. KOMISIONI PËR KONTROLLIN E PROCESIT TË DHËNIES SË LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK
- V. DHËNIA E LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK
- VI. VLEFSHMËRIA E LICENCËS
- VII. PEZULLIMI I LICENCËS

BURIMET E PERZGJEDHURA

Udhëzuesi për Licensimin e kerkimeve arkeologjike është përgatitur nga ekipi i PDKK-së. Udhëzuesi është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, z. Adrian Olivier (Mbretëria e Bashkuar).

Udhëzuesit kanë për qëllim të shërbejnë si bazë për zhvillimin e instruksioneve ligjore me qëllim që të sigurojnë që puna në teren të plotësojë standardet e nevojshme për mrojtjen e trashëgimisë arkeologjike, në pajtim me Ligjin e Kosovës për trashëgimi kulturore (neni 7.21) dhe rregullores për procedurat e germimit/ hulumtimit (Nr. 01/2008, neni 1, 1.2, dhe 1.3) ku është e specifikuar se entiteti ligjor apo personi fizik përgjegjës për të ndërmarrë veprime të germimit/hulumtimit arkeologjik, mbikqyrjes dhe dokumentimit duhet të jetë i licensuar.

Për të lejuar një proces efektiv, duhen caktuar kriteret dhe kushtet e nevojshme për të siguruar që ata që marrin licencën e përmbushin nivelin e kompetencës në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prishtinë, Prill 2011

I. SHPREHJET E PËRDORURA NË UDHËZUES

Licenca për hulumtim arkeologjik – është dokumenti juridik, përkatësisht leja e punës për hulumtim arkeologjik (“Certifikatë Licencimi”). Ajo i jepet personit juridik apo fizik që ka bërë një kërkesë për hulumtim arkeologjik nëse plotëson kërkesat e përshkruara në këtë udhëzues.

Mbajtësi i licencës për hulumtim arkeologjik – është personi juridik apo fizik që ka një licencë me shkrim për hulumtim arkeologjik, të lëshuar nga Departamenti për Trashëgimi Kulturore i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni për kontrollin e procesit të dhënies së licencës për hulumtim arkeologjik – është grupi i ekspertëve, i përbërë nga 3 anëtarë të cilët janë ekspertë të fushës dhe arkeologë të licensuar. Komisioni formohet nga Departamenti për Trashëgimi

Kulturore i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Hulumtimi arkeologjik – është procesi kompleks që përfshin fazat vijuese të punës: hulumtimin/punën paraprake; kryerjen e germimit arkeologjik apo llojit tjetër të hulumtimit arkeologjik në pajtueshmëri me qëllimin dhe metodologjinë e punës; përpunimin dhe analizën e strukturave dhe gjetjeve të gërmuara, të të dhënave dhe rezultateve të hulumtimit; interpretimin e rezultateve dhe botimin e rezultateve të hulumtimeve.

II. KUSHTET PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR PERSONIN FIZIK DHE JURIDIK

1. Për licencat e brendshme, aplikuesi duhet të jetë:

1.1. institucion shkencor i regjistruar për të kryer punë në fushën e arkeologjisë

1.2. institucion publik për mbrojtje në fushën muzeore, apo në ndonjë aktivitet tjetër të lidhur me trashëgiminë kulturore

1.3. person tjetër juridik, i cili ka të paktën një licencë tjetër për hulumtim arkeologjik në anëtarësinë e tij.

1.4. shkencëtar në fushën e arkeologjisë dhe/ose arkeolog me titull profesional në fushën muzeore, ose në ndonjë aktivitet tjetër të lidhur me trashëgiminë kulturore nëse ai/ajo plotëson kërkesat e mëposhtme:

i) ka rezultate të larta arsimore, kryesisht në nivelin Master (magjistraturë) në arkeologji, antropologji apo fushë të afërt;

ii) ka përvojë të pasur praktike (dy apo tre vjet) si në

pozicionin e të qenit objekt mbikëqyrje dhe në pozicionin e të qenit mbikëqyrës në studim/gërmim, punë laboratorike apo administruese, shkrim raportesh dhe dokumentim të strukturave dhe gjetjeve arkeologjike sipas nevojës

iii) ka përvojë profesionale në një fushë specializimi relevant (periudha parahistorike, historike etj.)

2. Për licencat e jashtme (të huaja):

2.1. Institucione të huaja shkencore dhe shkencëtarë të caktuar të huaj në fushën e arkeologjisë mund të lejohen të marrin një licence për hulumtim arkeologjik apo fushë të afërt vetëm nëse punët do të kryhen në bashkëpunim me subjektet shkencore apo publike ligjore që e kanë një licencë për hulumtim/gërmim arkeologjik, mbikëqyrje dhe dokumentim, sipas kushteve të përcaktuara në një kontratë të ndërsjellë.

2.2. Përfshirje mund të bëhen në rrethana të veçanta dhe të arsyeshme. Në raste të tilla, p.sh. mund t'i jepet një licencë institucioneve të huaja ndërkombëtare shkencore apo ekspertëve individualë në fushën e arkeologjisë, apo fusha të afërta me hulumtimet arkeologjike, të cilat do të kryhen si mision i pavarur arkeologjik, nëse marrëdhënia e rregulluar është vendosur me:

i) një marrëveshje të veçantë të nënshkruar ndërmjet institucioneve të autorizuara të Kosovës të fushës dhe subjektit të huaj për marrëdhënie të përbashkëta në punën e p.sh. misionit ndërkombëtar arkeologjik

ii) caktimin e një koordinatori kombëtar për p.sh. misionin ndërkombëtar arkeologjik

iii) një marrëveshje, e cila nuk duhet të jetë në kundërshtim me dispozitat e LTK-së.

III. KËRKESA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK

1. 1. Kërkesa për marrjen e licencës për hulumtim arkeologjik për personin fizik përmban:

1.1. një kërkesë me shkrim

1.2. biografinë me informacionin bazë, të dhëna më poshtë:

1.2.1. emri, emri i babait, mbiemri, vendlindja, adresa, profesioni dhe dy fotografi 3x4 cm

1.2.2. një certifikatë të lëshuar nga gjykata dhe prokuroria ku kryhet aktiviteti

1.2.3. aktivitetet e kryera në fushën e arkeologjisë

1.2.4. kopjen e noterizuar të diplomës

1.2.5. certifikatat e kualifikimeve dhe specializimeve dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet kompetente (të noterizuara)

2. Kërkesa për marrjen e licencës për hulumtim arkeologjik për personin juridik përmban:

2.1. një kërkesë me shkrim

2.2. informacionin bazë të përfaqësuesit ligjor të personit juridik:

2.2.1. emri, emri i babait, mbiemri, vendlindja, adresa, profesioni i udhëheqësit ligjor dhe teknik të personit juridik

2.2.2. aktiviteti që kryhet nga personi juridik sipas kategorive dhe llojeve të përcaktuara në licencën profesionale të udhëheqësit teknik për aktivitete arkeologjike;

2.2.3. akti i themelimit, regjistrimi si person juridik nga gjykata, certifikata e udhëheqësit ligjor dhe teknik, e lëshuar nga gjykata dhe prokuroria (e noterizuar)

2.2.4. certifikata e regjistrimit, e lëshuar nga Administrata Tatimore

2.2.5. deklarata që dëshmon zbatimin e parimeve të hulumtimit arkeologjik, masave teknike dhe të sigurisë në hulumtim dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore

2.2.6. deklarata e drejtuesit të projektit ku ai deklaron se nuk kryen punë të ngjashme për asnjë person tjetër juridik dhe që nuk ka marrëdhënie pune me shtetin (e noterizuar)

2.2.7. licenca profesionale e drejtuesit të projektit (e noterizuar)

2.2.8. kontrata e punës ndërmjet drejtuesit ligjor të personit juridik dhe drejtuesit të projektit (e noterizuar)

2.2.9. vlerësimin që në grupin e punës për hulumtim arkeologjik është përfshirë një arkeolog i cili e ka licencën për hulumtim arkeologjik.

3. Kërkesa për dhënien e licencës dhe dokumentet përkatëse i dorëzohen Departamentit për Trashëgimi Kulturor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

IV. KOMISIONI PËR KONTROLLIN E PROCESIT TË DHËNIES SË LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK

1. Kërkesa dhe dokumentet përcjellëse të personave fizikë dhe juridikë të cilët aplikojnë për licencë për hulumtime arkeologjike i dorëzohen Komisionit për kontrollin e procesit të dhënies së licencës për hulumtim arkeologjik ("Komisioni") nga ana e Departamentit për Trashëgimi Kulturor.
2. Komisioni shqyrton kërkesat e personave dhe subjekteve të interesuara që kanë aplikuar për licenca për hulumtim arkeologjik dhe informon Departamentin për Trashëgimi Kulturor për vendimin e ti të shkruar brenda 30 ditësh.
3. Komisioni kryen aktivitetin e tij në pajtueshmëri me këtë udhëzues, aktet ligjore dhe nënligjore dhe Udhëzuesin për Hulumtim Arkeologjik në fuqi të cilat përcaktojnë kriteret në fushën e arkeologjisë.

V. DHËNIA E LICENCËS PËR HULUMTIM ARKEOLOGJIK

1. Personave juridik dhe personave fizik kërkesat e të cilëve për licencë janë miratuar nga Komisioni do t'u jepet Certifikata e Licencimit nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor.
2. Certifikata e Licencimit lëshohet në dy kopje origjinale, një i dorëzohet subjektit/personit fizik në fjalë dhe një arkivohet nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor.
3. Licenca lëshohet jo më vonë se 30 ditë nga dita e vendimit të Komisionit.
4. Çdo kërkesë apo dokument përcjellës si dhe licenca,

sipas këtij udhëzuesi, duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe serbe ndërsa kërkesat në gjuhët tjera duhen përkthyer.

5. Licenca nuk mund të transferohet nga një person juridik apo person fizik tek tjetri.

6. Asnjë licencë që lëshohet nga autoritetet tjera kombëtare ose lokale, apo institucionet e huaja në fushën e arkeologjisë nuk është e vlefshme.

VI. VLEFSHMËRIA E LICENCËS

1. Licenca e dhënë sipas këtij udhëzuesi është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar.
2. Licenca e dhënë mund të pezullohet nëse mbajtësi i saj nuk respekton kriteret dhe kushtet e përshkruara në Ligjin për Trashëgiminë Kulturorë, aktet e tjera nënligjore të lidhura me aktivitetet arkeologjike dhe Udhëzuesin mbi Hulumtimin Arkeologjik.

VII. PEZULLIMI I LICENCËS

Pezullimi i licencës së dhënë për hulumtim arkeologjik bëhet nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor duke u bazuar në një vlerësim të Grupit të Punës të ekspertëve të fushës, të krijuar nga Departamenti për Trashëgimi Kulturor, dhe në Raportin e inspektorit për Trashëgimi Kulturor të Departamentit për Trashëgimi Kulturor.

Pravilnik o arheološkim istraživanjima, R. Hrvatska, NN br.102 (2010)

Analysis and reform of cultural heritage policies in South East Europe, Council of Europe publication (2008)

Guidance on heritage assessment, Council of Europe publication (2005)

Integrated management tools in South East Europe, Council of Europe publication (2005)

Pravilnik za arheološki istraživanja, Sl. na RM br. 111 (2005)

Landmarks Preservation Commission Guidelines for Archaeological Work in New York City, April 2002 <http://www.nyc.gov/html/lpe>

Draft New Licensing Framework for Archaeology, Ministry of Tourism, Culture and Recreation, Ontario (2002)

European Cultural Heritage (Volume II) – A Review of policies and practices (2002)

European Landscape Convention, Florence (2000)

Review of Archaeological Assessment and Monitoring, Heritage Council, Ireland (February, 2000)

Policy and Guidelines on Archaeological Excavation, An Roinn Ealaíon, Oidhreacht, Gaeltachka & Oileán, Department of Art, Heritage, Gaeltach and the Islands, Government of Ireland (1999)

Archaeological sites in Europe: conservation, maintenance and enhancement: European Colloquy jointly organised by the Council of Europe and Instituto Português do Património Cultural, Architectural Heritage Series No. 22, CoE Press (1999)

Standard and Guidance for Archaeological Excavations, The Institute of Field Archaeologists, University of Manchester (Revision September 1999)

European Convention on Protection of the Archaeological Heritage (Revised), Valletta Convention (1992)

Charter for the Protection and Management of the Archaeological Heritage, ICOMOS (1990)

International Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites (Venice Charter), ICOMOS (1964)

**Udhëzues për
kriteret dhe
kushtet për
vlerësimin
e aseteve të
trashëgimisë
kulturore**

HISTORIKU

- I. KRITERET NË LIDHJE ME RËNDËSINË E TRASHËGIMISË
 1. Kriteret kryesore në lidhje me rëndësinë aktuale të trashëgimisë kulturore ose me rëndësinë që mund të ketë trashëgimia kulturore në të ardhmen
 2. Kriteret për caktimin e një niveli rëndësie për marrjen e mundshme të statusit
 3. Kriteret krahasuese për të zgjeruar vlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore
- II. PARIMET PËR VLERËSIMIN E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- III. KUSHTET OPERATIVE PËR VLERËSIMIN E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- IV. PROCESI I VLERËSIMIT
- V. DOKUMENTACIONI
- VI. PËRCAKTIMI I KUFIJVE TË ASETEVE DHE ZONAVE TË TYRE TË MBROJTURA
- VII. PËRCAKTIMI I REGJIMIT MBROJTËS
- VIII. RAPORTI PËR PROCESIN E VLERËSIMIT

BURIMET E PERZGJEDHURA

HISTORIKU

Udhëzuesi për kriteret dhe kushtet për vlerësimin e asetëve të trashëgimisë kulturore është përgatitur nga anëtarët e ekipit të PDKK-së. Ky udhëzues është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, Dr. Martin Cherry (Mbretëria e Bashkuar).

Rëndësia e trashëgimisë kulturore përqafon të gjitha vlerat e ndryshme kulturore që njerëzit të lidhur me to. Të kuptuarit dhe të shprehurit me vlerat dhe rëndësinë e trashëgimisë janë zvogëluar për një përcaktim ligjor dhe rregullimin për zhvillimin e mbrojtjes dhe menaxhimit e politikave. Vlerësimi i rëndësisë së trashëgimisë është një proces sistematik dhe gjithëpërfshirës për të cilat kerkohet përcaktimi i kriterëve ligjore.

Në këtë kontekst dhe në përputhje me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore" (Ligji nr. 02/L-88, neni 4) dhe plus kriterëve të përgjithshme për vlerësimin e trashëgimisë kulturore për të fituar statusin ligjor të trashëgimisë kulturore – nën mbrojtje të përhershme, të parashikuara në Rregulloren nr. 05/2008, neni 4, ky udhëzues specifikon kriteret në lidhje me rëndësinë e trashëgimisë, parimet dhe kushtet operacionale për procesin e vlerësimit, dokumentacionin mbështetës dhe formën e raportit të procesit të vlerësimit. Si mjete teknike për procesin e vlerësimit dhe analizë së rëndësisë të trashëgimisë në fjalë Udhëzuesi integron kriterët e dhëna në rregullorën e përmendur dhe praktikat relevante ndërkombëtare, duke patur parasysh se kriteret e propozuara mund të zhvillohen sipas rrethanave specifike të plotësuara nga entiteti përgjegjës për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë. Vlerësimi i dhënë do të ndihmojë gjithashtu të nxisë një mirëkuptim dhe respekt për të shkuarën, pasurojë pranishëm, dhe të jetë me vlerë për brezat e ardhshëm.

Prishtinë, Mars 2011

I. KRITERET NË LIDHJE ME RËNDËSINË E TRASHËGIMISË

1. Kriteret kryesore në lidhje me rëndësinë aktuale të trashëgimisë kulturore ose me rëndësinë që mund të ketë trashëgimia kulturore në të ardhmen:
 - a) *Rëndësia historike dhe estetike – asetit është historikisht i rëndësishëm për lidhjen e tij me njerëzit, ngjarjet, vendet apo temat e paraqitura në: arkeologji, arkitekturë (ndërtesë, monument, lokacione), peizazhet kulturore dhe ato të projektuara, trashëgiminë industriale apo bujqësore, koleksionet apo objektet individuale, vendet e lidhura me ngjarje historike dhe njerëz që kanë pasur ndikim në shoqëri. Asetet e rëndësishme në aspektin historik variojnë nga asetet e lidhura me njerëzit e famshëm dhe ngjarjet e rëndësishme deri tek ata asetë që pasqyrojnë jetën e përditshme të njerëzve të zakonshëm. Rëndësia estetike e asetit lidhet me zëjtarinë, stilin, përsosmërinë teknike, bukurinë, demonstrimin e aftësisë, ose cilësinë e dizajnit dhe të punuarit.*
 - b) *Rëndësia shkencore dhe hulumtuese – asetet me vlerë të madhe potenciale për ekzaminim ose studim të mëtejshëm shkencor: ndërtesat, vendndodhjet, artefaktet dhe koleksionet nëse ato kanë vendburim të sigurtë dhe janë regjistruar në një kontekst të dokumentuar mirë dhe nëse paraqesin aspekte të historisë të cilat nuk janë pasqyruar mirë në burime të tjera.*

c) *Rëndësia shoqërore dhe shpirtërore: asetet me rëndësi shpirtërore për grupe të veçanta njerëzish dhe objektet që konsiderohen si objekte të shenjta brenda një sistemi të caktuar besimi, ose asetet që karakterizohen nga lidhja e ngushtë me komunitetin dhe kontribuojnë për identitetin dhe kohezionin social të komunitetit.*

2. Kriteret për caktimin e një niveli rëndësie për marrjen e mundshme të statusit

- a) *Përcaktimi: ka të bëjë me faktin nëse është përcaktuar se asemi i trashëgimisë kulturore ka rëndësi ndërkombëtare ose kombëtare (jepen arsyet për këtë përcaktim si dhe informacioni që ka çuar deri te përcaktimin e sipërpërmendur).*
- b) *Ekzemplar: ky kriter lidhet me të dëshmuarin që asemi i përket një klase ose lloji të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore brenda kuadrit të Kosovës, ose është pjesë veçanërisht e dallueshme apo karakteristike e trashëgimisë kulturore të Kosovës. Oferohen baza bazuar në të cilën është bërë gjyqimi për rëndësinë e asetit (duke cituar studime ose analiza, të cilat lejojnë një kuptim të mirë të pozicionimit të asetit ndërmjet aseteve të tjera).*
- c) *Lidhja: identifikimi me një person të rëndësishëm, ngjarje domethënëse, ose aspekt të rëndësishëm të kulturës së Kosovës (ose me figurat dhe ngjarjet e rëndësishme të njohura më gjerë në aspektin ndërkombëtar).*

3. Kriteret krahasuese për të zgjeruar vlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore¹

Kriteret në lidhje me rëndësinë kulturore u përkasin tri kategorive:

- A. *Rëndësia natyrore (ato karakteristika ose komponentë që janë të brendshme ose të natyrshme për asetin):*
- *Originaliteti* – përqindje e lartë e strukturës origjinale/të hershme që i ka mbijetuar dëmtimeve , ndryshimeve ose mbishtresave. Originaliteti shihet gjithashtu në lidhje me aspektin e materialeve apo substancave origjinale dhe të veçantisë së traditave dhe teknikave, vendndodhjes dhe mjediseve, funksionit ose përdorimit, shpirtit ose ndjenjave.
 - *Shtrirja/Plotësia* – niveli/shkalla e komponenteve që kanë mbijetuar nga përmbajtja origjinale ose fazat fillestare të asetit dhe të rrethinës/mjedisit të tij, ose përdorimi i teknikave origjinale, i mjeteve origjinale të prodhimit dhe/ose traditave të performimit
 - *Integriteti* – integritet i mjaftueshëm për të transmetuar, përfaqësuar apo përfshirë vlerat dhe cilësitë për të cilat asemi gjykohet si i rëndësishëm. Integriteti “i mjaftueshëm” duhet gjykuar duke shqyrtuar shkallën e ndryshimeve të përgjithshme në paraqitjen e strukturës, bazuar në numrin e ndryshimeve të rëndësishme, të tilla

1. Kriteret në vijim do të përdoren për të vlerësuar rëndësinë e një asemi të trashëgimisë dhe do të ndihmojnë për të përcaktuar nëse asemi i plotësojnë ose jo standardet për mbrojtje ligjore të monumenteve kombëtare. Shumë rrallë mund të ndodhë që një monument t'i përmbushë të gjitha kriteret, ndërkohë që shumë monumente do t'i plotësojnë shumicën e kriterëve dhe do të jenë kandidatë të fortë për t'u përcaktuar si monumente të rëndësishme, por disa do të plotësojnë vetëm ca kritere, të cilat do të jenë jashtëzakonisht detyruese (p.sh. një fragment i rrallë i gurit të gdhendur nga mesjeta në vendin e origjinës (in situ) në një vend të degraduar, ose në një ndërtesë shumë të ndryshuar ose të gjysmëshkatërruar industriale që përmban shembullin e vetëm të mbijetesës së një pjese specifike të makinerisë).

si rindërtim themeli, oxhak i ndryshuar, verandë moderne, ndryshime të dritareve origjinale, degradim i rrethinës, “elemente” bashkëkohore për interpretimin e folklorit, performancës, ose procesit të prodhimit artizanal, etj.

- *Kuadri kohor /Data* – lidhur si me origjinën dhe me fazat kryesore.
- *Vijimësia e shfrytëzimit/demonstrimi* – dëshmia e vijimësisë së shfrytëzimit mund të rrisë vlerën e vendit ku ndodhet aset, të objektit ose të procesit, veçanërisht nëse ekziston mundësia e shfrytëzimit të tij pas marrjes së statusit si vend, objekt ose proces demonstrimi dhe/ose shprehje kulturore.
- *Përmbledhja e dëshmive/studimi* – e shprehur nëpërmjet një hulumtimi të thellë dhe një njohurie të plotë të vendit ose procesit për të rritur vlerën e asetit ose të procesit duke zbuluar rëndësinë e tij të plotë në mënyrë të tillë që të rrisë vlerën/potencialin e tij edukativ dhe interpretues. Periudhat e gjata të monitorimit, inventarizimit, studimeve apo analizave të vazhdueshme mund t'i japin vlerë shkencore vendit ose procesit/performancës/shprehjes, e cila mund të përmirësojë dukshëm të kuptuarit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

B. *Rëndësia kontekstuale* (karakteristikat e lidhura me vendin e asetit qoftë brenda peizazhit të tij fizik dhe brenda kornizës së njohurive ekzistuese)

- *Të qenit i rrallë* – aset i rrallë që ka mbijetuar nga lloji i tij brenda një periudhe te veçantë dhe/ose shembull i rrallë përse i përket tërësisë dhe cilësisë së objektit të mbijetuar.

- *Përfaqësimi /Unikaliteti* – përfaqëson ose një shembull të mirë që është përfaqësues i llojit të tij, ose një aset me vlera natyrore të shquara (të tilla si kryeveprat e artit (artizanisë), puna e një artisti/arkitekti të njohur në zonën/rajonin në fjalë, ose brenda një periudhe specifike kohore.
- *Diversiteti* – i shprehur në forma të ndryshme nga individë, komunitete dhe shprehje etnike të ndryshme të variacionit rajonal (të tilla si format e ndryshme të arkitekturës, traditave dekorative dhe të përdorimit të materialeve)
- *Konteksti fizik* – marrëdhënia e një aseti me asetet tjera (vendet ose monumentet) në afërsi të drejtpërdrejtë dhe me peizazhin dhe mjedisin më të gjerë e më të përgjithshëm. Komponentët individuale brenda kompleksit të ndërtesave ase siteve arkeologjike mund të mos jenë lehtësisht të dukshme nëse vlerësohen dhe përcaktohen të izoluara (për shembull, një mull uji i parë si jo i shoqëruar nga pellgjet e ujit dhe nga kanalet e ujit). Asetet me lidhje të rëndësishme funksionale mund të jenë të shpërndara (të tilla si shkrirja e hekurit dhe punët për nxjerrjen e hekurit, ose një kala mesjetare dhe parku i saj për gjueti). Do të ketë raste ku një aset i caktuar lidhet fort me veçoritë e papërcaktuara (siç është një ndërtesë si “pikë referimi” e lidhur me vlerë të pamjes së saj). Një aset mjedisi rrethues i të cilit është degraduar plotësisht mund të jetë më pak i përshatshëm për të marrë statusin e objektit të mbrojtur se sa një objekt tjetër, mjedisi rrethues i të cilit është i paprekur.
- *Kërcënimi/brishtësia* – nëse vendi, objekti apo shprehja/procesi i përket një lloji të rrallë, i cili ka të ngjarë të bëhet edhe më i rrallë (ndoshta deri në pikën e zhdukjes), vlera e tij do të rritet, veçanërisht nëse vendi, objekti apo shprehja/procesi mund të preket nga degradimi pa iu nënshtruar menaxhimit, ndërhyrjes dhe mbrojtjes së nevojshme.

C. *Rëndësia asociative* (që nënkupton lidhjen e asetit me njerëzit dhe ngjarjet dhe me ndryshimin e perceptimeve ndaj aseteve me kalimin e kohës)

- *Interesi dhe lidhja historike* – kemi të bëjmë me interes ose lidhje historike kur vendi ose asemi është i lidhur me ngjarjet e rëndësishme të historisë dhe me traditën e komunitetit, grupeve etnike dhe kombit në tërësi
- *Atributet estetike* – Disa asete çmohen shumë nga popullsia lokale dhe rëndësia e tyre duhet të merret parasysh si pjesë e skenës lokale që mbahet gjallë pavarësisht nga cilësitë stilistike, artistike dhe historike siç vlerësohet në normat e pranuar, ose në mungesë të tyre.

a) *Vendi në vetëdijen kombëtare* – disa asete janë të rëndësishme për vetëdijen kombëtare ose për njerëzit që i përdorin aktualisht ose i kanë përdorur këto asete në të shkuarën, ose për pasardhësit e tyre.

II. PARIMET PËR VLERËSIMIN E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Vlerësimi kryhet në përputhje me:

1. të dhënat shkencore dhe profesionale në fushën të cilës i përket asemi i trashëgimisë kulturore;
2. të dhënat dhe dokumentacionin në dispozicion të asetit në fjalë (inventarin, studimet, analizat)
3. rezultatet e hulumtimeve shtesë të kryera rreth asetit dhe rreth lidhjes/marrëdhënies

së tij me kategoritë tjera të aseteve apo personave, komuniteteve dhe rajoneve.

III. KUSHTET OPERATIVE PËR VLERËSIMIN E ASETEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE

■ *Vlerësimi i aseteve të trashëgimisë së patundshme kulturore bëhet:*

1. sëbashku me asetet e lëvizshme kulturore të cilat janë pjesë e pasurisë së patundshme, për shembull asetet e trashëgimisë kulturore që janë të bashkëlidhura në mënyrë të pazgjidhshme me një ndërtesë apo shfrytëzimin/funksionin e saj
2. nëse koleksioni, ose objektet individuale nuk përbëjnë pjesë integrale të pasurisë së patundshme, vlerësimi bëhet në mënyrë të pavarur nga asemi në fjalë.
3. Veçmas nga zonat e mbrojtura, por në kuadrin e tyre

■ *Vlerësimi i aseteve kulturore të lëvizshme* zakonisht bëhet brenda koleksioneve të cilave ata u përkasin, ose të cilat janë krijuar në një muze të veçantë, galeri apo vend që kanë lidhje me ta.

■ *Vlerësimi i aseteve kulturore shpirtërore (jomateriale)* zakonisht bëhet me asete (elementë) individuale. Asetet jomateriale që përfaqësojnë dy a më shumë asete individuale të së njëjtë formës dhe përbëjnë një njësi unike që mund të identifikohet si element i veçantë dhe që është objekt mbrojtje, vlerësohen si asete shpirtërore kolektive, ose si entitet i trashëgimisë kulturore shpirtërore/jomateriale.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT

Vlerësimi i aseteve të trashëgimisë kulturore është një proces që përfshin:

1. regjistrimin, rregullimin dhe sigurimin e të dhënave dhe dokumentacionit në dispozicion (duke përdorur inventarizimin, analizën, vlerësimin, studimin, raportimin);
2. vlerësimin e gjendjes;
3. rishikimin dhe përditësimin e informacionit të dhënë në inventarizimin e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të çdo informacioni tjetër të nxjerrë nga hulumtimi shkencor (veçanërisht lidhur me asetet e trashëgimisë kulturore jomateriale)
4. sigurimin e dokumentacionit mbështetës në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzuesi (Kapitulli V)
5. bërjen e hulumtimeve shtesë në fushë me qëllim të përcaktuar që është specifikisht i lidhur me asetin në fjalë.
6. analizën krahasuese të vlerave, karakteristikave dhe rëndësisë së asetit
7. përcaktimin ose ripërcaktimin e kufijve të asetit të trashëgimisë kulturore dhe zonave të tij të mbrojtura
8. përcaktimin ose ripërcaktimin e regjimit mbrojtës
9. raportin mbi asetin e vlerësuar.

V. DOKUMENTACIONI

Dokumentacioni i kërkuar për procesin e vlerësimit lidhet me kategorinë e asetit të trashëgimisë kulturore.

1. Dokumentacioni i aseteve të trashëgimisë së patundshme kulturore përfshin:

- a) dokumentacionin me fotografi (me ngjyra, bardhë dhe zi dhe/apo dixhital), veçanërisht:
 - fotografimin e bërë nga ajri (veçanërisht për rezervat arkeologjike dhe/ose peizazhin kulturor) ;
 - pamjet panoramike jashtë perimetrit të asetit dhe zonës (ve) mbrojtëse: të paktën pesë për rezervatin arkeologjik, zonën konservuese arkitekturore dhe peizazhin kulturor ;
 - pamjet e përgjithshme, siluetat, dhe konteksti dominant urban apo rural (ansambli i ndërtesave/peizazhi): të paktën pesë fotografi për aset brenda kufirit (perimetrit) të asetit dhe të paktën tre pamje për secilën nga zonat mbrojtëse;
 - ballinat dhe veçoritë tjera të eksterierit (shatërvanët, shkallët, rrugicat, muret mbajtëse, barrierat e qasjes, gardhiqet, hyrjet, hapësirat etj.): të paktën dy fotografi të ballinës të secilit aset, ansamblit të ndërtesave dhe pamjes së rrugës dhe të secilës veçori brenda kufijve (perimetrit) të asetit dhe një fotografi për të gjitha veçoritë brenda secilës nga zonat e mbrojtura.
 - Interiorin e asetit (dyshemetë, muret, tavanet, shkallët, kamaret (qoshe në mur) oxhaqet, galeritë, shtyllat, dekorimet e ngjyrosura, ato skulpturore dhe të

- gdhendura etj.), të paktën një fotografi e pamjes së përgjithshme të tyre dhe një fotografi për secilin detaj karakteristik;
- pjesët/elementet e palëvizshme që janë të integruara (apo ngjitura) për asetit në kuadrin e funksionit të vet (ikonostasi, kanopi (e dalë zburimi), ikonat, mobilie, mjete të shërbimit etj.); të paktën një fotografi për të gjitha këto objekte dhe për detajet tipike.
- b) dokumentacionin teknik, i cili përmban veçanërisht:
- referimin kartografik të pozitës gjeografike dhe të rrugëve që të çojnë tek aseti i caktuar, me përcaktimin e qendrës komunale dhe zonës rezidenciale ku gjendet aseti, ose të zonës më të afërt rezidenciale dhe rrugëve që të çojnë tek aseti në hartën gjeografike të Kosovës dhe në hartën topografike të rajonit, zonës ose komunës përkatëse në shkallën 1:50 000 dhe 1:100 000 (për rezervatet arkeologjike dhe peizazhin kulturor që mbulon një zonë të madhe urbane dhe rurale);
 - referimin kartografik brenda zonës së mbrojtur, duke përfshirë kufijtë (perimetrit) e asetit dhe zonat e tij mbrojtëse, në shkallën 1:5 000 deri 1:25 000 (për të gjitha llojet e aseteve të patundshme);
 - gjendjen e zonës së mbrojtur, me të gjitha objektet dhe përmbajtjet/veçoritë e tjera brenda kufijve të asetit dhe brenda secilës nga zonat e tij mbrojtëse në shkallën 1:100 deri 1:1 000 (për të gjitha llojet e aseteve të palëvizshme);
- projektin arkitekturor të themelit, katit përdhësës, pjesëve tërthore/gjatësore, ballinave, strukturës ndërtimore dhe të detajeve karakteristike në shkallën 1:10 deri 1:100 (posaçërisht për asetit kulturor që është i një vlere dhe rëndësie të madhe);
 - skicat e mbishkrimeve origjinale dhe/ose dekorimeve të ngjyrosur (në shkallën 1:1) nëse ato janë të rëndësishme për vlerën e asetit.
- c) dokumentacionin juridik dhe dokumentacion tjetër komunal, i cili përmban veçanërisht:
- dëshminë e pronësisë (trashëgimi familjare, vendimi për ndarje, marrëveshje)
 - dëshminë e të drejtës së zotërimit (dhënia e së drejtës për shfrytëzim, akti i koncesionit, kontrata mbi qiramarrjen etj.);
 - regjistrimin e pasurisë;
 - ekstraktin e planit kadastror/njësisë së tokës;
 - dokumenti kadastror (për rezervatet arkeologjike dhe peizazhin kulturor që përfshijnë disa ngastra kadastrale brenda kufijve të zonave të mbrojtura);

- ekstraktin e planit urbanistik;
- pëlqimin e mbajtësve të së drejtës për interpretimin, krijimin, transportimin dhe/apo ruajtjen e asetit kulturor jomaterial;

d) Other types of documentation, especially:

- informacionet/bazat e të dhënave digjitale (veçanërisht për asetin kulturor me rëndësi të madhe).

2. Dokumentacioni i *aseteve të lëvizshme* përfshin:

- a) dokumentacionin me fotografi (me ngjyra, zi dhe bardhë dhe dixhital) veçanërisht:
 - koleksionin e afërt (në total)
 - secilin objekt apo komponent të koleksionit
- b) dokumentacionin teknik, veçanërisht:
 - skicat e mbishkrimeve origjinale dhe/apo dekorimet e ngjyrosur (në shkallën 1:1) nëse ato janë të rëndësishme për vlerën e asetit;
 - skicat mbi gjendjen e objektit në kohën e zbulimit të tij dhe skicat mbi gjendjen aktuale
- c) lloje të tjera dokumentacioni, veçanërisht:
 - dokumentacionet në video
 - fletët muzikore
 - dokumentet e tjera

3. Dokumentacioni i *aseteve shpirtërore*

(jomateriale) përfshin:

- regjistrimet përshkruese;
- regjistrimet melografike;
- regjistrimet koreografike;
- regjistrimet audio-vizuale;
- lloje të tjera regjistrimesh

VI. PËRCAKTIMI I KUFIJVE TË ASETEVE DHE ZONAVE TË TYRE TË MBROJTURA

Kufijtë (perimetri) e aseteve të patundshme kulturore përcaktohen sipas llojit dhe vendndodhjes së asetit, veçanërisht:

1. sipas tokës ndërtimore kufijtë e së cilës janë përcaktuar përmes planit përkatës urban;
2. sipas vendndodhjes së zonës, në rastet kur nuk ekziston plani urban;
3. sipas konfiguracionit të terrenit (p.sh. peizazhit dhe rezervatit arkeologjik që shtrihet në zonë të egër (të pashkelur);
4. sipas kufijve natyror, rrugëve, liqenjtë, lumenjtë etj.;
5. sipas bashkëveprimit me ambientin/mjedisin e vet me rëndësi historike.

Zonat e mbrojtura, numri i tyre, sipërfaqja dhe kufijtë përcaktohen në varësi të karakteristikave të ambientit me rëndësi historike, shtrirjes/plotësisë së asetit, ndikimit, qasjes dhe formave tjera të lidhjes me asetin apo ambientin.²

2 Zonat e mbrojtura, numri i tyre, sipërfaqja, kufijtë duhet të propozohen/përcaktohen nga ekipi i përzier i përbërë nga ekspertët e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, bazuar në dispozitat e lidhura me zonat e mbrojtura dhe/ose rajonet e mbrojtura të dhëna në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

VII. PËRCAKTIMI I REGJIMIT MBROJTËS

Niveli i regjimit mbrojtës përcaktohet sipas kategorisë dhe rëndësisë së asetit kulturor në fjalë.

Ka tri nivele të regjimit mbrojtës:

1 *Niveli i parë i regjimit mbrojtës* i referohet aseteve ku ndërhyrja nuk mund të çojë në ndryshim të madh dhe përfshin ruajtjen, respektimin, mbrojtjen, kultivimin dhe shfrytëzimin e pasurisë në gjendjen dhe funksionin e saj origjinal dhe masat mbrojtëse që përfshijnë konservimin dhe restaurimin e strukturës origjinale, anastyllozën (për objektet arkeologjike), rikompozimin (për dokumentacionin e regjistruar (filmuar) të aseteve jomateriale), parandalimin dhe veprime tjera të ngjashme në afërsi të asetit.

2 *Niveli i dytë i mbrojtjes* i referohet aseteve ku ndërhyrja mund të çojë në ndryshime të menaxhuara me kujdes. Çdo ndryshim duhet të respektojë gjendjen origjinale të asetit, por mund të ofrojë mundësi dhe për:

- përshtatjen e interiorit për shfrytëzim bashkëkohor, punë për rivitalizimin, rregullimin ose ndërtimin e ndërtesave të reja në zonat e zbrazëta, sipas kushteve të caktuara;
- ndërhyrje në pjesët e ekspozuara të koleksionit ose të objekteve në rast të transferimit nga mbajtësi origjinal (i degraduar) tek një i ri, dhe nga aspektet teknike dhe teknologjike tek mbajtës më i mirë dhe më i qëndrueshëm (për asetet kinematografike dhe fonografike), sipas kushteve të caktuara;
- ndërhyrje në lidhje me transferimin e dokumenteve të pasurisë kulturore jomateriale (shpirtërore) tek

mbartësi i ri (ose mediumi i ri) dhe për ekzekutimin në skenë dhe riprodhimin e aseteve, sipas kushteve të caktuara;

3 *Niveli i tretë* i mbrojtës është i lidhur me zonat e mbrojtura dhe kërkon përshtatje të shprehjes arkitekturore dhe kufizim sa i përket dimensioneve dhe lartësisë së ndërtesave.

Të gjitha nivelet e regjimit të mbrojtjes lejojnë ndalime dhe masa të tjera parandaluese dhe korrektuese.

Disa asete kulturore, veçanërisht zonat arkitekturore/historike dhe kulturore si një e tërë, mund të jenë objekt i një regjimi të kombinuar të mbrojtjes.

VIII. RAPORTI PËR PROCESIN E VLERËSIMIT

Në mënyrë që të sigurohemi që e tërë rëndësia kulturore e aseteve të caktuara, me të gjitha vlerat e shumëfishta që u bashkëngjiten atyre të mbeten plotësisht të kuptueshme në të ardhmen, është e rëndësishme të përshkruhet qartësisht procesi i analizës (dhe metodologjia e përdorur për të). Raporti i procesit të vlerësimit për secilin aset duhet të japë informacionin e nevojshëm për një vlerësim të mëtejshëm nga organet përgjegjëse, në veçanti nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i cili është organi përgjegjës për caktimin e mbrojtjes së përhershme të një trashëgimie kulturore sipas Ligjit të Kosovës mbi Trashëgiminë Kulturore. Kjo analizë do të ndihmonte dhe nxiste dhe një mirëkuptim dhe respekt për të kaluarën, do të pasuronte të tashmen dhe do të ishte me vlerë për brezat e ardhshëm.

Raporti përmban informacion të rëndësishëm për kategorinë e aseteve të trashëgimisë kulturore:

- titullin/emrin e asetit;
- klasifikimin (monumentin, ansamblin e ndërtesave, zonën konservuese arkitekturore, vendndodhjen arkeologjike, peizazhin kulturor; llojin e objektit të lëvizshëm dhe llojin e elementit jomaterial/shpirtëror);
- datën e ngjarjes dhe ekzistencën e saj;
- vendndodhjen;
- referimin kartografik;
- emrin dhe adresën e pronarit, zotëruesit ose të institucionit/organizatës përgjegjëse për prezantimin dhe/ose ruajtjen (për asetin e trashëgimisë së lëvizshme kulturore), p.sh. emrin dhe adresën e personit që ka ruajtur traditën ose dokumentacionin (elementin) e asetit të trashëgimisë jomateriale;
- listën me informacione kadastrale: komunën/agjencinë kadastrale, njësinë e tokës/ngastrën/(at);
- sistemin hapësinor dhe urban të referimit;
- përshkrimin e perimetrit të propozuar/përcaktuar të asetit dhe të zonave të tij të mbrojtura;
- autorin/krijuesin e asetit të trashëgimisë kulturore;
- personat dhe organizatat e lidhura me asetin;
- matjet (për asetet e lëvizshme të trashëgimisë kulturore);
- materialet dhe teknikat e përdorura (për

asetet e trashëgimisë së lëvizshme kulturore);

- listën e objekteve të koleksionit përkatës (titullin, numrin, një përshkrim të shkurtër);
- listën e ndërtesave ose të objekteve të tjera brenda kufijve të asetit përkatës (për grup ndërtesash, zonën konservuese arkitekturore, vendndodhjen arkeologjike, peizazhin kulturor);
- fotografitë karakteristike, skica ose regjistrime audio-vizuale (për asetet e trashëgimisë kulturore jomateriale);
- përmbledhjen e historikut dhe përshkrimin e asetit me sqarimin/rekomandimin për t'u caktuar si aset i trashëgimisë kulturore që gëzon mbrojtje të përhershme;
- propozimin e regjimit mbrojtës.

Emërimi i propozuar i shoqëruar me raportin duhet të shqyrtohet nga organi kompetent (bordit rishikues).

Emërimet e shqyrtuara, me rekomandimet e certifikuara janë dorëzuar Ministrisë të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për të marrë vendim për listën për asetin në mbrojtje të përhershme

Principles of Selection for Listing Buildings
(Department for Culture, Media and Sport – English
Heritage), March 2010

Scheduled Monuments, Identifying, protecting,
conserving and investigating nationally important
archaeological sites under the Ancient Monuments
and Archaeological Areas Act 1979 (Department for
Culture, Media and Sport – English Heritage), March
2010

Intangible Heritage Domains, UNESCO publication,
2009

Identifying and Inventorying Intangible Cultural
Heritage, UNESCO project publication, 2009

Conservation Principles, Policies and Guidance
for the Sustainable Management of the Historic
Environments (English Heritage), 2008

Implementing the Convention for the Safeguarding
of Intangible Cultural Heritage, UNESCO project
publication, 2008

Heritage Property Evaluation (A Guide to Listing,
Researching and Evaluating Cultural Heritage
Property in Ontario Communities), 2006

Operational Guidelines for the Implementation of the
World Heritage Convention (WHC. 05/2,) 1 February
2005

Cultural Qualities in Cultural Landscapes, ICOMOS
UK, 2004;

Investigating Heritage Significance (Draft Guideline),
NSW Heritage Office, 2004

Criteria to Designate Properties as National
Monuments, the Commission to Preserve National
Monuments of B&H, September 2002

Charter on the Built Vernacular Heritage, ICOMOS,
1999

Historic gardens (Florence Charter), 1981

Nara document on Authenticity (1994)

Recommendation concerning the safeguarding
and contemporary role of historic areas, UNESCO,
Nairobi, 26 November 1976

Recommendation concerning the safeguarding
and contemporary role of historic areas, UNESCO,
Nairobi, 26 November 1976

Recommendation concerning the protection at
national level of the cultural and natural heritage,
UNESCO, Paris, 16 November 1972

Resolution (66) 19 on criteria and methods of
cataloguing ancient buildings and historical or
artistic sites, Council of Europe (Adopted by the
Committee of Ministers on 29 March 1966)

International Charter for the Conservation and
Restoration of Monuments and Sites (“Venice
Chapter”), Venice, May 1964

**Udhëzues
për hartimin
e bazave të
konservimit të
trashëgimisë
kulturore brenda
planifikimit**

Hyrje

Korniza Ligjore e Kosovës

Analiza e konzervimit për zhvillimin e procesit të planifikimit

Përzgjedhje e shprehjeve të përdorura në udhëzues

BAZAT E KONSERVIMIT

I. PËRMBAJTJA E BAZAVE

A. Vështrim i përgjithshëm studimor

- Themelet ligjore dhe programore të bazave;
- Identifikimi i hapësirës së mbuluar nga bazat;
- Planet e aktuale mbi hapësirën e mbuluar;
- Inventarizimi i aseteve të trashëgimisë kulturore të hapësirës së mbuluar;
- Analiza e gjendjes/kushteve të trashëgimisë;
- Masat mbrojtëse.

B. Vështrimi grafik – shkalla e hartës; situata aktuale

C. Vështrim i përgjithshëm mbi dokumentet, hartat, fotografitë, gjendjen historike dhe ligjore

II. METODOLOGJIA E ZHVILLIMIT TË BAZAVE

1. Kushtet e përgjithshme
 2. Procesi
 - Krijimi i grupit të punës
 - Hartimi i programit operacional
 3. Hulumtimi
 4. Përpunimi i të dhënave dhe analizat e kryera
 - Dispozita të përgjithshme
 - Specifikimi i analizave të kryera
 - Kufijtë e hapësirës së mbuluar
 - Statusi i mbrojtjes së aseteve brenda hapësirës së mbuluar
 - Kushtet për analizën e trashëgimisë kulturore:
- Vlerësimi i kushteve aktuale
 - Shkaqet e përkeqësimit/shkatërrimit të aseteve, ose elemente të tjera që kanë shkaktuar gjendjen aktuale
 - Studim i vlerësimit të trashëgimisë në kuadrin e hapësirës/ambiental
 - Regjimi mbrojtës
 - Udhëzuesi i përgjithshëm për mbrojtjen;
 - Shtrirja e zonës(ave) të mbrojtura;
 - Niveli i mbrojtjes.

BURIME TË PËRZGJEDHURA

HISTORIKU

Udhëzuesi për hartimin e bazave të konservimit të trashëgimisë kulturore brenda planifikimit është pergaditur nga ekipi i projektit PDKK. Ky udhëzues është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, z. David Johnson (Mbretëria e Bashkuar).

Udhëzuesit janë destinuar që të shërbejnë si një mjet teknik për Institucionet relevante brenda MKRS për të kuptuar me mire rolin e tyre në procesin e planifikimit sipas legjislacionit ekzistues dhe standardeve e praktikave nderkombëtare.

Prishtinë, Maj 2012

Hyrje

Konzervimi i trashëgimisë ka ndryshuar nga të qenit një aktivitet i kufizuar që përqendrohej në monumente individuale në mbrojtjen e monumenteve në kuadër më të mëdha. Që pas hedhjes së ideja së konservimit të integruar (KI) në Deklaratën e Amsterdamt për Trashëgiminë Evropiane Arkitekturore (1975) dhe pas theksimit të rëndësisë së qasjes së integruar në Konventën e Granadës (1985), Konventën e Valetës (1992) dhe Konventën e Firencës (2000) janë hartuar shumë dokumente/ instrumente të tjera të ndryshme ndërkombëtare lidhur me parimet dhe zhvillimin e udhëzuesve për planifikimin dhe menaxhimin e trashëgimisë për cilësitë e trashëgimisë urbane.

"Konzervimi i integruar (KI) është pjesë e procesit të përgjithshëm të planifikimit dhe menaxhimit të qyteteve dhe territoreve në pajtim me perspektiven multireferuese (ekonomike, politike, sociale, kulturore, ambientale dhe hapësinore). Ai përqendrohet tek (por nuk kufizohet vetëm në) aspektet fizike dhe hapësinore të zonave të konsoliduara që për nga aspekti social janë të njohura për vlerat kulturore dhe kërkon të ruajë integritetin, autenticitetin dhe vazhdimësinë e vlerave kulturore për brezat aktualë dhe për brezat e ardhshëm. Konservimi i integruar thekson konservimin e aspekteve fizike dhe hapësinore brenda procesit të zhvillimit/ transformimit të qytetit, ndërsa kërkon zhvillim të qëndrueshëm duke transformuar vlerat kulturore të qytetit në asete që i shtojnë vlerën të gjitha dimensioneve të procesit të zhvillimit." (Zancheti, S.M., Kulikauskas P., Sa Carneiro A. R., Lapa, T.A., 2004. Bridging the disciplines and cooperative action: interfaces in integrated urban conservation. Cites & Time 1 (1)

Objektivat kryesore të qasjes së KI-së përfshijnë:

- promovimin e qasjes ndërdisiplinare në iniciativat fizike e normative për planifikimin e konservimit të trashëgimisë në lokalitete, qytete, qendra historike, fshatra apo hapësira periferike;
- promovimin e shfrytëzimit të modeleve për pjesëmarrjen institucionale, operacionale dhe publike që mund të lehtësojnë komunikimin ndërmjet ekspertëve të disiplinave të ndryshme në lidhje me trashëgiminë;
- kuptimin e disa parimeve të bazuara në hulumtim për komunikim ndërdisiplinar me anë të mjeteve praktike.

Politikat, programet, planet e konservimit në nivelin qendror apo lokal bazuar në vendimet në përputhje me kërkesat përkatëse nuk janë aq „të lehta“ për t'u miratuar dhe janë edhe më të vështira për t'u menaxhuar më vonë.

Pronarët e trashëgimisë jo domosdoshmërisht kanë të njëjtat vlerësime dhe qëllime me administratës publike. Organet politike janë të ndjeshme ndaj interesave të votuesve dhe shpesh binden të pranojnë projekte që dëmtojnë vlerat e trashëgimisë. Institucionet dhe ekspertët e tyre në fushën e trashëgimisë dhe planifikimit nuk kanë gjithmonë një qasje të integruar që merr parasysh trashëgiminë në politikat dhe proceset e zhvillimit.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e aktiviteteve për konservimin e duhur të trashëgimisë, duke njohur vlerën e saj dhe potencialin për zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë, siç thekson Konventa e Faros (2005), thekson që të gjithë profesionistët dhe zyrtarët që merren me çështjet e mjedisit të kenë njohuri mbi çështjet të rëndësishme siç janë konservimi, planifikimi urban, shfrytëzimi i tokave etj. Ata duhet të bëjnë koordinimin në zhvillimin e instrumenteve për të shmangur konfliktet e mëvonshme dhe veprimet juridike dhe për të zhvilluar politikat sektoriale që kontribuojnë për të njëjtat objektiva bazuar në parimet e zhvillimit ekonomik, balancës sociale dhe mbrojtjes së mjedisit duke përfshirë trashëgiminë.

Parimet kryesore dhe përparësitë sipas standardeve evropiane për politikën e konservimit të integruar që do të zhvillohen në Kosovë janë përshkruar fillimisht në këto dokumente: Strategjia Kulturore e Kosovës (botuar në vitin 2003 nga MKRS-ja), Plani për Zbatimin e Standardeve të Kosovës (UNMIK, 2004) dhe Strategjia për Konservimin e Integruar të Trashëgimisë Kulturore në Kosovë (projekt propozim nga Komiteti i Pavarur Ndërkombëtar, 2005). Dokumenti i fundit, i cili është Konservimi i Integruar në Kosovë, është njëdokument udhëzues për planifikimin e politikave (2009) i konceptuar si “udhëzues” për të nxitur studime sektoriale dhe shumësektoriale për KI-në u zhvillua në një Strategji për konservimin e integruar, 2011. Ndërkohë janë zhvilluar tri instrumente themelore ligjore me dispozita për marrjen parasysh të trashëgimisë në procesin e planifikimit: Ligji “Për Trashëgimi Kulturore” (në fuqi që nga viti 2006), Ligji “Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura” (në fuqi që nga viti 2008) dhe Ligji “Për Planifikimin Hapësinor (në fuqi që nga viti 2003). Ligji “Për Trashëgiminë Kulturore” (LTK) lidh konservimin e trashëgimisë me planifikimin hapësinor duke iu referuar zonave të mbrojtura, hapësirave të mbrojtura dhe hapësirave të veçanta, koncepte të përkufizuara në Ligjin “Për Planifikimin Hapësinor” (LPH). Në këtë kuadër, dispozitat e LTK-së në nenet 6.3. 6.4. dhe 6.5 (për trashëgiminë arkitekturore), 7.11. (për rezervate arkeologjike), 7.16 dhe 7.19 (për zonat e mbrojtura dhe zonat e trashëgimisë arkeologjike) paraqesin strukturë të qartë të përfshirjes së subjekteve përgjegjëse për trashëgimisë në procesin e planifikimit. Ndërkohë nuk është hartuar ssnjë rregullore apo udhëzim tjetër në lidhje me elementet, kushtet dhe masat që duhen përdorur nga profesionistët e trashëgimisë në kuptimin e qasjes integruese të trashëgimisë në planifikim.. Ligji “Për Zonat e Veçanta të Mbrojtura” (LZVM), i kufizuar tek rregullat specifike për mbrojtjen e trashëgimisë së komunitetit serb në Kosovë, trajton çështje të lidhura me procesin e planifikimit në LPH-së. Ligji “Për Planifikimin Hapësinor” (LPH) siguron vëmendje të përgjithshme për trashëgiminë, duke përcaktuar hapësirën e mbrojtur dhe zonën mbrojtëse (neni 2), duke promovuar

harmonizimin me parimet dhe planet evropiane për zhvillim hapësinor (neni 3, f), duke i dhënë përgjegjësi MAPL-së për bashkërendimin dhe harmonizimin në nivel qendror dhe lokal me normat dhe standardet ndërkombëtare (neni 5.3 që i referohet zbatimit të planeve hapësinore), dhe duke promovuar dhe mbrojtur “trashëgiminë mjedisore dhe natyrore, kulturore dhe arkeologjike” (neni 11.3, b dhe neni 21). Ekziston një procedura shumë e qartë për identifikimin dhe përcaktimin e hapësirave të veçanta që mund të përfshijë “...parqet nacionale dhe hapësira të tjera me vlera unike natyrore, ekonomike, bujqësore, kulturore, ose historike”, e parashikuar në nenin 12 që i referohet planeve hapësinore për zona të veçanta. Më tej gjashtë “udhëzime administrative” të shtjelluara në LPH ofrojnë udhëzime për elementet themelore të kërkuara, kushtet dhe masat që duhet marrë parasysh nga qeveria qendrore /ose lokale përgjegjëse për trashëgiminë për zhvillimin e niveleve të ndryshme të planeve hapësinore.¹ Së fundi, ndryshimet e LPH-së (Ligji nr. 03/L-106) në nenin 3, pika (a) dhe në nenin 16 (24.3) ka për qëllim të “mbushë boshllëqet” në marrjen parasysh të trashëgimisë kulturore në sistemin e planifikimit. Është për t'u theksuar se aktet ligjore në fuqi në lidhje me planifikimin hapësinor janë përmirësuar përsa i përket qasjes integruese ndaj sasisë dhe cilësisë së mjedisit, duke përfshirë trashëgiminë si faktor kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Duke pasur parasysh këtë gjendje, është e rëndësishme dhe e nevojshme që zyrtarët e trashëgimisë ta kenë të përcaktuar rolin e tyre aktiv në procesin e vlerësimit të mjedisit, kryesisht për shkak se ata jenë drejtuesit e procesit të njohjes së trashëgimisë si vlerë kombëtare, si vlerë që duhet të mbrohet dhe shfrytëzohet në jetën bashkëkohore të komuniteteve.

Analiza e konservimit për zhvillimin e procesit të planifikimit

1. Udhëzimi administrativ nr. 29/2003 për zbatimin e Ligjit “Për Planifikimin Hapësinor” për elementet themelore të përmbytjes së Planit Hapësinor të Kosovës (neni 2, pika 5.8); Udhëzimi administrativ nr. 29/2003 për zbatimin e e Ligjit “Për Planifikimin Hapësinor në elementet themelore të përmbytjes së planeve të veçanta për zonën e veçantë, neni 2.2 dhe neni 4, nën 5.1, në pikën gjashtë; Udhëzimi administrativ nr. 33/2003 për zbatimin Ligjit “Për Planifikimin Hapësinor” në elementet themelore të përmbytjes së planit zhvillimor komunal, neni 2 nën 5.2.6; Udhëzimi administrativ nr. 34/2003 për zbatimin e Ligjit “Për Planifikimin Hapësinor” në elementet themelore të përmbytjes së planit zhvillimor urban, neni 2, nën 5.2.8; Udhëzimi administrativ nr. 40/2005 mbi zbatimin e planifikimit hapësinor në kushte pëlqimi të planifikimit urban dhe pëlqimi për leje ndërtimi, neni 4.2 B paragrafi nëntë; Udhëzimi administrativ nr. 41/2005 për zbatimin e Ligjit “Për Planifikim Hapësinor” në elementet themelore të përmbytjes së planeve rregullatore urbane, neni 2 pika .2.3 nën m.

Ka zgjidhje të ndryshme për zhvillimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kompetente në fushën e trashëgimisë dhe planifikimit. Ndërgjegjësimi për vlerësimet praktike të ndikimit të trashëgimisë mund të bëhet me marrëveshjen (sipas procedurave ligjore) e grupeve të ekspertëve të mjedisit ku përfshihen edhe zyrtarët e trashëgimisë në fazat specifike të zhvillimit të skemave të planifikimit. Një nga fazat e para me rëndësi në proces është që të përfshihen zyrtarët që merren me çështjet e trashëgimisë në hartimin e një studimi për identifikimin, vlerësimin e trashëgimisë dhe për nxjerrjen e rekomandimeve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin në përputhje me nevojat e planeve zhvillimore.

Udhëzuesi për **Hartimin e Bazës Konservuese për Trashëgiminë Kulturore brenda Planifikimit (BK)** synon të nxjerrë në pah cilësitë dhe potencialin e trashëgimisë në zhvillimin e ardhshëm të një zone, nëpërmjet një analize fleksibile, sistematike dhe transparente që mund të jetë mjet i fuqishëm drejt menaxhimit të balancuar mirë dhe zhvillimit të strategjive dhe planeve sektoriale. Këto analiza janë mjete që mbështesin punët planifikuese që rrjedhin nga çështjet themelore që kanë ndikim mbi marrëdhëniet dhe balancën ndërmjet forcave të vazhdimësisë dhe ndryshimit në zonën objekt studimi.

Additional analysis of development requirements, potential and opportunities, i.e. consideration of attractiveness, revitalisation, capacity and utility of cultural heritage as a factor of sustainable development, particularly in terms of policies on cultural tourism, shelter and office space, fostering tradition and old crafts, education, etc. are also required.

In this regard, impact assessment and consideration of possible negative impact on the cultural heritage in the process of planning and management, especially if the effects are manifested as pressure of urbanisation, abandonment, dislocation, changes in structure and appearance of the assets or any other effects which jeopardise the integrity of the heritage, is also necessary to be provided. The legal basis for development of such integrative approach to the heritage in planning are the Law No. 03/015 on Environmental Impact Assessment (2010) that is in accordance with the Law No.03/L-214 on Environmental Strategic Assessment (2009).

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR HARTIMIN E BAZAVE

Procedura ligjore

- Baza duhet të përgatitet në përputhje me llojin e planit, me mjete prioritare dhe financiare, të përcaktuara në programet vjetore dhe shumëvjeçare të miratuara nga ministri i kulturës, dhe në përputhje me planet dhe programet zhvillimore.
- Baza duhet të përgatitet nga institucionet kompetente për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të patundshme, në përjashtim të rasteve të caktuara të justifikuara kur institucioni përgjegjës brenda MKRS-së specifikon një subjekt ligjor tjetër, osenjë ekip të përzier ekspertësh nga fusha të ndryshme.
- Baza duhet të miratohet nga institucioni kompetent brenda MKRS-së.
- Vetëm baza e miratuar mund të përdoret për përgatitjen e draftit për planifikim hapësinor dhe urban.
- Duhet të zhvillohet një procedurë ligjore për zbatimin e bazës në skemat e planifikimit zhvillimor, duke marrë parasysh mendimin e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor.

Struktura e analizës që do të kryhet:

- Puna përgatitore:
 - fillimi i procesit dhe programi i analizës (të lidhura me programin(et) përkatës, planin përgjegjës të zhvillimit, ose procesin përkatës të vendimmarrjes,
 - krijimin e grupit të ekspertëve bazuar në bashkërendimin dhe bashkëpunimin shumëdisiplinar,
 - mjetet financiare në dispozicion, etj.).

Faza përshkruese

- nxjerr në pah karakterin historik të zonës objekt analize (mbledh informacion rreth origjinës së lokalitetit dhe zhvillimin/ndryshimet;
- kategoritë e trashëgimisë dhe llojet e njohura të saj;
- kapacitetet infrastrukturore ;
- sistemimin e informacionit historik – duke ofruar një panoramë të përgjithshme të përmbajtjeve dhe marrëdhënies së hapësirës;)
- Faza e interpretimit:
 - thekson vlerën historike të zonës (lexueshmërinë historike të periudhave historike, shtresa dhe histori, të rëndësishme për popullin dhe shoqërinë,
 - vlerësimin e gjendjes, integritetit dhe origjinalitetit të zonës për të ndihmuar në përcaktimin se deri në çfarë mase përfaqëson dhe shpreh rëndësinë historike fenomeni fizik në mënyrë efektive).
- Faza e vlerësimit:
 - vlerëson cilësitë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore;
 - heton mënyrat alternative për ruajtjen ose zhvillimin e trashëgimisë kulturore të lidhur me hapësirën me vlerësimin e potencialit dhe cenueshmërisë së saj.
- Faza e mundësimit:
 - përcakton shkallën e ndërhyrjes,
 - duke propozuar masa mbrojtëse dhe
 - rekomandime për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore të zonës,
- Faza përmbledhëse:
 - përmbledh pikat dhe çështjet më të rëndësishme që duhet të integrohen në procesin pasues të planifikimit.

PËRZGJEDHJE E SHPREHJEVE TË PËRDORURA NË UDHËZUES

Konservimi i integruar, nënkupton një sërë masash që kanë për qëllim sigurimin e ekzistencës së vazhdueshme dhe pasurimit të trashëgimisë si dhe ruajtjen, restaurimin, rigjenerimin, shfrytëzimin, dhe rivitalizimin e saj;

Konservimi nënkupton masat ligjore, administrative, organizative, funksionale dhe masa të tjera në dispozicion të shtetit, rajoneve dhe komunave që kanë për qëllim ruajtjen dhe pasurimin e trashëgimisë. Masat e caktuara mbrojtëse tëndryshme nga ato ligjore dhe administrative, duhet të zbatohen nga subjektet e tjera mbrojtëse;

Asetet e paluajtshme të trashëgimisë kulturore nënkuptojnë trashëgiminë e ndërtuar, të përfaqësuar nga një qytet historik, treg ose qender fshati, pjesë tij, ose nga një zonë tjetër historike e ndërtuar;

Zona e mbrojtur nënkupton kufirin e monumentit të mbrojtur (aset i patundshëm kulturor) dhe zonës që e rrethon atë.

Hulumtimi nënkupton punët e kryera sa i përket trashëgimisë lidhur me nevojat për mbrojtjen e saj, më specifikisht me qëllimin e ekzaminimit të pjesëve të saj dhe marrjes së të dhënave mbi rëndësinë, gjendjen fizike dhe ekzistencën e një kanosje, apo kërcënimeve për ruajtjen e saj;

Hulumtimi paraprak nënkupton hulumtimin e trashëgimisë dhe mjedisit, i cili duhet të kryhet me qëllim të: 1. informimit të nevojshëm për vlerësimin e trashëgimisë para zhvillimit në një zonë të caktuar, ose 2. specifikimit të masave mbrojtëse.

Sondazh për vlerësimin e trashëgimisë në kuadrin e vet hapësinor nënkupton përmirësimin e regjistrit të trashëgimisë me të dhëna mbi gjendjen aktuale fizike të trashëgimisë dhe vlerësimin e një zonë të caktuar në dispozicion të autoriteteve planifikuese nëpërmjet një sondazhi të rekomanduar nga ekspertët;

Regjimi mbrojtës nënkupton ato rregulla të cilat, duke pasur parasysh rëndësinë historike të monumentit dhe në bazë të

vlerësimit të tij vendosin kufizime në të drejtat e pronësisë dhe të drejtat tjera, si dhe përcaktojnë masat për zbatimin e mbrojtjes;

Mirëmbajtja nënkupton punët që mundësojnë ruajtje fizike të trashëgimisë nga forcat e dëmshme dhe qëndrueshmërinë e saj përmes përdorimit të përshtatshëm. Qëllimi i mirëmbajtjes është konservimi i trashëgimisë.

BAZAT E KONZERVIMIT

Baza për konservim (“baza”) si dokumentacion bazë për trajtimin e aseteve të trashëgimisë së patundshme kulturore në planifikimin hapësinor dhe urban dhe në varësi nga lloji i planit, mund të jetë:

- baza për zonën e përfshirë në Planin Hapësinor të Kosovës në lidhje me planin hapësinor për zona hapësinore;
- bazat për zonën e veçantë të përfshirë në Planin zhvillimor të Komunës (neni 13 I LPH);
- baza për zonën e përfshirë në Planin Zhvillimor Urban
- baza për zonën e përfshirë në Planin Rregullues Urban.

I. PËRMBAJTJA E BAZAVE

Baza e konservimit, pavarësisht nga lloji i planit përkatës, përmban:

- A. pasqyrën tekstuale/me shkrim;
- B. pasqyrën grafike; shcallën e hartës; sitatutën aktuale
- C. pasqyrën e dokumenteve, hartave, fotografive, gjendjes historike dhe legjislative

Pasqyrat janë të harmonizuara reciprokisht dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

A. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM STUDIMOR/ME SHKRIM

Pasqyra tekstuale/me shkrim përmban kapitujt vijues:

1. argumentet ligjore dhe programore të bazës;
2. identifikimin e zonës të përfshirë në bazë;
3. planet aktuale për zonën e përfshirë;

4. inventarin e aseteve të trashëgimisë kulturore të përfshira në këtë zonë;
5. vlerësimin e gjendjes së trashëgimisë;
6. masat mbrojtëse.

1. Kapitulli mbi themelet ligjore dhe programore të bazave përmbanë:

- a) informacion të përgjithshëm mbi rregulloren dhe dispozitat (Legjislacionin) e lidhura me përgatitjen e bazës, planin përkatës dhe politikat për mbrojtjen e integruar;
- b) elementet themelore të strategjisë kombëtare për konservim të integruar dhe të dokumenteve të tjera strategjike në fuqi;
- c) informacion themelor mbi programet tjera të parashikuara për përgatitjen e bazës dhe të planit përkatës.

2. Kapitulli mbi identifikimin e zonës së përfshirë në bazë përfshinë:

- a) përshkrimin e kufijve të zonës së përfshirë;
- b) sipërfaqen e përgjithshme të zonës së përfshirë;
- c) të dhëna tjera të rëndësishme për identifikimin e zonës së përfshirë, në veçanti të lidhura me: komunat, komunat dhe vendbanimet kadastrave, ose pjesët që i përkasin zonës së përfshirë, në varësi të llojit të bazës;

3. Kapitulli mbi planet aktuale për zonën e përfshirë përmbanë:

- a) të dhëna mbi llojin, autoritetin vendimmarrës, kohën e vendimit, hyrjen në fuqi, periudhën e vlefshmërisë dhe të dhëna tjera të ngjashme mbi planet ekzistuese hapësinore dhe urbane, duke përfshirë ndryshimet ose plotësimet e tyre, si më poshtë:
 - për planin e të njëjtës kategori;
 - për planin apo planet e kategorive më të larta;
 - për planin apo planet e kategorive më të ulëta.
- b) pasqyrën e përgjithshme të vendimeve planifikuese të lidhura me trashëgiminë kulturore, të ndara veçmas për secilin plan, të radhitura sipas llojit apo radhitjes së planit;
- c) vlerësimin e zbatimit të zgjidhjeve të planifikuara dhe ndikimit të tyre në trashëgiminë kulturore, duke i kushtuar rëndësi posaçërisht zgjidhjeve të mundshme të diskutueshme në planet e të njëjtit nivel, ose të planit që do të zhvillohet.

4. Kapitulli mbi inventarin përmbanë:

Në lidhje me statusin e aseteve të trashëgimisë kulturore, ky kapitull përfshin inventarët vijues:

- inventarin e aseteve të patundshme të trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përhershme;
- inventarin e aseteve të patundshme të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme;
- inventarin e aseteve të pambrojtura të trashëgimisë kulturore të patundshme që duhet të jenë në mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

Në lidhje me llojin e planit, përfshihen inventarët vijues:

- inventari i trashëgimisë mbi bazën e zonës së përfshirë në planet hapësinore (planet hapësinore për zona të veçanta), i cili përmban:
 - të dhëna të përmbledhura sipas llojit të asetit
 - numri, vendi, origjina kronologjike/historike, sipërfaqja, gjendja, funksioni dhe informacione të tjera të rëndësishme ;
- inventari i trashëgimisë mbi bazën e zonës së përfshirë në planin zhvillimor urban, i cili përmban:
 - pasqyra me të dhëna të përgjithshme për asetet dhe zonat e tyre mbrojtëse – p.sh. emrin, vendin, datën e ndërtimit, vlerën dhe kuptimin, kufijtë, sipërfaqen, gjendjen, funksionin dhe informacione të tjera;
- inventari i trashëgimisë mbi bazën e zonës së përfshirë në planet rregulluese urbane, i cili përmban:
 - të dhëna të detajuara mbi secilin aset veçmas, në veçanti – emrin, vendin, adresën, ngastrën kadastrale, përshkrimin e përmbajtjes/veçorive, kufijtë e asetit dhe zonave të tij të mbrojtura, sipërfaqjen e asetit dhe të zonave të tij mbrojtëse, ose sipërfaqen e përgjithshme e lokalitetit/bërthamës së mbrojtur, autorin/punëtorinë, datën e ndërtimit, stilin (et) e ndërtimit të përcaktuar historikisht, konstruksionet dhe materialin e shfrytëzuar, ndërhyrjet strukturore, pikturuese apo ndërhyrjet e tjera konservuese, funksionin e mëparshëm apo aktual, gjendjen apo

shkallën e ruajtjes, llojin i pronësisë dhe të dhëna të tjera të ngjashme që kontribuojnë për identifikimin dhe kuptimin më të mirë të veçorive të aseteve.

5. Kapitulli mbi vlerësimin e gjendjes përmbanë:

Bazuar në *Llojin e planit*, bëhet analiza e mëposhtme mbi mjedisin kulturor:

- analiza e zhvillimit hapësinor, për planin hapësinor në fjalë, e cila përfshin:
 - pasqyrën e zhvillimit historik të zonës, ku theksohet origjina dhe zhvillimi i vendbanimeve dhe komplekseve tjera të rëndësishme monumentale, peizazhet kulturore dhe monumentet, trajtimet e tyre në periudha të ndryshme kohore, lidhjet me aglomeratet e afërta apo elementë të tjera si dhe ndikimi i tyre në zhvillimin dhe ndryshimet e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore, të dhënat tjera të rëndësishme për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës që përcaktojnë vendin, rolin dhe kuptimin e trashëgimisë kulturore në të kaluarën dhe në të tashmen;
- analiza e zhvillimit urban të planit zhvillimor urban, e cila përfshin:
 - pasqyrën e zhvillimit historik të qytetit dhe rrethinës së tij, ku theksohen modelet urbane dhe transformimi i tyre gjatë kohës, organizimi morfologjik i qytetit në fazat e ndryshme të zhvillimit të vet, lidhja me aglomeratet e afërta apo me elementët e tjera dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e qytezës/qytetit, identifikimi i hapësirës urbane dhe dimensioneve të saj, duke përfshirë kështjellat, qasjet kryesore, infrastrukturën dhe pajisjen urbane, rregullat kryesore, ose tendencat në zhvillimin historik të qytetit dhe aspektet tjera që i kontribuojnë kuptimit të duhur dhe të plotë të dimensionit historik të zhvillimit të qytetit dhe rrethinës së tij;

detailed overview of the historical development of the town/city or village as a

- analiza e zhvillim urban të planit rregullator urban në fjalë, e cila përfshin:

- pasqyrën e detajuar e zhvillimit historik të qytetit/qytezës apo fshatit si tërësi, dhe rrethinës së tij, zhvillimin urban të qendrave historike, fazat historike të ndërtimit të ndërtesave të rëndësishme në qytet/qytezë ose fshat dhe rrethinat e tyre, raportin me qendrat e ndryshme të ndikimit në mjedisin e afërt ose më të gjerë dhe aspekte të tjera që shërbejnë për të kuptuar më saktë dhe më plotë zhvillimin historik të zonës së përfshirë;

Bazuar në *Llojin e planit*, bëhet analiza e mëposhtme për gjendjen aktuale të trashëgimisë:

- Për të gjitha llojet e bazave: pasqyra e gjendjes aktuale e bazuar në fakte dhe statusi ligjor i trashëgimisë kulturore, niveli i ruajtjes ose niveli i dëmtimit, shkaktarët e dëmtimit, ndërhyrjet e mëparshme konservuese, mundësia për shfrytëzim efektiv, mënyra sesi shkohet në monument dhe gjendja e infrastrukturës tjetër në zonat e mbrojtura, subjektet përgjegjëse për mbrojtje dhe menaxhim të trashëgimisë kulturore dhe gjithashtu të dhënat tjera të rëndësishme në planin përkatës;
- Për bazat për planin zhvillimor urban, përveç pasqyrave të përmendura më lartë, paraqitet edhe: analiza kronologjike, kulturore, estetike, arkitekturore, tipologjike, morfologjike, funksionale etj., dhe analiza të tjera të qytetit, pamjet e tij, lidhjet me peizazhin apo rrethinën, lidhjet me bërthamën historike dhe vendbanimet e reja etj.;
- Për bazat për planin rregullator urban dhe/ose planifikimin urban për fshatrat dhe jashtë vendbanimeve, përveç pasqyrave (dy pikat e përmendura më lartë), paraqitet edhe: një analizë e detajuar e të gjitha aspekteve përkatëse e planifikimit hapësinor, veçanërisht analiza historike-artistike, analiza e veçorive strukturore të bërthamave historike (analiza tipologjike e modelit urban, ndërtesave të caktuara, ngastrave ndërtimore, kuarteve, dhe hapësirave të hapura, analiza e siluetave, ritmit, gjërave dominuese dhe ngjyrave, analiza e kompozicionit, analizat arkitekturore-teknike (numri i kateve dhe lloji i kulmit, sistemi ndërtimor, materiali ndërtimor, blloqet urbane dhe hapësirat e hapura, dhe elementet karakteristike të fasadës), analizat e funksionit (funksioni i mëparshëm

dhe i tanishëm i ndërtesave të mbrojtura, komplekseve dhe hapësirave të zbrazëta), analiza socio-ekonomike, demografike, pronësore-ligjore dhe analiza të tjera të detajuara të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë zonat e saj të mbrojtura, hapësirat publike dhe private, dhe zonat e gjelbra në zonën e përfshirë.

6. Kapitulli mbi *masat* mbrojtëse përmbanë:

- Vlerësimin, i cili përfshin shqyrtimin e nevojës për të realizuar mbrojtjen e aseteve të patundshme të pambrojtura kulturore dhe statusit të tyre të ardhshëm të mbrojtjes, pra me fjalë të tjera nëse është e nevojshme të fitohet statusi i mbrojtjes për:
 - asetet e trashëgimisë kulturore të mbrojtura në mënyrë të përhershme;
 - asetet e trashëgimisë kulturore me mbrojtje të përkohshme; ose
 - zonat rezervat arkeologjik.
- Rivlerësimin e aseteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore, i cili përfshin shqyrtimin e nevojës për të ripërcaktuar vlerat, kuptimin, kufijtë apo regjimin mbrojtës të trashëgimisë kulturore, përta i përket zgjerimit, pra forcimit të mbrojtjes, ose përta i përket zvogëlimit, pra zvogëlimit ose ndërprerjes së mbrojtjes.
- Regjimin e mbrojtjes, i cili përfshin zonat e mbrojtura dhe standardin e ndërhyrjeve të lejueshme, si për shembull veprimin që mund të ndërmerret për mbrojtjen e aseteve dhe rrethinave të tyre të afërta, shprehur përmes:
 - mbrojtjes së nivelit të parë;
 - mbrojtjes së nivelit të dytë;
 - mbrojtjes së nivelit të tretë.
- Masat e veçanta mbrojtëse të lidhura me masat konservuese/restauruese, ligjore, administrative dhe masa të tjera preventive dhe korrektuese, siç janë: mbikëqyrja arkeologjike, hulumtimi mbrojtës arkeologjik, hulumtimi konservues, mbledhja e të dhënave dhe regjistrimi, përgatitja e studimeve të veçanta, elaboretet, programet dhe projektet urbane, masat parandaluese mbrojtëse në rast të konfliktit të armatosur dhe fatkeqësive natyrore, masat mbrojtëse si pasojë e ndotjes, masat për të

përmirësuar cilësinë e mjedisit në zonat e mbrojtura, restaurimi, shpëtimi, ruajtja, hipotekat, shpronësimi dhe masa të tjera në përputhje me ligjin.

B. VËSHTRIMI GRAFIK

Pasqyra grafike e bazës përmban pasqyrat kartografike dhe pasqyrat e tjera grafike të kushteve/gjendjes së zonës dhe projektit të mbrojtjes të përshkruar në pasqyrën tekstuale, të lidhur veçanërisht me:

- inventarin;
- analizën dhe vlerësimet;
- masat mbrojtëse.

Pasqyra grafike e bazës përmban:

- për bazat që duhet të përfshihen në planin hapësinor të Kosovës (duke iu referuar planeve hapësinore për zonat e veçanta) pasqyra kartografike në shkallën 1:100 000;
- për bazat që duhet të përfshihen në planet zhvillimore komunale: pasqyra kartografike në shkallën 1:50 000 ose 1:25 000;
- për bazat që duhet të përfshihen në planet zhvillimore urbane: pasqyra kartografike mbi bazën gjeodezike në shkallën 1:10 000 (për qytetet më të mëdha), dhe 1:5 000 ose 1:2 500 deri 1:1 000 (për qytetet e tjera);
- për bazat që duhet të përfshihen në plane rregulluese urbane: pasqyra kartografike mbi bazën gjeodezike në shkallën 1:2 500, ose 1:1 000 deri 1:500, dhe regjistrimet arkitekturore (baza, siluetat, fasada e të ngjashme) në shkallën 1:200 deri 1:100;
- për bazat që do të përfshihen në planet urbane jashtë vendbanimeve: pasqyra kartografike në shkallën 1:25 000 ose 1: 10 000 dhe pasqyra grafike në shkallën 1:2 500 deri 1:500.

C. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM MBI DOKUMENTACIONIN

Pasqyra e dokumentacionit përmban dokumentacionin përshkruar, teknik dhe fotografik.

- *Dokumentacioni përshkruar* përmban formularin e regjistrimit të subjekteve përgjegjës për krijimin e

bazës, aktin e vendimit mbi emërimin e menaxherit të grupit të ekspertëve për krijimin e bazës, pjesë nga rregulloret/legjislacioni pozitiv, programin dhe planet në fuqi, kushtet për planifikimin hapësinor të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, arkivin, bibliografinë, listën e burimeve, studimeve, programeve, dhe projekteve mbi trashëgiminë kulturore dhe zonën e përfshirë si dhe çdo dokumentacion tjetër të rëndësishëm për planifikimin.

- *Dokumentacioni teknik* përmban hartat e vjetra, bazën gjeodezike, të dhënat arkitekture, skicat, gravurat, dhe çdo dokumentacion tjetër të ngjashëm për asetet e trashëgimisë kulturore që gjenden në zonën në fjalë.
- *Dokumentacioni fotografik* përmban fotografi të vjetra dhe regjistrime të gjendjes aktuale me ngjyra, bardhë dhe zi ose dixhitale, duke përfshirë regjistrimet me satelit dhe nga ajri, panoramat, perspektivat, siluetat, gjërat dominuese, eksterierin dhe detajet karakteristike të ndërtesës(ve) në zonën në fjalë.

Çdo pjesë e dokumentacionit përmban shënimin e duhur numerik, çdo shenjë tjetër dhe legjendën përkatëse.

Kërkesa teknike

Baza zhvillohet në një ose më shumë vëllime, në përputhje me qëllimin e përpunimit të materialit dhe të metodës së përpunimit. Baza zhvillohet dhe verifikohet në pesë kopje identike. Baza zhvillohet në formë elektronike.

II. METODOLOGJIA PËR ZHVILLIMIN E BAZAVE

1. Kushtet e përgjithshme
 - 1.1. Krijimi i bazës për konservim duhet të bëhet në përputhje me programin(et) për krijimin e bazave për konservim.
 - 1.2. Krijimi i bazës për planifikim hapësinor dhe urban, me përjashtim të bazës për planet rregullatore urbane, duhet të bëhet pas parashtrimit të kërkesës për hartimin e këtyre planeve dhe në pajtim me kushtet e caktuara për planifikim hapësinor.
 - 1.3. Kushtet për planifikimin hapësinor në fjalë

parashikohen në përpiluesit e planit për nevojat e të cilëve krijohet baza.

2. Procesi

2.1. Krijimi i grupit të punës

2.1.1. Krijimi i bazës fillon me formimin e një ekipi të përzier ekspertësh nga subjekti përgjegjës për krijimin e bazës.

2.1.2. Ekipi i ekspertëve punon në përputhje me aktin e vet të themelimit dhe programin operacional për krijimin e bazës përkatëse.

2.2. Përgatitja e programit operacional

Programi operacional përcakton llojin, objektin dhe kohën e zbatimit të aktiviteteve, veçanërisht në lidhje me:

- mbledhjen e dokumentacionit dhe të dhënave ekzistuese;
- kryerjen e hulumtimit të nevojshëm;
- krijimin e dokumentacionit të ri.

3. Hulumtimi

3.1. Për krijimin e bazës përdoren të dhënat e inventarit dhe regjistrit kombëtar të të dhënave të trashëgimisë kulturore, dokumentacioni që ekziston për vlerësimin e aseteve që janë të vlerësuara dhe në statusin e mbrojtjes së përhershme, të dhënat për statusin e trashëgimisë së mbrojtur, propozimet për dhënie e statusit të aseteve të trashëgimisë kulturore që gëzojnë mbrojtje të përhershme, hulumtimi arkeologjik dhe konservues, menaxhimi dhe përdorimi i aseteve të mbrojtura dhe çdo dokumentacion tjetër i nevojshëm ekzistues në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.

3.1.1. Për krijimin e bazës mund të shfrytëzohen të dhëna dhe dokumentacione të tjera të përshtatshme, veçanërisht informacione që lidhen me planifikimin hapësinor dhe urban, kadastrën, statistikën, mbrojtjen e ambientit, turizmin, transportin, shfrytëzimin e burimeve minerale, tokën e shfrytëzuar, mbrojtjen dhe shpëtimin në rast të konflikteve të armatosura dhe fatkeqësive natyrore, dhe informacione nga fushat tjera që kanë pika të përbashkëta me konservimin e integruar të trashëgimisë kulturore.

3.1.2. Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve zhvillohet në fazën fillestare, përgatitore të punës.

3.1.3. Kushtet specifike të hulumtimit.

3.1.4. Për krijimin e bazës zakonisht shfrytëzohen

- rezultatet e hulumtimeve të mëparshme.
- 3.1.5. Përjashtimi është i mundshëm vetëm kur ka arsye të justifikuar. Në këto raste, për krijimin e bazës mund të bëhet hulumtim i ri, veçanërisht hulumtim që lidhet me procesin e vlerësimit të aseteve të reja ose përkohësisht të mbrojtura në kuadrin e zhvillimit të hulumtimit historiko-bibliografik, arkivor, statistikor dhe të hulumtimeve të tjera të nevojshme.
- 3.1.6. Hulumtimi arkeologjik dhe hulumtime të llojeve të tjera në terren mund të bëhet vetëm nëse të dhënat dhe dokumentacioni në dispozicion janë të pamjaftueshme apo nëse ka arsye të tjera të justifikueshme për kryerjen e këtyre lloj hulumtimesh .

4. Përpunimi i të dhënave dhe paraqitja e analizës së kryer

4.1. Dispozita të përgjithshme

4.1.1. Për vështirimin e përgjithshëm studimor:

Gjatë përpunimit dhe paraqitjes së të dhënave në procesin e studimit të bazës përdoren tabela, grafikë, diagrame, skema dhe forma të tjera të pasqyrimit të të dhënave të përpunuara. Rishikimi i bazës gjatë punës studimore mund të ilustruhet përmes përzgjedhjes së fotografive të duhura, skicave dhe vizatimeve të lidhura me njësinë përkatëse tematike.

Çdo lloj i materialit ilustrues ka numrin e tij specifik dhe një sqarim të veçantë, për shembull emrin ose legjendën të ndryshme nga emri dhe legjenda e përmendur kapitulli për vështirimin e përngjithshëm mbi dokumentacionin.

4.1.2. Për vështirimin e përgjithshëm grafik

Për krijimin e pasqyrës grafike përdoren hartat e përditësuar topografike dhe baza gjeodezike e ofruar nga mbajtësi i planit për nevojat e të cilit krijohet baza. Nëse pasqyra grafike nuk mund të përgatitet në një faqe të vetme në shkallën e duhur, atëherë para pasqyrës grafike afër pjesës grafike duhen shtuar fletët me pjesët numerike që janë të lidhura me pasqyrën.

4.1.2.1. Përgatitja grafike bëhet me shenja dhe simbole për paraqitje grafike të bazave sipas:

- shenjave dhe simboleve themelore në shtojcën grafike të

planeve urbane siç përshkruhet në rregulloret e fushës së planifikimit hapësinor dhe sipas shenjave dhe simboleve të veçanta të paraqitjes grafike të trashëgimisë kulturore siç përshkruhet në rregulloret e fushës së trashëgimisë kulturore.

4.2. Specifikimi i analizës së kryer

4.2.1. Kufijtë e zonës së përfshirë në bazë, me përjashtim të bazës për Planin Hapësinor të Kosovës, përfshihen në listë si më poshtë:

4.2.1.1. Në vështirimin e përgjithshëm studimor të bazës: në mënyrë përshkuese, duke ndjekur pikat kryesore, drejtimin e zgjerimit, rregulloret/dekretet zyrtare dhe masat ose treguesit e tjerë të nevojshme për identifikim, nëse përshkrimi i kufirit nuk është dhënë në aktin përkatës.

4.2.1.2. Në vështirimin e përgjithshëm grafik të bazës: me shenja dhe simbole specifike.

4.2.1.3. Nëse përshkrimi i zonës së planifikuar është i përcaktuar me ligji, me plan të një niveli më të lartë, me aktin e realizuesit të planit ose në një mënyrë tjetër, akti korrespondues duhet të paraqitet në vështirimin e përgjithshëm studimor .

4.2.1.4. Nëse përshkrimi i kufijve të asetit të mbrojtur dhe zonave të tij të mbrojtura është dhënë në aktin e mbrojtjes, vështirimi i përgjithshëm studimor duhet të përfshijë aktin korrespondues.

4.2.1.5. Në bazë përfshihet përshkrimi i kufijve të aseteve të pambrojtura që duhet të jenë asete të mbrojtura, duke përfshirë përshkrimin e zonave të tyre potenciale të mbrojtura, qoftë në analizën studimore dhe në mënyrë grafike, duke përdorur shenja dhe simbole të veçanta. Kjo dispozitë zbatohet në rastet kur kufijtë e aseteve nën mbrojtje të përhershme dhe/ose kufijtë e zonave të tij të mbrojtura nuk janë specifikuar në aktin për mbrojtje, ose kur përshkrimi në aktin përkatës është i paqartë ose i paplotë.

4.2.2. Gjendja e e aseteve të mbrojtura brenda zonën së përfshirë

4.2.2.1. DTë dhënat e lidhura me asetet e trashëgimisë

kulturore që gjenden në zonën e përfshirë përpunohen dhe paraqiten bazuar në llojin e asetit, si për shembull mbi bazën e klasifikimit (kategorisë/nënkategorisë/grupet/nëngrupet/llojet e trashëgimisë kulturore) në përputhje me përkufizimet e Ligjit “Për Trashëgiminë Kulturore” dhe të Udhëzuesit për inventarizim të aseteve të trashëgimisë së patundshme kulturore.

4.2.2.2. Për asetet e klasifikuara, duhet të përdoret lloji i përshtatshëm i pasqyrave grafike, duke përfshirë në veçanti:

- përmbledhjet grafike të aseteve që janë në mbrojtje të përhershme, sipas llojit/kategorisë së tyre;
- përmbledhjet grafike të aseteve që janë në mbrojtje të përkohshme, sipas llojit/kategorisë së tyre;
- përmbledhjet grafike të aseteve të pambrojtura, sipas llojit/kategorisë së tyre.

4.2.2.3. Përjashtimet lejohen në rastet kur në zonën e përfshirë ka më shumë se një lokalitet arkeologjik të një lloji, për të cilat mund të krijohet një shtojcë e veçantë grafike, duke përfshirë në veçanti:

- përmbledhja grafike e lokaliteteve arkeologjike në mbrojtje të përhershme;
- përmbledhja grafike e lokaliteteve arkeologjike të pambrojtura dhe/apo në mbrojtje të përkohshme;

4.2.3. *Kushtet për vlerësimin e trashëgimisë kulturore*
Analizat e lidhura me vlerësimin e trashëgimisë kulturore të zonës së përfshirë në plan, pavarësisht nga lloji i bazës, bazohen në studime krahasuese ndërdisiplinare dhe shumëdisiplinare.

4.2.3.1. Rezultatet e analizave të vështirimit të përgjithshëm studimor të bazës janë përshkruese dhe në gjerësi korrespondojnë me llojin e bazës/planit.

4.2.3.2. Për rezultatet e analizave, duhet të krijohet lloji dhe numri i duhur i shtojcave grafike, duke përfshirë veçanërisht:

- përmbledhjet grafike të fazave të zhvillimit historik;
- përmbledhjet grafike të gjendjes aktuale ;
- përmbledhjet grafike të nevojave, potencialeve dhe mundësive;

- përmbledhjet e veçanta grafike sipas llojit të analizës.

Në përpunimin grafik të analizave përparësi i jepet përmbledhjes grafike lidhur me:

- funksionin e aseteve (të parë, të ndryshuar në një periudhë të caktuar kohore, funksionin aktual ose funksionin potencial në të ardhmen);
- shkaqet e prishjes/dëmtimit/shkatërrimit të aseteve;
- shkallën e ruajtjes/paraqitjes së aseteve;
- identifikimin e hapësirave dhe zonave të gjelbra (ekzistuese dhe të planifikuara në të ardhmen);
- zonat e parashikuara për ndërtim dhe rregullim territorial.

4.2.4. *Vlerësimi i gjendjes aktuale*

4.2.4.1. Si pjesë përbërëse e analizës së gjendjes aktuale të aseteve, klasifikohen katër nivelet vijuese:

nivel i mirë;
nivel mesëm;
nivel i dobët;
rrënoja.

4.2.4.2. Nivelet e ruajtjes përpunohen në:

- Përshkrimin e përgjithshëm studimor të bazës: dokument përshkrues deri në nivelin që është i përshtatshëm për llojin e bazës, dhe informacion për llojin, përmbajtjen dhe statusin e aseteve;
- Përmbledhjen grafike të bazës: përmes një ose më shumë pasqyrave të sintetizuara dhe/ose pasqyrave grafike të veçanta sipas llojit të aseteve ose sipas statusit të tyre të mbrojtës.

4.2.5. *Shkaqet e dëmtimit/shkatërrimit të aseteve ose elementeve të tjera përgjegjëse për gjendjen aktuale*

4.2.5.1. Shkaqet për prishje, dëmtim dhe shkatërrim të aseteve, si pjesë përbërëse e analizës së gjendjes aktuale, klasifikohen në katër grupet vijuese:

Grupi A – prishja e shkaktuar nga fenomenet natyrore, kryesisht nga tërmetet, rrëshqitjet e tokës, vërshimet dhe fenomene të tjera të ngjashme;

Grupi B – prishja e shkaktuar nga struktura e ndërtesës, kryesisht nga materiali i përdorur ndërtimor, sistemi ndërtimor, infrastruktura dhe elemente të tjera të ngjashme;

Grupi C – prishja e shkaktuar nga zhvillimi historik, ekonomik dhe social, kryesisht nga emigrimi, migrimi, ulja e popullatës dhe

elementë të tjerë të ngjashëm;

Grupi D – prishja e shkaktuar nga aktivitetet shkatërruese të njeriut, luftërat dhe konflikte të tjera të armatosura, zjarret, ndotja, ndërtimi i pakontrolluar dhe i paligjshëm dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

4.2.5.2. Nëse ka dy ose më shumë grupe të këtyre shkaqeve, secili grup duhet të trajtohet dhe dokumentohet veçmas.

4.2.6. *Studim i vlerësimit të trashëgimisë në kuadrin hapësinor/ mjedisor*

Gjatë procesit të vlerësimit vlerësohet vlera e aseteve dhe mjedisi i zonës së përfshirë.

4.2.6.1. Vlerat e aseteve shqyrtohen sipas kriterëve të dhëna në Udhëzuesin mbi kushtet dhe kriteret për vlerësim të aseteve të trashëgimisë kulturore;

4.2.6.2 Vlerat e mjedisit ose të zonave shqyrtohen si: vlera kulturore-historike, socio-ekonomike dhe shfrytëzuese të zonës së përfshirë.

4.2.6.3 Në bazën për plane urbane, veçanërisht për planet rregulluese urbane, shqyrtohen edhe vlerat e mëposhtme: vlerat arkitekturore, infrastrukturore dhe funksionale të strukturës urbane që lidhen me asetin specifik.

4.2.6.4 Në këto raste, vlerësimi duhet të bëhet për ndërtesat ekzistuese, infrastrukturën urbane dhe hapësirat që i japin vlerë pamjeve historike të qendrës/grupit të ndërtesave/ lokalitetit, duke specifikuar se strukturat urbane:

- i japin vlerë mjedisit historik;
- janë neutrale në lidhje me mjedisit historik;
- janë në harmoni me mjedisin historik.

4.2.6.5. Procesi i vlerësimit përcaktohet sipas shkallës së studimit të aseteve, të dhënave në dispozicion dhe dokumentacionit të përfshirë në to dhe në përputhje me qëllimin dhe efektet ligjore të mbrojtjes.

4.2.6.6 Vlerësimi mund të kryhet në të gjitha asetet, ose në pjesën e aseteve të patundshme të listuara në inventarin e trashëgimisë kulturore (baza zyrtare e të dhënave), ose në asetet pa ndonjë status mbrojtjeje ligjore, por të njohura si veçori dalluese me vlerë për zonën e përfshirë që duhen mbrojtur me ligj.

4.2.6.7 Shtrirja e vlerësimit është në përputhje me mundësitë për kryerjen e procedurave të nevojshme për realizimin e mbrojtjes në vitin e parë të zbatimit të planit.

4.2.6.8 Të dhënat mbi asetet që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përhershme përpunohen vetëm në vështirimin e

përgjithshëm studimor të bazës, në përjashtim të rasteve kur është e nevojshme të përgatitet përmbledhja grafike e ndryshimeve në lidhje me kufijtë e aseteve dhe/ose zonave të mbrojtura.

4.2.7. *Regjimi mbrojtës*

4.2.7.1. Regjimi mbrojtës realizohet për asetet që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përkohshme dhe të mbrojtjes së përhershme.

4.2.7.2 Regjimi mbrojtës përcaktohet sipas llojit dhe kategorisë, sipas statusit të aseteve, dhe sipas nevojave dhe mundësive të komunitetit.

4.2.7.3 Regjimi mbrojtës përcaktohet për zonën e mbrojtur në përgjithësi (asetet e mbrojtura dhe zonat e mbrojtura), pavarësisht nga madhësia e asetit dhe zonave të tij të mbrojtura.

4.2.7.4 Përcaktimi i regjimit të mbrojtjes për asetet që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përhershme bëhet përmes shtjellimit të regjimit mbrojtës të vendosur nëpërmjet aktit për mbrojtje.

4.2.7.5 Përcaktimi i një regjimi mbrojtës për asetet që gëzojnë statusin e mbrojtjes së përkohshme ose për asetet që nuk janë nën mbrojtje bëhet sipas Udhëzuesit për Kushtet dhe Kriteret për Vlerësimin e Aseteve të Trashëgimisë Kulturore.

4.2.7.6. Elaborimi i regjimit mbrojtës bëhet për të përcaktuar:

- (i) udhëzimet e përgjithshme për mbrojtje;
- (ii) shtrirjen e zonës(ve) së mbrojtur;
- (iii) nivelin e mbrojtjes.
- (i) *Udhëzimet e përgjithshme* për mbrojtje hartohen mbështetur në bazën e planifikimit, duke iu referuar aktivitetëve që kanë për qëllim:

- përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së trashëgimisë kulturore në zonën e përfshirë;
- sigurimin e kornizës zhvillimore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
- balancimin e mundësive për zhvillim ndërmjet pjesëve të ndryshme të zonës së përfshirë, duke respektuar dhe ruajtur integritetin e trashëgimisë kulturore;
- identifikimin e zonave prioritare ku mund të zbatohen parimet e konservimit të integruar;
- përcaktimin e mbrojtjes së zonave arkeologjike në rast

investimesh infrastrukturore dhe të ngjashme;

- krijimin e një plani menaxhimi për asetet e mbrojtura dhe zonat e tyre të mbrojtura në hapësirën e përfshirë.

(ii) *Shtirja e zonës së mbrojtur dhe niveli i mbrojtjes* elaborohen në baza të planifikimit urban.

Brenda një zone të mbrojtur të hapësirës së përfshirë në plan (asete të mbrojtura dhe zonë(a) e mbrojtur) mund të përcaktohen më shumë zona të mbrojtura, në veçanti:

- zonat nën mbrojtje strikte ose zonat me mbrojtje të veçantë që përcaktohet për zonën e mbrojtur e cila përmban një ose më shumë monumente, komplekse memoriale ose peizazhe kulturore nga kategoria trashëgimi kulturore e rëndësishë së veçantë, ose për zonën e mbrojtur të lokalitetit arkeologjik.
- zona nën regjim mbrojtës të kufizuar/garantuar që përcaktohet si pjesë e hapësirës së mbrojtur (zonat e mbrojtura të aseteve të mbrojtura), e cila përmban një apo më shumë monumente, komplekse memoriale, peizazhe kulturore, ose asetet në mbrojtje të përkohshme.
- zona pa mbrojtje që janë pjesë e hapësirës së mbrojtur në hapësirën e përfshirë, e cila përjashtohet nga regjimi mbrojtës për shkak të shkeljes së madhe të integritetit të hapësirës së mbrojtur.

Në zonat e mbrojtura, si një lloj i hapësirës së mbrojtur, zbatohet regjimi mbrojtës i nivelit të tretë.

(iii) *Niveli i regjimit mbrojtës*

- Regjimi mbrojtës i nivelit të parë përfshin ndërhyrjet në asetet e dëmtuara; kryesisht të kufizuara në mirëmbajtje, ose riparime të vogla në ndërtesa dhe vende të hapura. Në zonat e rezervave arkeologjike mund të bëhet vetëm mirëmbajtja. Vlerësimi i aseteve të mbrojtura me ligj në këtë nivel të mbrojtjes kryesisht përfshin ruajtjen e funksioneve ekzistuese, dhe/ose vendosjen e funksionit të ri që i përshtatet mundësive të zonës së përfshirë.

fillimisht përfshinë mbajtjen e funksionit ekzistues dhe/ose futjen e një funksioni të ri që është rregulluar me mundësitë e zonës së mbuluar nga plani.

- Regjimi mbrojtës i nivelit të dytë përfshin ruajtjen e pamjes origjinale të aseteve dhe ndërhyrjet që nuk janë në konflikt me qëllimet e mbrojtjes dhe veçoritë origjinale të aseteve. Struktura ekzistuese urbane u përshatet nevojave aktuale dhe funksioneve të reja, duke respektuar veçoritë arkitekturore të aseteve. Ndërhyrjet zakonisht janë të lidhura me përshtatjen e enterierit, ndërsa eksterieri dhe fasada ruhen në pamjen e tyre origjinale.

Vendet e zbrazëta mund të shfrytëzohen për ndërtim të ndërtesave të reja me shprehje tjetër arkitekturore, në përputhje me karakterin e zonës në fjalë.

- Regjimi mbrojtës i nivelit të tretë përfshin kufizime në lidhje me madhësinë/sipërfaqen dhe lartësinë e katit të ndërtesave në zonat e mbrojtura të aseteve dhe përshtatjen e shprehjes së re arkitekturore me trashëgiminë.

Në një zonë të mbrojtur mund të zbatohen nivele të ndryshme të mbrojtjes.

Paraqitja grafike e regjimit mbrojtës përfshin krijimin e pasqyrave grafike të sintetizuara dhe të veçanta, të harmonizuara me analizën për vlerësim dhe/ose rivlerësim të aseteve në zonës në fjalë.

Masa të veçanta të mbrojtjes përpunohen vetëm në vështirimin e përgjithshëm studimor të bazës.

Lloji dhe numri i masave dhe shtirja e zhvillimit të tyre përcaktohen në pajtim me llojin e bazave dhe llojin e masave.

Shenim

Në zonat e rezervuara arkeologjike, vetëm mirëmbajtja mund të bëhet.

Analiza e aseteve të mbrojtura me ligj në këtë nivel të mbrojtjes

BURIMET E PERZGJEDHURA:

Guidance on the Development of Legislation and Administration System in the Field of Cultural Heritage, CoE publication (2011, second edition)

Integrated management tools in South-East Europe, CoE publication (2008)

Guidance on heritage assessment, CoE publication (2005)

Guidance on urban rehabilitation, CoE publication (2005)

ICOMOS – Recommendations for the analysis, conservation and structural restoration of architectural heritage (2003);

ICOMOS Charter – Principles for the analysis, conservation and structural restoration of architectural heritage (2003)

ICOMOS Indonesia, Charter for Heritage Conservation (2003)

ICOMOS Charter on Built Vernacular Architecture., Mexico 1999

ICOMOS – Washington Charter (Charter for the Conservation of Historic Towns and Urban Areas), Washington, 1997

ICOMOS – Venice Charter (Charter for the Conservation and Restoration of Monuments and Sites), Venice, 1994

ICOMOS – New Zealand Charter (Charter for the Conservation of Places of Cultural Heritage Value), New Zealand, 1993

ICOMOS – Guidelines for Education and Training in the Conservation of Monuments, Ensembles and Sites (1993)

ICOMOS Appleton Charter for the Protection and Enhancement of the Built Environment (Canada 1983)

ICOMOS – Burra Charter (Charter for the Conservation of Places of Cultural Significance), Australia, 1979

Resolution (72) 20 on interim measures for the protection of the cultural heritage of monuments and sites (adopted by the Committee of Ministers, 1972, CoE Strasbourg)

Conservation and Collections Care, Spectrum: The UK Museum Documentation Standard Conservation Guidelines: Conservation Principles/General Information (published by the Irish Department of the Environment)

Sources of help and advice:

Planning Reconstruction (Chapter from “Safer Homes Stronger Communities: A Handbook for Reconstructing after Natural Disaster” published by the World Bank, January 2010)

Recording, Documentation, and Information Management for Conservation of Heritage Places, The Getty Conservation Institute, Los Angeles 2007

Evaluation of cultural heritage in EIA , Heskoning Nederland, B.V. Spatial Development, (2004)

European Confederation of Conservator-Restorer Organisations (ECCO): ECCO Professional Guidelines, Brussels, ECCO, 2002

Values and Heritage Conservation, Research report, The Getty Conservation Institute, Los Angeles 2000;

Feliden, B.M., Jokilehto, J., Management Guidelines for World Cultural Heritage Sites, ICCROM 1998

Landmarks of a New Generation: User’s Manuel, The Getty Conservation Institute, 1997

Ward, Ph., The Nature of Conservation, Getty Conservation Institute, 1989

Jokilehto Jukka, A History of Architectural Conservation (with other sources), ICCROM, 1986

Udhëzues për aktivitetet e konzervimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore

- hartimi i projekteve konservuese

I. LLOJET E PROJEKTEVE

- Sipas llojit të ndërhyrjeve:
 1. *Projekte për ndërmarrjen e masave/ndërhyrjeve parandaluese*
 2. *Projekte për kryerjen e punimeve konservuese*
 3. *Projekte për kryerjen e punëve në strukturën e asetit*
 4. *Projekte për kryerjen e punimeve për adaptim*
 5. *Projekte për kryerjen e punimeve restauruese*
 6. *Projekte për kryerjen e punimeve rindërtuese*
 7. *Projekte për marrjen e masave mbrojtëse dhe ndërhyrje të tjera*
- Sipas kategorisë, ose llojit të asetit:
 1. *Projekte për konservimin e aseteve të trashëgimisë së patundshme*
 2. *Projekte për konservimin e aseteve të trashëgimisë së tundshme*
- Sipas kompleksitetit të masave dhe ndërhyrjeve – fazat:
 1. *Projekte konceptuale*
 2. *Projekte kryesore (themelor)*
 3. *Projekte ekzekutive*
 4. *Shtojca e projektit ekzekutiv*
 5. *Projekte për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e asetit*

II. METODOLOGJIA DHE KUSHTET PËR HARTIMIN E PROJEKTEVE KONSERVUESE

A. REALIZIMI I PUNËVE HULUMTUESE:

- *Programi i hulumtimit konservues*
- *Realizimi i punës hulumtuese*
- *Dokumentacioni i procesit hulumtues dhe i rezultateve*

B. PROGRAMI PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË KONSERVIMIT

C. HARTIMI I PROJEKTIT TË KONSERVIMIT – FORMATI DHE PËRMBAJTJA:

- *Faqja e parë e projektit të konservimit*
- *Dëshmitë për hartimin e projektit konservues*
- *Rezultatet e punës hulumtuese*
- *Programi për hartimin e projektit konservues*
- *Sqarimi i propozimeve/zgjidhjeve të projektit*
- *Sasia dhe kostoja e projektit.*

III. RISHIKIMI I HARTIMIT TË PROJEKTIT KONSERVUES

- *Komisioni për rishikimin e hartimit të projektit të konservimit*
- *Përgjegjësia e komisionit*
- *Raporti i komisionit*

IV. STANDARDET SPECIFIKE DHE NORMAT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT KONSERVUES

- *Parimet themelore*
- *Konservimi i trashëgimisë së patundshme kulturore*
- *Konservimi i pikturave dhe llojeve tjera të vlerave dhe/ose dekorimit*
- *Konservimi i materialit arkivor*
- *Konservimi i librave të vjetër dhe materialeve tjera librare*

BURIMET E PËRZGJEDHURA

Udhëzues për aktivitetet e konzervimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore –hartimin e projekteve konservuese është pergaditur nga ekipi i projektit PDKK. Ky udhëzues është diskutuar dhe zhvilluar me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ekspertëve lokal. Udhëzuesi (draft) është shqyrtuar nga eksperti i Këshillit të Evropës, z. David Johnson (Mbretëria e Bashkuar), dhe znj. Donatella Zari (Itali).

Duke pasur parasyhs se hulumtimi i detajuar dhe targetuar është i nevojshëm kudo qe kushtet e asetit te trashegimise ne fjale është gjetur i rrezikuar apo është identifikuar nevoja per intervenim per te vazhduar ekzistenca e tij ne rrethana të reja pa humbur elementet esenciale qe kntribojnë në rëdësinë e tijë, është nevoj e nje procesi ligjor qe te plotësojë kërkesat. pa marre parasysh nese intervenimi do te behete nga kompanitë e spoecializuara (publike/private) apo nga stafi i Institucioneve mbrojtëse të trashëgimisë me konzervator profesional, ekziston nevoja e krijimit te rregulores per hartimin e projekteve të konzervimit.

Në këtë kontekst Udhëzuesit pere caktojnë llojin dhe përmbajtjen e projekteve të konzervimit (duke perfshirë varianta të lejueshme) kushteve per kryerjene e planeve te konzervimit dhe kryerjen e mbikqyrjes profesionale te projekteve te konzervimit si dhe standardeve dhe rregullave te palneve te konzervimit , dhe rregullon ceshtje specifike lidhur me metodologjine e planifikimit konzervues ne fjal.

Udhëzuesit percjellin kontekstin e rregullores Nr. 03/2008 ne aktivitetet e konzervimit dhje restaurimit në trashëgiminë kulturore, qe rezulton nga LTK (nenet: 2.10,2.11,4.16,6.7 dhe 9.13). Për më tepër ato duhet te konsultohen ne proceduren per plotësimin e standardeve profesionale te personave juridik ose fizik dhe kompanive per ofrimin e masave të konzervimit në asetet e trashëgimisë kulturore qe duhet te krijohen nga MKRS.

Prishtinë, Maj 2012

I. LLOJET E PROJEKTEVE

Sipas llojit të ndërhyrjes që duhet ndërmarrë, projektet konservuese mund të jenë:

1. Projekte për ndërmarrjen e masave/ndërhyrjet parandaluese

Projekti për masat/ndërhyrjet parandaluese bëhet për trashëgiminë kulturore në rrezik dhe asetet nën mbrojtje të përkohshme si dhe për zonat e rezervatit arkeologjik, ku është e nevojshme të ndërmerren masa të përkohshme të mbrojtjes për të ruajtur asetin derisa të sigurohen kushtet për të ndërmarrë masa të tjera të duhura për mbrojtje afatgjatë.

2. Projekte për kryerjen e punimeve konservuese

Projekti për kryerjen e punimeve konservuese hartohet për konservimin e trashëgimisë kulturore të patundshme, ose të një pjese të saj integrale, kur është e nevojshme, kërkohet ose parashikohet mbrojtja për asetin përkatës që të ruhet në formën dhe gjendjen e vet origjinale, si për shembull në gjendjen në të cilën është gjendur, pa shtuar elementet që janë shkatërruar ose që mungojnë.

3. Projektet për kryerjen e punimeve në strukturën e asetit

Projekti për kryerjen e punimeve në strukturën e asetit hartohet për trashëgiminë e patundshme kulturore, ose për pjesë të saj integrale, ku ka dëme të elementeve strukturore të asetit, ose kur është e nevojshme që të largohet një dëm i tillë dhe që asetit të kthehet në gjendje të qëndrueshme, pa rrezikuar veçoritë e veta me vlerë.

4. Projektet për kryerjen e punimeve për adaptim

Projekti për kryerjen e punimeve për adaptim/ndryshime hartohet për trashëgiminë e patundshme kulturore, ose një pjesë të saj integrale, kur është e nevojshme, kur kërkohet ose kur parashikohet ndryshimi i enterierit të ndërtesës për shkak të kthimit në funksionin original, për të ndryshuar apo vënë në veprim funksionet e caktuara të asetit në tërësi ose të një pjese të tij, pa ndryshuar elementet strukturore

të ndërtesës dhe pa dëmtuar vlerat ose veçoritë tjera artistike të asetit.

5. *Projektet për kryerjen e punimeve restauruese*

Projekti për kryerjen e punimeve restauruese hartohet për aset in e patundshëm ose të tundshëm, kur kërkohet ose parashikohet përtëritje autentike e asetit të dëmtuar pjesërisht, duke shtuar pjesët që mungojnë në formë dhe pamje të jashtme, duke përfshirë anastilozën, rikompozimin, rindërtimin, zgjerimin, ose ndërhyrje të tjera restauruese, ose largimin e pjesëve dhe elementeve të shtuara në mënyrë jo të përshtatshme.

6. *Projektet për kryerjen e punimeve rindërtuese*

Projekti për kryerjen e punimeve rindërtuese hartohet për aset in e patundshëm ose të tundshëm, kur është e nevojshme, kur kërkohet ose parashikohet përtëritje e asetit, i cili është shkatërruar shumë ose plotësisht, si dhe në rast të zhvendosjes së plotë ose të pjesshme, të rindërtimit dhe veprimeve tjera të ngjashme rindërtuese.

7. *Projektet për marrjen e masave mbrojtëse dhe ndërhyrje të tjera*

Projekti për marrjen e masave të tjera mbrojtëse dhe ndërhyrje të tjera hartohet për trashëgiminë kulturore të patundshme ose të tundshme, ose për një pjesë të saj përbërëse, në rastet kur ndërmerret një ndërhyrje e caktuar mbrojtëse si masë e pavarur, në veçanti në rastin e anastilozës, rikompozimit, çmontimit, shtresëzimit të shtresave të pikturuara, ose nxjerrjes ose largimit të afreskeve, mozaikut, skulpturës ose llojeve të tjetra të dekorimeve, ose vendosjes së ndërtimeve apo strukturave mbrojtëse etj.

Sipas *kategorisë apo llojit të aseteve* për të cilat propozohen masat/ndërhyrjet projektet konservuese mund të jenë:

për konservimin e trashëgimisë së patundshme, të tilla si projekt dizajni për stabilizimin e strukturës (statikës), ose konservimi i arkitekturës, për konservimin e trashëgimisë së luajtshme, të

tilla si hartimi i projektit për konservimin e ikonave, mozaikëve, pikturave, objekteve të skulpturuara, veçorive të gdhendjes së drurit, objekteve të metalit, qeramikës, qelqit, lëkurës, tekstilit, pergamenës, letrës, imazheve etj.

Sipas *kompleksitetit të masave dhe ndërhyrjeve* që ndërmerren projekti konservues mund të zhvillohet në disa faza/shkallë, të tilla si:

1. Projekti konceptual (ideor)

Projekti konceptual hartohet veçanërisht për:

1.1. trashëgiminë e patundshme kulturore nëse është e nevojshme të bëhet:

- zhvendosja;
- rindërtimi i plotë (i tërë) apo i pjesshëm;
- adaptimi me shkallën e lartë të ndërhyrjeve;
- restaurimi i ndërhyrjeve të nivelit të lartë, duke përfshirë rikompozimin, anastilozën, shtimin e elementeve që mungojnë, ose largimin e veçorive jo të përshtatshme shoqëruese dhe të tjera (ndërtesat apo pjesët e ndërtesave), pajisjet ndihmëse etj.;
- shtresëzimi i shtresave të pikturave, largimi i mozaikut të dyshemesë, heqja e afreskeve, largimin ose ndarjen e ornamenteve ose të elementeve tjera të përdorura dhe veprime të ngjashme;
- rregullimi i peizazhit dhe lloje të tjera të rregullimit të vendit dhe/ose rrethinës së tij, ku përfshihen modifikimi i terrenit ose ndërhyrje të tjera më të mëdha në një zonë të mbrojtur;
- ndërtimi i strukturave për mbrojtje të përkohshme ose të përhershme dhe i strukturave të tjera;
- kryerja e punimeve në aset in e mbrojtur, ose në pjesë të tij, që paraqesin një ndërtesë të veçantë, pikturë apo një njësi funksionale, nëse punimet kryhen si fazë e veçantë e projektit;
- në raste të tjera, kur përcaktohet nga kushtet e konservimit apo të vendit.

- 1.2. Trashëgiminë e tundshme kulturore, në rastet kur:
- pjesa integrale origjinale e asetit të patundshëm duhet të hiqet përgjithmonë (për shkak të arsyeve mbrojtëse) dhe të vendoset nën mbrojtje si trashëgimi e tundshme kulturore, p.sh. kur duhet të bëhet aset i tundshëm në kuptimin ligjor;
 - kërkohet restaurimi dhe rindërtimi.

Projekti konceptual përfshin grafikën dhe dokumentet e tjera që përdoren si bazë për krijimin e zgjidhjeve artistike, funksionale dhe teknike për ndërhyrjet që do të bëhen.

Projekti konceptual mund të përmbajë disa zgjidhje të mundshme.

2. Projekti kryesor (themelor)

TProjekti kryesor (themelor) hartohet për të gjitha format e trashëgimisë kulturore të patundshme dhe të tundshme, pavarësisht nga kategoria e tyre dhe lloji i ndërhyrjes së propozuar të mbrojtjes.

Ky projekt shtjellon llojin dhe shtrirjen/përmasën e ndërhyrjeve, mënyrën dhe planin dinamik të zbatimit të tyre.

Ky projekt lidhet me kategorinë përkatëse ose me llojin e aseteve (p.sh. projektet për arkitekturë, statikë, pikturë muri, ikonografi, mozaikë, objekte të pikturimit në vaj dhe teknika tjera, skulptura nga guri, pjesë apo objekte të gdhendura nga druri, objekte të metalit, qeramikës, qelqit, eshtra, lëkurë, tekstil, pergamenë, letër etj.).

2.1. Projekti kryesor (themelor) përmban:

2.1.1. Vlerësimin teknik të gjendjes aktuale:

- analiza e gjendjes aktuale dhe/ose përshkrimi i dëmeve;
- analiza e teknikës dhe teknologjisë së përdorur;
- analiza fizike-kimike e materialeve të përdorura.

2.1.2. Dokumentacioni teknik i gjendjes aktuale përgatitet në shkallën e duhur, duke shënuar vendet, llojet dhe shtrirjen e dëmit, si dhe vendin nga i cili janë marrë mostrat për analizë apo testet e kryera, dhe përfshin situatën, bazën/themelin, prerjet, detajet dhe llojet tjera

të vizatimeve dhe grafikave, deri te shtrirja që përshtatet me llojin e asetit dhe llojin e shtrirjes së ndërhyrjeve mbrojtëse të propozuar.

2.1.3. Dokumentacioni fotografik:

Dokumentacioni fotografik i gjendjes aktuale përgatitet me teknikën dhe shtrirjen e duhur dhe ofron informacion të saktë vizual rreth gjendjes aktuale dhe vendit, llojit dhe shtrirjes së dëmit, dhe ofron informacion rreth vendit ku janë kryer testet.

2.1.4. Ndërhyrjet që do të ndërmerren përfshijnë:

Shtjellimin e ndërhyrjes së propozuar duke shfrytëzuar udhëzimet e paraqitura në Kapitullin II dhe Kapitullin III të këtij Udhëzuesi si dhe:

2.1.4.1. Dokumentacionin teknik:

për trashëgiminë e patundshme kulturore:

- pozicionin në shkallën 1 : 100 dhe për asetet më të mëdha në shkallën 1 : 1 000, me pamjen e vendit (pozitën e asetit) në zonë dhe fasadën e tij të pestë (çatinë) dhe objektet e rëluara të përshtatura, qasjet, drejtimet kryesore, rregullimi i ambientit dhe të ngjashme;
- baza në shkallën 1 : 100, me numrin e kërkuar të ngritjeve, duke përfshirë bazën e kateve dhe/ose papafingëve, kur është e nevojshme;
- prerjet (tërthore dhe gjatësore) në shkallën 1: 100, me lartësi dhe përshkrim në bazë;
- fasadën në shkallën 1 : 100;
- detajet në shkallën 1: 1 deri 1 : 20, sipas rastit;
- enterieri, me një paraqitje të veçantë të përmbajtjes së pikturuar, gdhendur, skulpturuar dhe tjetër, në shkallën 1: 1 deri 1: 25, sipas rastit;
- plani i mobilierisë në shkallën 1: 50, nëse ka lloje të ndryshme të dymave dhe dritareve. për trashëgiminë e tundshme kulturore:
- vizatimet, skemat dhe përshkrimet e tjera të sipërfaqeve të ngjyrosura, relieveve,

skulpturave dhe elementeve të gurit, drurit, metalit, qeramikës, qelqit, tekstilit dhe të tjera, ose të pjesëve apo objekteve, shenjave, dekorimeve dhe përmbajtjes së ngjashme në shkallën 1: 1 deri në 1: 50;

- prerjet identifikuese të strukturës së asetit me komponente ose shtresa etiketimi.

Janë të mundshme përjashtimet nga përmbajtja e dokumentacionit teknik për ndërhyrjet në trashëgiminë e patundshme kulturore:

- kur nuk është e nevojshme të hartohet projekti ekzekutiv, dokumentacioni teknik për dokumentim të trashëgimisë së patundshme kulturore të rëndësisë së madhe përmban vizatimet e bazës, prerjet dhe fasadën (f) në shkallën 1 : 25;
- nëse objekti është i dimensioneve të vogla, dokumentacioni teknik i trashëgimisë së patundshme kulturore të rëndësisë së madhe përmban vizatimet e themelit, prerjet dhe fasadat në shkallën 1 : 25.

2.1.5. Plani dinamik

Dinamika e planit të zbatimit të projektit për ndërhyrje parandaluese përfshin paraqitjen skematike ose çdo paraqitje tjetër të gjendjes së punës që do të kryhet në fazat e projektuara dhe afatet për realizimin e secilës fazë, shprehur në ditë pune.

3. Projekti ekzekutiv (zbatues)

Projekti ekzekutiv hartohet për trashëgiminë e patundshme kulturore kur kemi të bëjmë me ndërtesa komplekse ose ndërhyrjen mbrojtëse komplekse që përbëhet ose përmban: zhvendosjen, shtresëzimin e shtresave të pikturuara ose të llojeve të tjera të ndarjes, rindërtimin e pjesshëm ose të plotë dhe në raste të tjera kur del e nevojshme.

Projekti ekzekutiv shtjellon zgjidhjen teknike të ofruar në projektin kryesor (themelor).

Projekti ekzekutiv përbëhet nga:

1. për ndërhyrjet në strukturë/konstruksion:
 - vizatimet e detajuara që paraqesin dokumentacionin e detajuar teknik të

zgjidhjes (ve) të konstruksionit/strukturës, të përgatitura në shkallën 1 : 50 në përputhje me rregullat teknike;

- detajet e tjera të konstruksionit dhe punëve përfundimtare (profesionale).

2. për ndërhyrjet në piktura ose në veçoritë e tjera artistike:

- një plan i detajuar për secilën fazë;
- një përshkrim i detajuar i punës;
- vizatimet me matje të saktë të të gjitha shtresave, apo pjesëve, në shkallën 1: 1 deri 1: 50.

4. Shtojca e projektit ekzekutiv

Shtojca e projektit ekzekutiv hartohet për trashëgiminë e patundshme kulturore në rastet kur zbatimi i projektit konservues kërkon devijim nga projekti kryesor (themelor) ose nga projekti ekzekutiv.

Ky projekt hartohet gjatë punëve të ndërmarra dhe përmban tekstin dhe/apo paraqitjen grafike të gjendjes së tanishme të ndërhyrjes së kryer, ose të ndërhyrjes shtesë që do të bëhet.

5. Projekti për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e asetit

Projekti për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e asetit hartohet për trashëgiminë kulturore të patundshme dhe të tundshme në rastet e ndërhyrjeve komplekse dhe ndërhyrjeve të tjera specifike që përfshijnë në mënyrë të veçantë mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin të asetit pasi të jenë marrë masat mbrojtëse.

Ky projekt përcakton atë që është optimale, pra kushtet specifike teknike-teknologjike, funksionale dhe kushtet e tjera për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e asetit të caktuar.

Projekti për shfrytëzim dhe mirëmbajtje përfshin:

1. llojin, metodën dhe kornizën kohore për vlerësimet periodike të elementeve konstruktive dhe pjesëve ose veçorive të tjera karakteristike të asetit të caktuar;
2. afatet e fundit për zëvendësimin e kërkuar të elementeve të caktuara, pjesëve, instalimit dhe pajisjeve të tjera;
3. monitorimin periodik dhe analizën e ndikimit klimatik dhe mikroklimatik mbi gjendjen e asetit

- të caktuar;
- 4. kushtet për ruajtje, përdorim, paketim, transportim, transferim, prezantim dhe aktivitetet e lidhura me këtë;
- 5. metodat specifike të sigurimit të qasjes në asetin e mbrojtur.

- 4. dinamikën e realizimit të hulumtimit;
- 5. buxhetin;
- 6. mjetet teknike;
- 7. dokumentacionin.

II. METODOLOGJIA DHE KUSHTET PËR HARTIMIN E PROJEKTEVE KONSERVUESE

Hartimi i projektit konservues si një proces i plotë përfshin fazat e mëposhtme të punës:

- A. realizimin e punëve hulumtuese;
- B. zhvillimin e një programi operacional për hartimin e projektit konservues;
- C. hartimin e projektit konservues;
- D. shqyrtimin/kontrollin e hartimit të projektit konservues.

A. REALIZIMI I PUNËS HULUMTUESE

Çdo hulumtim konservues, pavarësisht nga lloji, si një proces i plotë përfshin fazat vijuese:

- 1. aktivitetet paraprake (përgatitore) që kanë lidhje me përmbushjen e kushteve për miratimin e kryerjes së hulumtimit konservues;
- 2. realizimin e hulumtimit;
- 3. interpretimin e rezultateve;

- *Programi i hulumtimit*

Hulumtimi konservues kryhet në përputhje me një program për hulumtim konservues.

Programi për hulumtim konservues mund t'i referohet një ose më shumë aseteve të mbrojtura, pavarësisht nga lloji i hulumtimit dhe mënyra e organizimit të tyre.

Programi përfshin:

- 1. të dhëna mbi atë që kryen hulumtimin dhe për organizimin e hulumtimit;
- 2. temën, llojin dhe përmasat e hulumtimit;
- 3. qëllimin e hulumtimit dhe rezultatet e pritura;

Punët hulumtuese me qëllim hartimin e projektit konservues, pavarësisht nga kategoria/lloji i asetit dhe/ose lloji dhe shtrirja e ndërhyrjes mbrojtëse që do të ndërmerret, mund të përbëhen nga një apo më shumë lloje hulumtimi.

Llojet e hulumtimit janë:

- 1. hulumtim arkivor-bibliografik;
- 2. hulumtim arkeologjik;
- 3. hulumtim konservues;
- 4. hulumtim gjeomekanik;
- 5. hulumtim i ndonjë fushe tjetër, hulumtim laboratorik ose kabinet.

Lloji i hulumtimit dhe mënyra e kryerjes ose e organizimit përcaktohen nga programi për hulumtim konservues.

Kushtet e veçanta:

- a) nëse punët hulumtuese përbëhen ose përfshijnë kryerjen e hulumtimit arkeologjik dhe/ose konservues "in situ" (në terren):
 - 1. një pjesë integrale e programit për hulumtim konservues është plani për hulumtim arkeologjik, p.sh. programi për hulumtim konservues, pavarësisht nga mënyra sesi organizohet hulumtimi;
 - 2. Ky hulumtim mund të bëhet nga:
 - ekipi i krijuar si ekip hulumtues për atë lloj të veçantë të hulumtimit, pa ndryshuar përbërjen dhe statusin e personelit në ekip;
 - anëtar(i) e ekipit në rolin e menaxherit(ëve) të hulumtimit, me apo pa përfshirjen e pjesëmarrësve të tjerë në hulumtim;
 - një ose më shumë ekipe të tjera hulumtuese që nuk përfshijnë menaxherët dhe ekipin e projektit.

- b) Nëse puna hulumtuese përbëhet ose përfshin kryerjen e hulumtimit gjeomekanik dhe/ose ndonjë hulumtim tjetër specifik sipas fushës, ose hulumtim laboratorik, zakonisht ato punë u besohen ekzekutuesve tjerë.
- c) Nëse punët hulumtuese përbëhen ose përfshijnë shfrytëzimin e rezultateve të arritura më parë nga hulumtimi arkeologjik, konservues dhe/ose lloje të tjera, hulumtimet e tilla vihen në listë në raportin(et) e (realizimit) hulumtimit dhe në programin për hartimin e projektit konservues.
- d) Nëse një program për hulumtim konservues përfshin shumë lloje hulumtimi, ose shfrytëzimin e rezultateve të hulumtimeve të kryera më parë, rezultatet e një hulumtimi të tillë do të jenë pjesë e raportit përmbledhës. Pjesë integrale e raporteve përmbledhëse janë raportet individuale nga lloje të caktuara hulumtimi.
- *Realizimi i punës hulumtuese siguron:*
 - mbledhjen, klasifikimin dhe përpunimin e të dhënave në dispozicion dhe dokumentacionit përkatës për hulumtimin e caktuar;
 - vlerësimin teknik të gjendjes së asetit (eve) të mbuluar nga programi për hulumtim;
 - kryerjen e analizës dhe të testeve të nevojshme laboratorike;
 - dokumentimin e procesit hulumtues;
 - përgatitjen e raporteve mbi hulumtimin konservues.

- *Dokumentacioni i procesit hulumtues dhe i rezultateve*

Dokumentacioni i procesit hulumtues kryhet në pajtim me kërkesat në lidhje me kategorinë/llojin e aseteve, qëllimet e hulumtimit dhe llojin dhe përmasën e hulumtimit konservues. Dokumentacioni përgatitet duke siguruar ose krijuar dokumentacion përshkrues, teknik, me fotografi ose dokumentacion tjetër përkatës.

Dokumentacioni zakonisht i referohet:

1. dëmtimit të aseteve, me një prezantim të detajuar, duke dhënë shënim të saktë për vendin, llojin dhe shtrirjen e dëmit;
2. identifikimit të aseteve dhe materialeve nga të cilat ato janë punuar, dhe në veçanti përbërjes së tyre, veçorive dhe karakteristikave të tjera (veçantitë);
3. matjeve të kryera, sondimi, testimi, analizave dhe hulumtimeve;
4. rezultateve të arritura të hulumtimit

B. PROGRAMI PËR HARTIMIN E PROJEKTIT KONSERVUES

Programi për hartimin e projektit konservues përgatitet duke u bazuar në rezultatet e punës hulumtuese, në pajtim me planin operacional.

Programi për hartimin e projektit konservues përfshin llojin dhe shtrirjen e ndërhyrjes mbrojtëse, ose kushtet dhe kërkesat arkitekturore, artistike-teknike dhe/ose kushtet e tjera përkatëse për zhvillimin e projekteve konservuese.

Programi përcakton llojin, vëllimin dhe drejtuesit e punës, dinamikën zbatuese, sasinë e mjeteve financiare dhe çështje të tjera të lidhura me hartimin e konservimit, në pajtim me këto rregulla.

C. HARTIMI I PROJEKTIT KONSERVUES – Formatit dhe përmbajtja

Çdo projekt konservues, pavarësisht nga lloji, përmban pjesën e përgjithshme dhe të veçantë.

Pjesa e përgjithshme e projektit konservues përfshin:

1. 1. faqen e parë;
2. 2. përmbajtjen e projektit;
3. 3. dëshmitë për hartimin e projektit konservues;
4. 4. rezultatet e punëve hulumtuese;
5. 5. programin për dizajnin e projektit konservues;
6. 6. sqarimin e propozimeve/zgjidhjeve të projektit;
7. 7. cilësinë dhe koston e projektit.

Pjesa e veçantë e projektit konservues përfshin përmbajtjen e përcaktuar në lidhje me nivelin e planit (ideor, kryesor, projektin(e) ekzekutiv/e).

Faqja e parë e projektit konservues përmbanë:

1. emrin e personit, ose titullin dhe adresën e personit juridik që është realizuesi i projektit, ose ku legalizohet projekti;
2. numrin e arkivimit dhe datën e projektit ose legalizimit të projektit;
3. emrin e projektit:
 - sipas llojit (të ndërhyrjes së propozuar), dhe
 - emrin e plotë dhe vendin e asetit të lidhur me projektin.
4. vendin dhe datën e hartimit të projektit.
5. Emrin e pronarit/ shfrytëzuesit të asetit të trashëgimisë kulturore

Përmbajtja e projektit konservues përfshin emrat/titujt e plotë të përmbajtjes së projektit të hartuar;

Dokumentacioni per krahes per hartimin e projekteve perfshinë:

1. akti i regjistrimit për personat juridikë ose të personave me kod dhe një përshkrim i aktivitetit që përfshin përgatitjen e projekteve konservuese;
2. Instrumenti që definon pjesëmarrësit për zhvillim të projekteve konservuese (ekipin e projektit) dhe pozitën ose statusin e tyre;
